

Korrik 2012
Numri: 52
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den

Muslimani i mirë





Editorial

Krijuesi, i Madhërishmi e ka lidhur "enigmën e gjithësisë, jetës dhe vdekjes, si dhe të krijimit me provën se cili njeri do të nxjerrë në pah jetën më të rregullt dhe punët më të mira." (Hud, 7; Mulk, 2)

Allahu, i Cili është Ligjvënësi Absolut, ka vënë përpara nesh "kornizat e fesë më të mirë" duke na ftuar të mendojmë në qoftë se "ka besimtar më të mirë sesa ai, për të cilin mirësia është parim, që e adhuron Allahun sikur ta ketë para syve të tij, që ia ka nënshtruar pamjen e jashtme dhe botën e brendshme Allahut dhe që pason fenë monoteiste të Ibrahimit?" (Nisa, 125)

Në fjalën hyjnore myslimani këshillohet që "edhe të keqen ta zhdukë në mënyrën më të mirë të mundshme." (Muminun, 96; Fussilet, 34)

Allahu ka kërkuar prej myslimanëve që "të ftojnë në rrugën e Zotit me urtësi dhe këshilla të bukura" dhe në qoftë se konflikti me armë është i pashmangshëm "ta përmbushin atë në mënyrën më të kujdesshme". (Nahl, 125)

I Dërguari i Allahut sikur ka dëshiruar që të nënvizojë rëndësinë e një jete prej myslimani të mirë, kur ka thënë se "bukuria e të qenit mysliman është se myslimani nuk merret me punët që nuk i takojnë atij."

Feja islame është e bukur në thelb dhe të shprehesh "Unë jam mysliman", do të thotë ta cilësosh veten me shumë anë të bukura dhe pozitive.

A mund të bëhet fjalë për një "tip myslimani të shëmtuar", me fjalë të tjera, a është e mundur që një person të jetë mysliman dhe të mos jetë pajisur me bukurinë që të fal feja islame?

Sado kontradiktore të duket një gjë e tillë, ekziston mundësia që një individ të jetë përfshirë brenda rrethit të besimit islam dhe të mos e ketë pajisur veten e tij me të gjithë bukurinë që të fal feja islame.

Zemra e bukur është zemra e ngopur me dhikrin e Allahut.

Mendja e bukur është mendja që di ta lexojë siç duhet edhe këtë jetë, edhe jetën tjetër dhe di të bëjë zgjedhjet e saj duke pasur parasysh të dy botët.

Dora e mirë është dora që dhuron, dora që përkëdhel kokën e jetimit.

Gjuha e mirë është ajo që flet për Zotin dhe rri duke e përmendur Atë. Fjala e bukur është fjala që nuk mban me vete gënjeshtër, mashtrimin apo dredhinë.

Syri i mirë është syri që zbulon urtësinë tek çdo gjë që ka krijuar Zoti. Syri që lexon Kuranin dhe kundron Qabenë.

Namazi i bukur është namazi që falet për hir të Allahut duke i përmbushur të gjithë rregullat e namazit. Namazi gjatë të cilit përjetohet ndjesia se gjendesh përpara Zotit. Namazi që e bën myslimanin të përjetojë në mënyrë të vazhdueshme ndjesinë se gjendet përpara Zotit. Namazi që e mbron njeriun nga çdo lloj vepre e pahijshme dhe e shëmtuar.

Agjërimi i bukur është agjërimi ku agjërojnë të gjitha pjesët e trupit...

Do të lexoni:

- Ahmet Tashgetiren / 4** Muslimani i mirë
- Nexhat Ibrahimimi / 8** Ç'është Islami? -1-
- Nuredin Nazarko / 11** Kalvari i hipokrizisë së kritereve
- Ali Riza Temel / 12** Ndershmëria dhe besueshmëria janë cilësitë bazë të njeriut besimtar
- Vehap S. Kola / 16** Jeta si ripohim i paktit të kryehershëm me Zotin
- Muhamed El-Gazali / 18** Hadithi i dobët
- Ma. Muhidin Ahmeti / 20** Aplikimi i mësimit fetar islam në sistemin shkollor të Kosovës
- Soc. Raimonda Draçini / 23** Enigma e peronit dhe filozofia personaliste
- Ma. Gilman Kazazi / 24** Domosdoshmëria e të lexuarit të Kuranit
- Xhemal Nar / 26** Pasioni për ta quajtur veten perëndi
- Edison Çeraç / 28** Statusi dyjar i realitetit në botëkuptimin islam
- Imam Muhamed Sytari / 30** Pesë stacione në leximin e Israsë dhe të Miraxhit
- Abdurrahman Xhandan / 32** Njerëzit që hanë besimin e tyre
- Prof. dr. Shinazi Gyndyz / 34** Përbëria thelbësore e njeriut është dlijësia dhe pafajësia

4

Ahmet Tashgetiren



8

Nexhat Ibrahimimi



34

Prof. dr. Shinazi Gyndyz



Viti: VI | Numri: 52 | Korrik 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Dr. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Arjan Ymeraj / Artur Tagani

Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Korrik 2012

40

Osman Nuri Topbash




50

Prof. dr. Ahmet Akgyndyz



64

Ma. sci. Flamur Sofiu



Fotoja e Muajit 36 /

Një ajet - Një hadith 38-39 /

Gjendja e Hiçit 40 / **Osman Nuri Topbash**

Adhurimi dhe drejtësia 46 / **Albert Halili**

si reflektime të dashurisë
ndaj Allahut

Allahu është i bukur 49 / **Fatmir Sulaj**

dhe e do të bukurën

Disa fakte mbi reformën 50 / **Prof. dr. Ahmet Akgyndyz**

dhe ndryshimin në islam 54 / **Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz**

Edukimi shpirtëror 56 / **Zani i s'kaluemes**

Jemi midis Urës! 58 / **Ma. Ermal Nurja**

Regjistrimi i parë
osman (tahrir) në Shqipëri

Arkitektura Islame 60 / **Ma. Artur Tagani**

Shërimi me gjëra të ndaluara, 64 / **Ma. sci. Flamur Sofiu**

me ndyrësira dhe dhënia e marrja
e gjakut sipas Sheriatit Islam

Historiku i Bashkësisë Islame në Kinë 68 / **Enciklopedi**

Bashkëpunimi, faktor në forcimin
e shoqërisë Islame 70 / **Arben Halluni**

PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 634

Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 4411 98 48

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro

Myslimani i mirë

Ahmet Tashgetiren

Myslimanët janë robërit e Allahut, i Cili është i Hijshëm (Xhemil) dhe e do hijeshinë (xhemal).

Myslimanët janë ymeti i profetit Muhamed (a.s.), të cilin Allahu e ka cilësuar si "shembullin më të mirë dhe më të bukur". (Ahzab, 21)

Fjala hyjnore i ka cilësuar fjalët "unë jam mysliman" si "fjalët më të bukura". (Fussilet, 33)

Krijuesi, i Madhërishmi e ka lidhur "enigmën e gjithësisë, jetës dhe vdekjes, si dhe të krijimit me provën se cili njeri do të nxjerrë në pah jetën më të rregullt dhe punët më të mira" (Hud, 7, Mulk, 2)

Krijuesi, i Madhërishmi e ka mësuar njeriun në librin e Tij të shenjtë që "të kërkojë më të mirën si në këtë jetë, ashtu edhe në jetën tjetër." (Bakara, 201)

Allahu, i Cili është Ligjvënësi Absolut, ka vënë përpara nesh "kornizat e fesë më të mirë" duke na ftuar të mendojmë në qoftë se "ka besimtar më të mirë sesa ai, për të cilin mirësia është parim, që e adhuron Allahun sikur ta ketë para syve të tij, që ia ka nënshtruar pamjen e jashtme dhe botën e brendshme Allahut dhe që pason fenë monoteiste të Ibrahimit?" (Nisa, 125)

Krijuesi i Madhërishëm e ka cilësuar bamirësinë që myslimanët bëjnë ndaj të tjerëve, si një "hua e mirë" që i jepet Zotit. (Bakara, 245, Hadid, 11, 18, Tegabun 17, Muzemil 20)

Në fjalën hyjnore myslimani këshillohet që “edhe të keqen ta zhdukë në mënyrën më të mirë të mundshme.” (Muminun, 96, Fussilet, 34)

Allahu ka kërkuar prej myslimanëve që “të ftojnë në rrugën e Zotit me urtësi dhe këshilla të bukura” dhe në qoftë se konflikti me armë është i pashmangshëm “ta përmbushin atë në mënyrën më të kujdeshme”. (Nahl, 125)

I Dërguari i Allahut sikur ka dëshiruar që të nënvizojë rëndësinë e një jete prej myslimani të mirë, kur ka thënë se “bukuria e të qenit mysliman është se myslimani nuk merret me punët që nuk i takojnë atij.”

Po kështu, i Dërguari i Allahut i ka cilësuar persona të caktuar me fjalët “Islami i tij është i bukur” (Hasune islamuhu).

Nga gjithë këto ajete të Kuranit dhe hadithe të profetit Muhamed mësojmë se feja islame është e bukur në thelb dhe të shprehesh “Unë jam mysliman”, do të thotë ta cilësosh veten me shumë anë të bukura dhe pozitive.

Këto ajete dhe hadithe të profetit na tregojnë se Allahu dhe i Dërguari i Tij i kanë ftuar njerëzit ta përcjellin islamin në jetën e tyre me gjithë bukurinë e tij.

Nga këto ajete dhe hadithe kuptojmë se zbulimi i individit me mësimet e fesë islame varet nga vullneti dhe puna që kryen çdo mysliman për veten e tij. Në qoftë se vullneti mungon dhe nuk bëhet puna e duhur, personaliteti i myslimanit mund të mos pajiset me bukuritë e fesë islame dhe ai mund të shndërrohet kështu në një “tip njeriu të shëmtuar”.

A mund të bëhet fjalë për një “tip myslimani të shëmtuar”, me fjalë të tjera, a është e mundur që një person të jetë mysliman dhe të mos jetë pajisur me bukurinë që të fal feja islame?

Sado kontradiktore të duket një gjë e tillë, ekziston mundësia që një individ të jetë përfshirë brenda rrethit të besimit islam dhe të mos e ketë pajisur veten e tij me të gjithë bukurinë që të fal feja islame.

Fakti që jo çdo vepër e gabuar dhe e shëmtuar mjafton që islami të presë marrëdhënien me individin, e bën të mundur ekzistencën e një kundërthënieje të tillë.

Islami nuk e miraton kurrë që një mysliman të bëjë një vepër që konsiderohet gjynah. Gjynahu është i shëmtuar. Prandaj edhe në Kuran përdoren fjalët “një fëlliqësirë nga punët e shejtanit” (Maide 90, Enam 145) në lidhje me disa gjynahe. Nuk bëhet fjalë për bukurinë e një gjëje të tillë, por edhe kjo gjë mund të ndodhë në jetën e myslimanit, ashtu siç ndodh me disa gjynahe të tjera. Kështu që arrijmë në përfundimin se myslimani bëhet përherë e më shumë i shëmtuar, për sa kohë që kryen gjynahe në jetën e tij.

Zemra e bukur është zemra e ngopur me dhikrin e Allahut.

Mendja e bukur është mendja që di ta lexojë siç duhet edhe këtë jetë, edhe jetën tjetër dhe di të bëjë zgjedhjet e saj duke pasur parasysh të dy botët.

Dora e mirë është dora që dhuron, dora që përkëdhel kokën e jetimit.

Gjuha e mirë është ajo që flet për Zotin dhe rri duke e përmendur Atë. Fjala e bukur është fjala që nuk mban me vete gënjeshtren, mashtrimin apo dredhinë.

Syri i mirë është syri që zbulon urtësinë tek çdo gjë që ka krijuar Zoti. Syri që lexon Kuranin dhe kundron Qabënë.

Namazi i bukur është namazi që falet për hir të Allahut duke i përmbushur të gjithë rregullat e namazit. Namazi gjatë të cilit përjetohet ndjesia se gjendesh përpara Zotit. Namazi që e bën myslimanin të përjetojë në mënyrë të vazhdueshme ndjesinë se gjendet përpara Zotit. Namazi që e mbron njeriun nga çdo lloj vepre e pahijshme dhe e shëmtuar.

Agjërimi i bukur është agjërimi ku agjërojnë të gjitha pjesët e trupit.

Dhurimi i bukur është dhurimi që bëhet vetëm



për të fituar kënaqësinë e Allahut, ku dhuruesi nuk dëshiron të përmendet, që bëhet në mënyrë aq të mbuluar, sa që njëra dorë nuk e di se çfarë ka dhënë dora tjetër.

Prindërit e mirë janë ata prindër që përmbushin siç duhet detyrën e tyre si prindër dhe që i edukojnë fëmijët e tyre, duke i ndërgjegjësuar për adhurimin e Zotit.

Fëmija i mirë është fëmija që ndërgjegjësohet që në moshë të re për adhurimin ndaj Zotit dhe që i zgjat krahët e dhembshurisë ndaj prindërve të tij kur ata plaken.

Udhëheqësi i mirë është burri i shtetit që e konsideron detyrën që ka si regjistrin ku do t'i shënohen punët që ka bërë dhe tregohet i përpiktë në punën e tij, sepse e di se për çdo veprim që do të kryejë ka për të dhënë llogari.

Kriteret e "myslimanit të bukur" janë të gjithë ato kriteret që kanë ardhur nga Zoti në emër të fesë islame dhe që janë reflektuar në personalitetin e të Dërguarit të Allahut. Për këtë arsye, Profeti është cilësuar nga vetë Allahu si Usvetul-hasene, që do të thotë Shembulli më i bukur.

Myslimanët kanë përpara tyre një model, me bukuritë e të cilit ata mund të hijeshojnë dhe stolisin personalitetin e tyre. Ata që janë pajisur me veprat e bukura të Profetit, pasi ai kaloi në jetën tjetër, janë emërtuar si "miqtë e Allahut".

Ata janë përpjekur të ngjasojnë me Profetin, si me zemrat e tyre, ashtu dhe me mendjet, duart, këmbët,

sytë, veshët, namazet, agjërimet, haxhet, zeqatet, dhurimet, me një fjalë, me të gjitha veprimet dhe sjelljet e tyre në jetë. Me fjalë të tjera, ata janë përpjekur të përcjellin në personalitetet e tyre të gjithë bukuritë e Profetit.

Mund të thuhet se çdo individ është "mysliman i mirë", në varësi të masës që ka arritur të zbukurohet me bukurinë e Profetit.

Në krahun tjetër diametralisht të kundërt të këtyre bukurive, mund të numërohen gjërat e shëmtuara.

Edhe aty është e mundur të tregohet diferenca e këndit me të cilën hyn në mes personaliteti madhështor i të Dërguarit të Allahut. Pra, shkalla e masës së largimit nga bukuria mund të matet duke marrë parasysh masën e diferencës së këndit që ekziston, kundrejt personalitetit të Profetit.

Për shembull, nuk është e mundur të quhet zemër e mirë, zemra që është errësuar, sëmurë, mbuluar, madje ka vdekur me fëlliqësitë e gjynaheve.

Mendja që ka prishur ekuilibrin mes kësaj bote dhe botës tjetër gjatë kërkimit të së bukurës, që ka humbur koordinatat e saj të kërkimit dhe ka dalë nga boshti i saj, ka humbur edhe bukurinë e saj në të njëjtën kohë.

Si mund të quhen të bukura duart e fëlliqura me harame dhe shpërdorime?

A është i bukur syri që sheh haramin?



Ku mbeti bukuria e gjuhës së zhytur në gënjeshtër, përgojime dhe shkelje të të drejtave të Zotit ndaj njeriut?

A mund të quhet i bukur namazi i falur, të cilin po ta kishte parë i Dërguari i Allahut, do të kishte thënë: "Shko dhe falu sërish, se nuk je falur."?

A mund të cilësohet si e bukur mirësia që shoqërohet me përbuzje, që nuk meriton të pranohet nga Allahu për këtë arsye?

A mund të konsiderohet i bukur agjërimi i personit që ka agjëruar me midenë e tij, por me gjuhën e tij ka vrarë dhe ka përtypur mishin e njerëzve të tjerë duke përgojuar për ta?

A mund të numërohet si xhihad i bukur xhihadi që ka për qëllim të ngopë egon e tij me vepra trimërie apo që ka prirje për të ushtruar forcë mbi të tjerët?

A mund të flitet për bukurinë e një udhëheqjeje të shtetit që është përlyer me zullumin?

A mund të konsiderohet e bukur sipas kritereve hyjnore, detyra e prindërve që nuk pranohet e tillë as brenda familjes? Fëmija për të cilin prindërit e kanë të vështirë t'ia bëjnë hallall ato që u ka bërë, a do të trajtohet si i bukur tek Allahu?

A mund të quhet i mbarë udhëtimi i jetës, i cili është i ngarkuar plot me "hakun e ngrënë të njerëzve të tjerë"?

"Regjistri i jetës" që është plotësuar në këtë apo në atë mënyrë në këtë jetë, por që do ta bëjë të zotin

të skuqet kokë e këmbë në jetën tjetër, a mund të konsiderohet si diçka e bukur?

Ekziston një koncept mysliman i mirë.


Myslmani i mirë, para së gjithash, është i domosdoshëm për ne, sepse ai është provimi i jetës sonë. Pasi jeta jonë e përhershme do të jetë aq e mirë, në varësi se sa myslimanë të mirë kemi arritur të jemi në këtë jetë.

Vetëm se, të jesh mysliman i mirë, është e rëndësishme edhe për ata që kërkojnë të masin cilësinë e myslimanëve, duke na marrë ne për shembull.

E vërteta është se feja islame e zbukuron njeriun në atë masë që ai e jeton fenë. Në qoftë se shohim se ndonjë anë e kemi të mangët, kjo vjen për shkak të hapësirës që është krijuar mes nesh dhe mëtimeve të fesë islame.

Në qoftë se ne e përfaqësojmë fenë islame me këto aspekte të mangëta që kemi, do të bëjmë që feja islame të paguajë një dëm të rëndë për shkakun tonë dhe kjo parashikon një dënim të ashpër për ne në regjistrin e veprave.

Çdo mysliman duhet të përpiqet të stoliset sa më shumë me bukuritë e mëtimeve të fesë islame, ndërsa është këtu në këtë jetë, në mënyrë që të meritojë të quhet nga Allahu "Robi im i mirë" dhe të jetë njëri prej atyre, për të cilët i Dërguari i Allahut ka thënë se "Islami që jetoi është shumë i bukur" prandaj edhe meriton të bashkohet me Profetin nën flamurin e lavdit në Ditën e Gjykimit.





Ç'është Islami?

-1-

Nexhat Ibrahim

HYRJE¹

Në botën aktuale Islami nuk perceptohet njësoj nga të gjithë. Myslimanët kanë bindje të thellë se feja e tyre është më e lashta dhe më e reja dhe njëkohësisht më e mira. Sepse, që nga Ademi (a.s.) e deri te Muhamedi (a.s.), parimet kryesore të fesë janë po ato. Perëndimorët mendojnë ndryshe. Ata nuk e konceptojnë Islamin fe të re qiellore, vazhdimësi të feve të mëhershme, por mendojnë se Islami është një miks idesh të huazuara nga judeo-kristianizmi dhe të formuluar nga gjenialiteti i Muhamedit. Mirëpo, studiuesit objektivë myslimanë, por edhe disa jomyslimanë kanë mendime respektuese.

Në vazhdim, do të përpiqemi t'i shtrojmë qëndrimet islame për disa çështje aktuale në disa rreshta, meqë asnjë shkrim i kësaj natyre nuk synon të përgjigjet hollësisht.

ÇFARË QUAJMË ISLAM?

Islami, që e solli Muhamedi (a.s.), nuk është fe e re, por e njëjta, qysh nga Ademi (a.s.) e deri sot. Ai solli të vërtetat që Allahu i shpalli nëpërmjet të dërguarve të Tij për çdo popull në çdo kohë. Muhamedi (a.s.), është përmbyllja e ciklit pejgamberik deri në Fundin e Botës. Islami është fe e paqes, qetësisë, mirëqenies, aktivitetit, drejtësisë, dinjitetit njerëzor. Islami për myslimanët nuk është vetëm fe në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, siç e perceptojnë fenë zakonisht perëndimorët, por është edhe mënyrë jetese në të gjitha pikëpamjet. Këtë fe sot e pasojnë një e pesta e popullsisë botërore, në të gjitha vendet e botës. Numri i përgjithshëm i myslimanëve

1. Teksti u dedikohet lexuesve që e njohin pak apo aspak Islamin, por mund të shërbejë si udhëzues i mirë edhe për të tjerët. Autori.

mendohet ta ketë kaluar një miliard e gjysmë.

Ç'BESONJË MYSLIMANËT?

Besimi islam përbëhet prej gjashtë të vërtetave të pakontestueshme, nga fillimi i njerëzimit e deri sot. Këto të vërteta janë:

1. **Besimi në Një dhe të Vetmin Allah**, i pafillim, i pambarrim, që nuk i ngjason askujt dhe asgjësë, i Cili nuk varet nga askush dhe nga asgjë. Për Krijuesin nuk mund të shtrohet pyetja e kohës apo hapësirës, e kufizimit apo neglizhencës. Allahu është jashtë çdo perceptimi njerëzor dhe çdo përpjekje për identifikim paraqet përdhosje dhe blasfemi.

2. **Besimi në melekë (engjëj)**, të cilët Ai i krijoi në dobi të njeriut. Janë krijesa dritësore, të padukshme, pozitive, që me dëgjueshmëri dhe përlulje kryejnë urdhrat hyjnor. Melekët kryesorë janë: Xhibriili, Mikaili, Israfil dhe Azraili.

3. **Besimi në librat e Allahut**, të cilat ia dërgoi njerëzisë nëpërmjet të dërguarve, udhëzimi i drejtë, me synim të arritjes së kënaqësisë përfundimtare. Edhe librat e vegjël (suhufet) edhe librat e mëdhenj (kitabët), tregojnë pamjaftueshmërinë njerëzore dhe njëkohësisht, mëshirën e Krijuesit për krijesat e Tij.

4. **Besimi në të dërguarit e Allahut**, të cilët i dërgoi në dobi të njerëzve dhe nëpërmjet tyre e shpalli Fjalën e Tij. Të dërguarit i njohin nëpërmjet gradave të tyre si resul (i dërguar) dhe nebij (ferrëfytes). Çdo popull pati të dërguarit e tyre, si ndihmë për njerëzit.

5. **Besimi në Ditën e Fundit** dhe në të gjitha të vërtetat e Botës Tjetër. Çdo gjë që ndodh bëhet me caktimin dhe vullnetin e Tij. Edhe besimi në Jetën në varr dhe në ndodhitë pas ringjalljes janë nje të patjetërsueshme islame, si marrja në pyetje, dhënia e llogarisë, marrja e fletave, gjykimi, shefati, xheneti, xhehenemi etj.

SI BËHET NJERIU MYSLIMAN?

Islami dallon për nga thjeshtësia në çdo gjë, prandaj edhe nuk ka ndonjë ceremoni apo ritual të veçantë për t'u bërë mysliman. Kushti i vetëm është shehadeti, i cili përbëhet prej dy të vërtetave: *Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç një Allahu dhe se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij*. Me këtë deklarim, myslimani bëhet trashëgimtar i të gjitha shpalljeve të mëparshme dhe peygamberëve të mëparshëm, duke besuar se Muhamedi (a.s.), është i fundit dhe përfundimtar. Procesi i të bërit mysliman në aspektin shpirtëror, është i vazhdueshëm dhe nuk përfundon deri në momentin e vdekjes. Këtë proces myslimanët e quajnë xhihad të madh, që do të thotë

ndërtimi i vazhdueshëm i njeriut në rrafshin individual, duke u pajisur me virtyte të njëpasnjëshme.

Ç'DO TË THOTË FJALA ISLAM?

Fjala *islam* është nga gjuha arabe, që do të thotë përkushtim, dorëzim, kurse rrjedh nga fjala *selam*, që do të thotë paqe, prehje. Në kuptimin e ngushtë fetar, fjala *islam* do të thotë përkushtim, dorëzim i plotë ndaj Allahut të Madhërishtëm, përkatësisht *islam* do të thotë përshtatje dhe ndjekje e pakusht e Pejgamberit (a.s.), në jetën, dëshminë dhe konfirmimin e fesë në Zotin. Në përgjithësi, Islamin do ta kuptojmë si akt të dëgjueshmërisë ndaj Zotit, si unitet të fesë në dallimin e veprave dhe si kriter i ndërgjegjes.

Fjala *Allah* është në gjuhën arabe dhe nënkupton Krijuesin e plotfuqishëm. Në gjuhën shqipe si përkthim të kësaj fjale, në përdorim disa fjalë, si: Zot, Hyjni, Perëndi etj.

PËRSE ISLAMI SHPESHHERË PARAGJYKOHET?


Islami në të gjitha fazat e jetës njerëzore është i njëjtë dhe në aspektin besimor e moral nuk pëson ndryshime. Ndryshimet teknike e teknologjike nuk cenojnë substancën besimore, përkundrazi, të arriturat e mirëfillta intelektuale dhe shkencore do të ndihmojnë në të perceptuarit e drejtë të fesë islame.

Mirëpo, për shkaqe religjioze, politike, ekonomike e të tjera, nëpër faza të ndryshme të historisë, Islami edhe është keqkuptuar. Ai është quajtur fe e prapambetjes, moszhvillimit, dhunës etj. Sidomos në shekullin XX dhe XXI, Islami në Perëndim është keqkuptuar marrëzisht. Mënyra e jetës së myslimanit po atakohet, duke tentuar që ai të kufizohet vetëm në fe ceremoniale dhe private dhe duke ia mohuar gjithëpërfshirjen e tij të natyrshme.

A ËSHTË PREJARDHJA E ISLAMIT DHE JUDEO-KRISTIANIZMIT E NDRYSHME?

Të tria fetë qiellore, Islami, judaizmi dhe kristianizmi, kanë një prejardhje zanafillore. Janë fe të shpallura nga Allahu, nëpërmjet të dërguarve të Tij. Babai i të tria feve qiellore është Ibrahim (a.s.). Deri sa Musai dhe Isai (a.s.), rrjedhin nga i biri i Ibrahimit (a.s.), Is'haku (a.s.), Muhamedi (a.s.), mban prejardhjen nga Ismaili, i biri i madh i Ibrahimit (a.s.).

Sipas të dhënave historike, Ibrahim (a.s.), e themeloi qytetin e sotëm të Mekes dhe e ndërtoi Qabënë, drejt së cilës drejtohen të gjithë myslimanët e botës me rastin e namazit. Tendencat historike, madje edhe aktualisht se hebraikët kanë epërsi nacionale apo kristianët kanë epërsi shpirtërore, janë vetëm devijim nga rruga e mirëfilltë. Islami nuk pranon



epërsi politike, as racore, as gjuhësore, por pranon epërsinë e takvallëkut (devotshmërisë).

Ç'ËSHTË QABEJA?

Qabeja është vendadhurimi i Allahut (xh.sh.), të cilën e ndërjuan Ibrahim dhe i biri Ismaili (a.s.). Këtë e bënë me urdhrin e Allahut (xh.sh.), para 4000 viteve. Ndërtimi është bërë nga guri. Mendohet se vendi i Qabesë më herët ka qenë vend i shenjtë, të cilën e ka filluar Ademi (a.s.) edhe sot, me rastin e kryerjes së haxhit, të gjithë myslimanët kryejnë disa rituale, duke përkujtuar shpirtërisht, emocionalisht dhe historikisht të gjithë brezat e myslimanëve të mëhershëm, me në krye të dërguarit e tyre. Shprehja më e shpeshtë gjatë haxhit është: O Allah, të përgjigjem....

KUSH ËSHTË MUHAMEDI (A.S.)?

Muhamedi (s.a.v.s.), është lindur në Mekë, në vitin 570. Ishte pjesëtar i fisit të njohur Kurejsh. Në këtë kohë, kristianizmi në Evropë sa kishte filluar të shtrihej. Babai i vdiq ende pa lindur, kurse nëna i vdiq disa vjet më vonë. Ai mbeti jetim, nën përkujdesjen e gjyshit Abdulmuttalibit e pastaj të xhaxhait Ebu Talibit. Qysh në fillim personaliteti i tij ishte i veçantë. Të gjithë e donin, të gjithë e respektonin, gëzonte autoritet, sa ndonjëherë shërbente edhe si gjykatës mes palëve, sepse të gjithë e dinin se nuk mbante anën e padrejtësisë. Ndihej si njeri i qetë, punëtor, me prirje nga meditimi. E shqetësonin pa masë degjenerimet në shoqërinë mekase, sidomos besimi i idhujve, morali i ulët, fitimi i padrejtë, shkelja e njerëzve të pafuqishëm etj. Për këtë arsye, shpesh mendonte, me synim të gjente ndonjë rrugëdalje për popullin e tij. Shpesh e vizitonte shpellën Hira, në maje të Xhebel'un-Nur (Kodra e Dritës), në afërsi të Mekes.

SI U BË MUHAMEDI (A.S.) I DËRGUARI DHE FERRËFYESI I ALLAHUT (XH.SH.)

Muhamedi (a.s.), rreth të dyzetave vetmohej dhe meditoonte për tema të ndryshme. Ndërsa një ditë meditoonte, atij iu shpall meleku Xhibril me fjalët e para. Shpallja do të zgjasë gati 23 vjet. Ajo është ruajtur në librin e quajtur *Kurran*. Kjo ndodhi kështu: Posa shpallej ndonjë ajet, disa ajete apo një sure, Muhamedi (a.s.), e mësonte përmendsh e pastaj ua komunikonte shokëve të tij. I njëjti tekst shkruhej nga shokët. Kur Muhamedi (a.s.), filloi të thërriste në këtë të vërtetë, ai dhe shokët e tij iu ekspozuan fyerjeve, maltrajtimeve, përndjekjeve të papara dhe vrasjeve makabre nga bashkëqytetarët e tyre. Kjo dhunë rezultoi me shpërnguljen e myslimanëve në vitin 622, nga Meka në Medinë, qytet ky rreth 460 km larg Mekës. Vetë ngjarja, shpërngulja do të njihet me emrin *Hixhreti*. Këtë ndodhi myslimanët e morën si fillim të kalendarit mysliman.

Vetëm pas gati një dekadë vuajtjesh por edhe një organizimi të shkëlqyeshëm, myslimanët arritën të kthehen në Mekë, kur ndodhi Çlirimi i Mekës, me mjete paqësore, pa hakmarrje, pa dhunë, duke ua falur dhunën dhe padrejtësitë që mekasit ua patën shkaktuar dikur. Para se Muhamedi (a.s.), të vdiste, shumica e Arabisë ishte bërë myslimane.

Ç'ËSHTË KURANI?

Kurani është burimi kryesor i fesë islame. Ai është përmbledhje e fjalëve (porosive) që Zoti ia shpalli Muhamedit (a.s.), nëpërmjet melekut Xhibril, pjesë-pjesë, për 23 vjet. Muhamedi (a.s.), i mësoi përmendsh dhe njëkohësisht ua diktoi shokëve të tij ta shkruanin. Tekstin e shkruar e ka kontrolluar disa herë gjatë jetës së tij. Teksti që sot kemi në duar, është autentik nga koha e Muhamedit (a.s.), i paprekur, i pandryshuar, i pazëvendësuar dhe i tillë do të mbetet përgjithmonë. Edhe si tekst edhe si përmbajtje, Kurani është i paarritshëm, mrekulli, i jashtëzakonshëm, unikal (mu'xhize) dhe i tillë do të mbetet deri në fund të kësaj bote. Në aspektin fizik Kurani ka pësuar ndryshime, sepse çdo kohë ka lënë gjurmët e veta. Fillimisht është shkruar në lëkura, lëvore drunjsh, rrasa guri e të tjera, kurse më vonë në papirus, letër, e pastaj nga mënyra e dorës u kalua në mënyrën e shtypshkronjës e krejt së voni, deri te format elektronike.


PËR ÇFARË TEMASH FLET KURANI?

Kurani është fjala e fundit e Allahut në skenën historike. Ai paraqet burimin kryesor të myslimanëve në pikëpamje shpirtërore dhe fizike. Kurani trajton të gjitha temat me rëndësi për njeriun: botën paraekzistenciale, këtë botë dhe botën përtej. Gjithashtu, trajtohen temat rreth urtësisë, besimit, lutjeve, ligjit, pastaj temat e pejegambereve pararendës, për shoqërinë në përgjithësi, aspektet ekonomike, politike, pastaj rrëshqitjet e shumë popujve, flitet për kozmosin, shtazët, bimët, flitet për botën e padukshme si: engjëjt, xhinët, djajtë etj. Megjithatë, tema qendrore në Kurani është Allahu dhe krijesat e Tij e sidomos njeriu.

CILAT JANË BURIMET DYTËSORE TË FESË ISLAME?

Hadithi apo Suneti është burimi i dytë i fesë islame. Besimi në të është pjesë përbërëse e Islamit, kurse mohimi apo përbuzja e tij është vepër joislame. Hadith janë fjalët, kurse Sunet janë veprat, lejimet, pëlqimet, rekomandimet dhe shembujt e pejegamberit të Allahut (xh.sh.), Muhamedit (a.s.).

Ekzistojnë edhe burimet dytësore, si Ixhmai (analogjia) dhe Kijasi (Konsensusi) dhe burimet terciare (urfi, istihansi etj.), të cilat mbulojnë zbrazëtitrat juridike të jetës së myslimanëve ndërmjet veti dhe të myslimanëve në raport me të tjerët. Të gjitha burimet dytësore dhe tretësore duhet të jenë në pajtim të plotë me Kuratin dhe Sunetin.



KALVARI I HIPOKRIZISË SË KRITEREVE

Nuredin Nazarko

Rendi natyror i gjërave i kërkon njeriut që, për të siguruar jetesën, të ushtrojë një profesion të caktuar në një fushë të caktuar, duke marrë në konsideratë dhe jo pa qëllim, përputhshmërinë mes natyrës që shpërfaq individi dhe profesionit që mëton të kryejë. Dinamika e zhvillimeve në kohët e sotme është kaq e vullshme dhe sugjestionuese, saqë me apo pa dashje, të zhvendos drejt domosdoshmërisë së arsimimit, të zhvendos drejt detyrueshmërisë për t'u arsimuar, pasi vetëm nëpërmjet një arsimimi të mirfilltë dhe diplomimit në një fushë të caktuar të njohurive, mund të jesh një kandidat potent për të pretenduar punësim, sipas fushës në të cilën ke përfunduar studimet universitare apo postuniversitare. Qenia njerëzore është krijuar për të qenë ambicioze dhe ambiciet që ushqejnë, qoftë i sapodiplomuari apo i punësuar, i shtyjnë drejt pretendimeve për të qenë pjesë e garës për vendet e lira të punës, i pari për t'u stabilizuar në punë e pse jo edhe për karrierë, ndërsa i dyti me shpresën për të bërë karrierë në fushën e njohurive për të cilën, si i pari ashtu dhe i dyti kanë derdhur mund, djersë, energji, me besimin se për të qenë kandidat i denjë për përgjegjësinë që kërkon të marrë, duhet të jetë kompetent, i aftë në kryerjen e përgjegjësisë që sipërmerr. Duke besuar apo duke qenë një pragmatist që kërkon të provojë shansin, sapo informohet për vendin e lirë të punës, interesohet me mirësjellje, ashtu sikundërse e kërkon edukata, pranë institucionit përkatës. Po me mirësjellje përcillet së bashku me fletët e kriterëve që duhet të plotësojë kandidati, që kërkon të jetë pjesë e garës për vendin e lirë të punës. Ndihet i emocionuar, sepse po i jepen shanse të barabarta me kandidatët e tjerë për të qenë konkurrent që tashmë i erdhi ora për të shpalosur aftësitë e tij, për të cilat ka ngacmuar dhe stërmunduar shpirtin dhe trurin e tij në ditë dhe net të gjata sflitëse, ku i ulur mbi libra përpinte çdo shkronjë të shtypur mbi fletët e tyre. Pasi njihet me kriteret, fillon e përgatit dosjen e konkurimit, ashtu siç e kërkon procedura. Me përfundimin e dosjes së konkurimit, nisët të bëjë dorëzimin e saj dhe më pas të presë po sipas kriterëve të procedurës, një afat të përcaktuar kohor, afat që i nevojitet komisionit shqyrtues që "të zbërthejë deri në një" përmbajtjen e dosjeve të kandidatëve, për të kuptuar sa u vlen lëkura konkurrentëve. Përveç konkurimit me dosje, ka edhe një element tjetër që duhet të ndiqet për efekt të procedurës, intervista me të gjithë kandidatët konkurrentë, në mënyrë që komisioni shqyrtues i dosjeve, t'i vlerësojë kandidatët, jo vetëm nëpërmjet shifrave dhe kartonave, që mund t'i blesh gjithandëj në ditët e sotme, por duke marrë në konsideratë formimin, përmbajtjen dhe aftësitë intelektuale të kandidatëve, pasi shifrat dhe kartonat mund të rezultojnë me një formë pa përmbajtje. Pret kandidati të njoftohet për intervistën, me shpresën se aty do të dalë edhe më në pah intelektualiteti i tij, por ja që intervista dhe bashkë me të edhe dorëzimi i dosjes na paskësh qenë thjesht për efekt procedure.

Dhe këtë e mësoi pikërisht atëherë, kur mendonte se, meqënëse do të ketë garë, do të ketë në mos drejtësi dhe ndershmëri të plotë, transparencë të vlerësimit të kandidatëve, në prani jo vetëm të komisionit, por dhe të vetë kandidatëve, në mënyrë që të bindte veten se nuk e meritonte, sipas meritokracisë, përgjegjësinë që kërkonte të merrte mbi shpatullat e tij. Dhe ja, ata të cilët në emër të intelektualizmit, sërëtin kriterë pa fund, shkelin me të dyja këmbët një kriter mjaft të rëndësishëm, transparencën dhe mbi të gjitha, themelin e gjithçkaje, drejtësinë. Kësisoj, konkurrentët vazhdojnë të rropaten në fryrjen e dosjeve me përplotësim të kriterëve, që lançohen teorikisht nga ata të cilët shkelin kriteret, ndërkohë që të tjerë konkurrentë, që përplotësojnë kriteret ashtu siç i kërkon procedura praktike e entit rregullator të taraveve, arrijnë të katapultohen sipas fuqisë së kriterëve që kanë plotësuar. Mbi bazën e kësaj skeme vlerësimi, qyshse njeriu iu përshtat skemave që si çibanë shprishën bukurinë e të qenit njeri, eliminohen kandidatë që për hir të intelektualitetit të tyre, duhet të suporheshin për të qenë pjesë e stafëve të caktuara, që të kontribuonin për një ecuri më të mirë të punëve që do të merrnin nën përgjegjësinë e tyre intelektuale. Mirëpo, enti rregullator i taraveve ka vendosur të mos kooptojë asnjë kandidat, mirëfillti intelektual, përderisa nuk u nënshtrohet rregullave të lojës që ky ent i zbaton me një fshehtësi të dukshme ditën nëpër diell.

Natyrshtëm shtrojmë pyetjen se përse veprohet kësaj? Dhe ja, përgjigjja më kuptimplote na vjen përmes penës së shkrimtarit të madh botëror, Fjodor Dostojevskit. "Sipas tyre, nuk është njerëzimi me zhvillimin e tij historik, të gjallë, ai që shndërrohet në shoqëri normale, por, përkundrazi, është sistemi social, pjellë e ca përlllogaritjeve matematike, ai që e rregulloka njerëzimin, e bëka më të drejtë, pa cene. Sipas tyre, kjo ndodh jashtë çdo procesi të gjallë, pa kaluar nëpër një rrugë të caktuar historike! Ata ndaj dhe s'e duan historinë: "Shëmnia dhe idiotizmi e kanë mbytur!" - dëgjon nga goja e tyre. Nuk e kanë për zemër procesin e gjallë të jetës, nuk u duhet shpirti i gjallë, sepse ai vetëm kërkon, vetëm dyshon, nuk u nënshtrohet ligjeve të mekanikës, është frymë e vjetër. Le të qelbë era e coftinës, le të jetë i bërë prej gome, por kryesore është të mos ketë jetë, të mos ketë vullnet, të mos ngrejë krye e të mos protestojë! Dhe del që tërë puna përqendrohet në mënyrën e vendosjes së tullave, të ndërtimit të korridoreve dhe të dhomave, në ngritjen e karabinasë. Bukur fort! Karabinaja është gati, ndërsa ata që do hyjnë nuk janë gati, u mungon jeta, s'e kanë kaluar procesin jetësor! Vetëm me logjikë nuk superohet natyra njerëzore!... S'ke si e mbledh gjithçka në një fokus, në çështjen e komoditetit! Kjo do të thotë t'i thjeshtëzosh gjërat, t'i servirësh aq të qarta, saqë as për të menduar nuk ka nevojë fare! Kjo është kryesore: të mos ketë nevojë për të menduar!" (Krim dhe ndëshkim, Tiranë 2009: 249-250)

Ndershmëria dhe Besueshmëria

JANË CILËSITË BAZË TË NJERIUT BESIMTAR

Ali Riza Jemel

Islami është një fe e dërguar për ta lartësuar njeriun në gradën e përsosjes. Kjo fe ka vendosur disa parime etike për të arritur te ky synim. Këto parime janë universale për çdo kohë dhe njeriu i sotëm duhet t'i zbatojë ato, për të arritur gradën e përsosmërisë.

Disa prej atyre parimeve morale universale janë: ndershmëria, drejtësia, besueshmëria, mbajtja e premtimit, dëlirësia, toleranca dhe bujaria. Në këtë shkrim dëshirojmë të shtjellojmë ndershmërinë dhe besueshmërinë.

NDERSHMËRIA, KARAKTER I FORTË ETIK

Ndershmëria përkufizohet në këtë mënyrë: Zbatim i regullave moralo- etike në të folur, karakter i fortë etik dhe mbajtje e drejtësisë në fjalë e në sjellje. Ndershmëria është qetësi dhe paqe me veten. Shkurtimisht, është një domosdoshmëri e lumturisë.

Ndershmëria është një nga parimet etike themelore, së cilës feja jonë e lartë, Islami, i ka dhënë shumë rëndësi. Allahu i Lartmadhëruar thotë:

“(O Muhamed!) qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Kështu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty; e mos i kaloni kufijtë, sepse Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që ju veproni.” (Hud, 112.)

Në ajet ndodhen dy parime që formojnë bazën e Islamit: të qëndrosh i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je urdhëruar dhe të mos i kalosh kufijtë, d.m.th., të mos dalësh jashtë kufijve që ka caktuar Allahu. Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar urdhëron, krahas besimtarëve edhe

Pejgamberin, sallallahu alejhi ve sellem, të qëndrojë i patundur në parimet e kufijtë që ka vendosur Ai.

Allahu na tregon se i shikon gjërat që ne bëjmë dhe na paralajmëron të mos anojmë nga të padrejtët. Po ashtu, na paralajmëron se, nëse e lëmë drejtësinë dhe ndershmërinë, do të hyjmë në xhehenem. Kështu që nuk do të kemi asnjë mik dhe asnjë ndihmëtar.

Transmetohet se Abdullah b. Abbas ka thënë kështu, në lidhje me këtë ajet: “Në të gjithë Kuranin nuk ka zbritur ndonjë ajet më i rëndë dhe më i vështirë se ky, për të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem. Për këtë arsye, Pejgamberi ynë i Nderuar ka thënë: *“Surja Hud dhe motrat e saj më kanë plakur.”* (Tirmidhi, Tefsiru'l-Kur'an, 57, V, 402.)

Pika e vështirë në këtë ajet, që e ka bërë të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, të thotë se e ka plakur, është pjesa e urdhrit për qëndrueshmëri, e cila ka lidhje me umetin më shumë se ajo që ka lidhje me veten e tij, sepse në ajet njoftohet se urdhri **“Kështu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty”**, është i vlefshëm edhe për besimtarët. Kështu, siç nuk ka pozitë më të lartë se istikameti (qëndrueshmëria në fe), po ashtu nuk ka as urdhër më të vështirë se ai.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, kish-te vendosmëri dhe vullnet për t'i kryer të gjitha detyrat që i kishte obliguar Allahu i Lartmadhëruar. Megjithëse kushtet nuk ishin të favorshme, ai i përdori deri në fund aftësitë dhe mundësitë e tij, në një mënyrë që i kishte hije madhështisë së çeshjtes që kishte marrë përsipër. Në ajetin e mësipërm, Allahu i Madhëruar dëshiron vazh-

dimin e kësaj nga Pejgamberi dhe nga ata besimtarë që e pasojnë.

Hazreti Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, i cili u dërgua si udhëzuesi më i mirë, ishte edhe një shembull për drejtësinë dhe ndershmërinë. Njëri prej qëllimeve më të mëdha të tij ishte formimi i një shoqërie prej njerëzve të drejtë dhe të ndershëm. Nisur nga kjo, së pari u bë vetë shembull në drejtësi dhe ndershmëri. Brendësia e tij me aparencën dhe fjala me zemrën ishin një.

Në një thënie tjetër, ai shfaqej siç ishte dhe ishte siç shfaqej. Ishte e pamundur të gjeje ndonjë ndryshim ndërmjet atyre që thoshte dhe atyre që bënte. Ai u përpoq përgjatë gjithë jetës së tij për t'i shpënë njerëzit te drejtësia dhe ndershmëria.

Një ditë, i erdhi një sahabi, i cili quhej Sufjan eth-Thekafi dhe i tha:

- O i Dërguari i Allahut! Më jep një këshillë për Islamin, në mënyrë që të mos kem nevojë të pyes dikë tjetër pas teje. Pejgamberi ynë i Nderuar i tha:

- Thuaj: "I besova Allahut dhe pastaj qëndro i patundur në këtë fe." (Muslim, Iman, 62.)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.), e ka përmendur drejtësinë dhe ndershmërinë pas besimit ndaj Zotit. Në këtë mënyrë, bëri një lidhje ndërmjet drejtësisë dhe besimit ndaj Zotit. Në një hadith tjetër ka thënë:

"Jini të drejtë, sepse drejtësia ju shpie në mirësi. Ndërsa kjo e fundit, ju shpie në xhenet. Nëse robi bëhet i drejtë dhe gjithmonë bën punë të drejta, te Allahu shkruhet si besnik. Largohuni nga gënjeshtria. Gënjeshtria e shpie njeriun në mëkat. Ndërsa ky i fundit e shpie në xhehenem. Nëse njeriu gënjen vazhdimisht dhe punon duke gënjyer, te Allahu shkruhet si gënjeshtar." (Buhari, Edeb, 69.)

Në një hadith tjetër, që ka lidhje me temën tonë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

"Më jepni fjalën për gjashtë çështje, në mënyrë që edhe unë t'ju jap fjalën se do të hyni në xhenet:

1. Kur të flisni, flisni drejt! Po, sjelljet dhe fjalët tuaja le të jenë të drejta dhe kurrë mos u ndani nga drejtësia.

2. Kur të premtoni, mbajeni fjalën! Nëse veproni të kundërtën, atëherë ajo është hipokrizi.

3. Jini besnikë ndaj amanetit! Nëse në një vend ku ju besojnë, ju jepet amanet ndonjë gjë, mos i zhgënjeni ata të cilët pandehin se jeni të besueshëm.

4. Jini të ndershëm! Ruajeni nderin dhe namusin tuaj. Po ashtu, ruajeni nderin dhe namusin e të tjerëve, sikur mbroni

nderin dhe namusin tuaj!

5. Mbyllini sytë ndaj haramit! Mos i shikoni gjërat që nuk ju përkasin dhe mos ua ngulitni sytë gjërave prej të cilave e keni të ndaluar të përfitonit. Shikimi në haram e prish zemrën.

6. Mos i dëmtoni të tjerët! Askujt mos i bëni keq në asnjë llojë mënyrë! (Ahmed b. Hanbel, V, 323.)

Një njeri, i cili i plotëson kushtet që përmenden në këtë hadith, jeton i sigurt në këtë botë dhe në këtë mënyrë, e ka siguruar edhe ahiretin. Pejgamberi ynë i Nderuar, siç ka qënë i drejtë dhe i ndershëm përgjatë gjithë jetës së tij, i ka urdhëruar edhe besimtarët gjithmonë për drejtësi dhe ndershmëri.

Siç shikohet nga ky ajet dhe nga këto hadithe, ndershmëria ka një vend dhe rëndësi të veçantë në fenë islame, sepse ndershmëria është prej kushteve të domosdoshëm të ndërgjegjes së njeriut dhe strukturës së shoqërisë së shëndoshë. Po ashtu, është prej detyrave më të rëndësishme që njeriu ka ndaj personalitetit të tij.

GJËRAT QË NDESHMËRIA I JEP NJERIUT

Ndershmëria është kushti i parë dhe më i rëndësishmi për t'u bërë njeri i besueshëm në shoqëri. Të gjithë e duan atë njeri që nuk gënjen, që nuk bën hile në punë dhe që nuk shtret në gjendjen dhe situatën e tij. Edhe nëse nuk e duan, e vlerësojnë.

Ndershmëria sjell një jetë të bukur, të sigurt dhe plot qetësi. Allahu i Lartmadhëruar thotë kështu, për ato gjëra që ndershmëria i jep njeriut: "Pa dyshim, ata që thonë: "Zoti ynë është Allahu!" dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t'u frikësuar e as për t'u dëshpëruar (kur t'u vijë vdekja)." (el-Ahkaf, 13.)

"Me të vërtetë, atyre që thonë: "Zoti ynë është Allahu", e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: "Mos u frikësoni, mos u pikëlloni dhe gëzojuni xhenetit që ju është premtuar." (Fussilet, 30)

Në këto ajete njoftohet se, ata që i besojnë Allahut, që janë të drejtë e të ndershëm, nuk do të brengosen, nuk do të mërzhiten dhe do të hyjnë në xhenet përgjithmonë, si shpërblim për veprat e mira që kanë bërë në këtë botë.

Ndershmëria është një prej faktorëve më të rëndësishëm e të domosdoshëm për arritjen e një jete të qetë, të sigurt, të sistemuar, të gëzuar dhe të kënaqshme nga aspekti individual e shoqëror. Ajo është një virtyt etik, i cili ka lidhje me të gjitha fushat e jetës, duke filluar nga marrëdhëniet personale e deri te marrëdhëniet shoqërore, nga aktivitetet

**"Me të vërtetë,
atyre që thonë:
"Zoti ynë është Allahu",
e pastaj vazhdojnë të vendosur
në rrugën e drejtë, do t'u zbresin
engjëjt (para vdekjes)
e do t'u thonë: "Mos u frikësoni,
mos u pikëlloni dhe gëzojuni
xhenetit që ju është premtuar."**

(Fussilet, 30)



Allahut? Pa dyshim, unë jam i dërguar besnik për ju, pandaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua!” (esh-Shuara, 123-126.)

NE JEMI UMETI I NJË PEJGAMBERI TË BESUESHËM

Besueshmëria është njëra prej pesë cilësive, që patjetër duhet të gjendet te pejgamberët. Në të njëjtën kohë, kjo shpreh kuptimin dhe rëndësinë e kësaj cilësie të vyer. Kjo cilësi tregon se pejgamberët janë të besueshëm në çdo aspekt. Është e paimagjinueshme që një njeriu, të cilit nuk i besojnë njerëzit, t’i jepet detyra e profetësisë, sepse pejgamberi është një i dërguar ndërmjet Allahut dhe robërve të tij. Nëse një njeri i tillë nuk do të ishte i besueshëm, a do t’i besonin njerëzit dhe do t’ia dëgjonin fjalën?

Ja pra, besueshmëria ishte cilësia më e rëndësishme edhe e Muhamedit, sallallahu alejhi ve sellem, ashtu siç ishte më e rëndësishme edhe për të gjithë pejgamberët e tjerë. Kështu, njëra prej specifikave, me të cilën Hz. Pejgamberi ishte shembull për umetin e tij, ishte cilësia e besueshmërisë.

Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, ishte një njeri që u jepte siguri njerëzve, sepse ai ishte Muhamedu’l-Emin. Madje që herët, që kur ishte i ri, domethënë njëzet – njëzet e pesë vjet para se të shfaqej Islami...

Përse iu dha atij cilësia e besueshmërisë? Sepse njerëzit e shikonin atë besnik në çdo aspekt. Kush ia pati dhënë cilësinë e besueshmërisë atij? Së pari, këtë cilësi ia dhanë fisnikët e popullit të tij. Fisnikët ishin të sigurt se ai nuk do të tallej me fisnikërinë e tyre. Tregtarët ishin të sigurt se ai nuk u bënte dredhira atyre në shitblerje.

Po, ai ishte shembull i sigurisë. Sepse të gjitha sjelljet e tij e tregojnë këtë, që nga fëmijëria. Të varfrit e shikonin atë si një vend strehimi. Ata ishin të sigurt se padrejtësisë së tiranëve mund t’i dilnin kundra vetëm me të. Këtë kategori mund ta shtojmë dhe mund ta shumojmë. Atëherë, besueshmëria dhe siguria që ka sjellë Islami, janë përjetuar realisht në personalitetin e Pejgamberit.

BESUESHMËRIA DHE TRADHTIA NUK MUND TË QËNDROJNË BASHKË

Fakti që Pejgamberi ishte i besueshëm, ka një rol të madh në suksesin që ka arritur feja islame. Sikur të ishte një njeri i pabesueshëm në sjellje, njerëzit nuk do të mbledheshin rreth tij. Hz. Pejgamberi, siç nuk ka tradhtuar njerëzit dhe pasuritë e tyre, po ashtu nuk ka tradhtuar edhe pasurinë e popullit. Kështu, pas Luftës së Hunejnit, qëndroi në vendin ku ishin mbledhur plaçkat e luftës, mori një qime nga gunga e devesë së tij dhe tha:

tregtare e profesionale e deri te detyrat civile. Ajo duhet të zbatohet patjetër, në të gjitha këto fusha.

Nisur nga kjo, ndershmëria përfshin të qenit i drejtë dhe i ndershëm në njet, në mendim, në vullnet, në shpirt, në fjalë dhe në të gjitha punët e sjelljet e tjera.

NDERSHMËRIA ËSHTË CILËSI E PEJGAMBERËVE

Siguri do të thotë ndijesi për të besuar dhe për t’u lidhur pa u frikësuar e pa ndjerë dyshim, konfidencë. Ndërsa besueshmëria, shpreh gjendjen e të qenit i besueshëm.

Besueshmëria, e cila është prej cilësive më të rëndësishme të moralit të bukur, në të njëjtën kohë është edhe cilësi e përgjithshme e pejgamberëve. Kurani Fisnik bën fjalë në shumë ajete për këto cilësi. Këtu dëshirojmë të përmendim dy prej tyre:

“Populli i Nuhut i quante gënjeshtarë të dërguarit. Kujto kur vëllai i tyre, Nuhu, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni Allahut? Në të vërtetë, unë jam një i dërguar besnik për ju, pandaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua!” (esh-Shuara, 105-108.)

Ja pra, siç shikohet edhe në këtë ajet, Nuhu, alejhisselam, shprehet se është një pejgamber që e ruan amanetin dhe që nuk tradhëton kurrë. Popullit të vet i tha: “Unë jam një i dërguar besnik për ju.”

“Populli i Adit i quante gënjeshtarë të dërguarit. Kujto kur vëllai i tyre, Hudi, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni

"O njerëz! Unë nuk e dua plaçkën e luftës, qoftë edhe sa kjo qimë!" (Ibn Maxhe, Xhihad, 34.)

Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, gjithmonë i këshillonte shokët e tij të ishin të besueshëm. Thoshte se tradhtia, e cila është e kundërta e besueshmërisë, është një sjellje shumë e shëmtuar. Edhe sahabët e kanë njohur Hazretin Pejgamber si njeri të besueshëm dhe qenë lidhur ndaj tij me një besueshmëri të pafundme.

Hazreti Pejgamberi ka njoftuar se ndërmjet besimit dhe besueshmërisë ka një lidhje shumë të fortë. Ja disa fjalë të tij, në lidhje me këtë çështje:

"Në zemrën e njeriut nuk qëndrojnë bashkë besimi dhe mohimi. Besueshmëria dhe tradhtia nuk qëndrojnë bashkë." (Ahmed b. Hanbel, II, 349.)

"Besimtarë janë ata njerëz, që u zihet besë." "Mysliman është ai njeri, me të cilin myslimanët e tjerë janë të sigurt." "Betohe në Allahun, në dorën e të Cilit është shpirti im, se nuk mund të hyjë në xhenet ai njeri, fqinji i të cilit nuk është i sigurt prej ligësive të tij." (Ahmed b. Hanbel, III, 54.)

GJËRAT QË BESUESHMËRIA I JEP NJERIUT

Ndjenja e besueshmërisë duhet të gjendet në çdo klasë dhe në çdo fushë të shoqërisë. Shoqëria arrin një strukturë të shëndoshë, kur prindërit i besojnë në fëmijës, kur fëmija u beson prindërve, kur bashkëshortët i besojnë njëri-tjetrit, kur eprori i beson nëpunësit, kur nëpunësi i beson eprorit, kur punëtori i beson punëdhënësit, kur punëdhënësi i beson punëtorit, kur shitësi i beson klientit dhe kur klienti i beson shitësit.

Këtu duhet të ndalemi pak mbi besueshmërinë në shitblerje, së cilës Hazreti Pejgamberi i ka dhënë shumë rëndësi. Së pari, duhet të sqarojmë se besueshmëria e ndërsjelltë është baza e tregtisë dhe e shitblerjes, të cilat Islami i ka shtjelluar dhe u ka dhënë shumë rëndësi.

Kur të humbasë besimi në tregti dhe kur të përhapet pasiguria, te njerëzit natyrisht zhvillohet ndjenja e dyshimit dhe e kujdesit që duhet të kenë ndaj çdo lloj gjëje. Lidhjet shpirtërore ndërmjet njerëzve dobësohen. Po ashtu, lind drujtja dhe urrejtja. Një gjë është e sigurt: asnjë njeri nuk e do dhe nuk e respekton, madje e urren atë që mashtron apo mundohet të mashtrojë.

Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, na njofton se besueshmëria në tregti, bëhet shkak për begati dhe beqet. Ai thotë se besueshmëria është risk, ndërsa tradhtia sjell varfëri. (Kuzai, Shihabu'l-Ahbar, (përk. Ali Jardëm), Botimet Damla, Stamboll, 1999, fq.43.)

Me besueshmëri këtu synohet siguria në fjalë dhe në punë. Njerëzit hezitojnë të formojnë lidhje me njerëz të pabesueshëm në fjalë dhe në vepër. Nëse një njeri i tillë merret me tregti, atëherë njerëzit e tjerë druhen nga shitblerja me të. Nëse është klient, nuk i japin mall dhe, nëse është artist, nuk i japin porosi. Për këtë arsye, nevoja ndaj mallrave e veprave të këtyre njerëzve bie ndjeshëm dhe fitimet nuk u shtohen. Ja, këtu qëndron urtësia e fjalës së Pejgamberit:

"Tradhtia sjell varfëri."

Por, nëse ndodh e kundërta, domethënë, nëse të gjithë i besojnë njëri-tjetrit, shtohet fitimi, prodhimi dhe konsumi. Kjo i hap rrugë begatisë dhe pasurisë.

SI PËRFUNDIM

Islami është një fe, e cila e zhvillon shpirtin e njeriut, e pastron ndërgjegjen e tij dhe i jep drejtim ndjenjës njerëzore. Ajo gdhend në zemrat dhe në kokat e njerëzve me plot madhështi dashurinë, fuqinë dhe drejtësinë e Allahut. Ajo urdhëron mëshirë të ndërsjelltë ndërmjet njerëzve, njeriun nuk e lë të preokupohet vetëm me stomakun e tij, e tërheq nga sjelljet e cilësitë shtazore dhe e pjek në furrën e virtytit të njerëzisë.

Në këtë mënyrë, feja islame i ngarkon shumë përgjegjësi njeriut, ia bën të qartë se liria e pakufishme devijon në padrejtësi e errësirë dhe dashurinë në shërbim e vlerëson nga dy aspekte: si shërbim ndaj Allahut dhe si shërbim ndaj njerëzve. Nisur nga kjo, Islami kërkon nga myslimani që të bëhet një njeri i drejtë, i ndershëm dhe i besueshëm në mjedisin që e rrethon.

Në kohën e Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, myslimanët ishin në kulmin e drejtësisë dhe besueshmërisë, të cilat janë virtyte etike. Ndërsa në ditët e sotme, njerëzit po përjetojnë një rënie morale. Veçanërisht, ndërmjet njerëzve po përjetohej një krizë në çështjen e ndershmërisë dhe të besueshmërisë.

Në një shoqëri, ku individët nuk sillen drejt dhe me ndershmeri ndaj njëri-tjetrit, nuk mund të bëhet fjalë që ata t'i besojnë shoqi-shoqit. Në një shoqëri që nuk ka ndershmeri dhe besueshmëri, nuk mund të ketë paqe dhe qetësi.

Kjo gjendje që po dominon te njerëzit, na tregon në mënyrë të qartë se sa nevojë kemi sot për parimet universale që ka sjellë Kurani fisnik. Ja, si në çdo gjë tjetër, edhe në çështjen për të qenë një njeri i ndershëm, i drejtë dhe i besueshëm, ne duhet ta përsosim moralin tonë me moralin e Kuranit dhe të marrim për shembull Pejgamberin, sallallahu alejhi ve sellem.

*"Betohe në Allahun,
në dorën e të Cilit është
shpirtim im, se nuk mund
të hyjë në xhenet ai njeri,
fqinji i të cilit nuk është
i sigurt prej ligësive
të tij."*



Jeta si ripohim i paktit të kryehershëm me Zotin

Vehap S. Kola

I gjithë angazhimi njerëzor në jetë mund të përkufizohet kështu: ripohim i paktit të kryehershëm me Zotin. Është fjala pikërisht për atë pohim, betim, besëlidhje, e cila që në kryehershmëri qëndron në themel të marrëdhënies ndërmjet njeriut dhe Zotit dhe i jep frymëmarrje vetë vazhdimësisë së shoqërisë njerëzore. Historia e ekzistencës së njeriut nis atëherë *"Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre: "A nuk jam Unë Zoti juaj?" Ata u përgjigjën: "Po, dëshmojmë se Ti je." Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: "Këtë nuk e kishim ditur."*¹ Që atë çast, njeriu është i ngarkuar me përgjegjësinë për ta ripohuar këtë pakt përmes jetës, pa mundësinë për ta tjetërsuar apo transferuar këtë përgjegjësi. Përpjekjes së disa shoqërive për të zhveshur veten nga pesha e këtij amaneti, Zoti i përgjigjet *"Mbajeni fort atë që ju dhamë dhe kujtoni çfarë përmban ajo, që të ruheni nga gjynahet."*²

Sot, shoqëria njerëzore përpëlitet në të njëjtën përpjekje shfajësuese dhe arratiake dhe për pasojë, mbi kokat e njerëzve bën hije mali i peshës së shfajësimit për braktisjen e besëlidhjes. Ndërsa dimë përfundimin e historisë, së cilës i referohet Kurani, ne nuk jemi aspak të sigurt rreth përfundimit që do të ketë ajo e jona. Ne jemi të sigurt vetëm për hapësirën e mundshmërive të saj: nëse e pohojmë besëlidhjen e vjetër, do të mund të vazhdojmë jetën, në të kundërt, mali do të bjerë mbi ne dhe jeta e shoqërisë njerëzore mund të ndërpritet. Është frikëndjellëse të dëshmosh sesi ne, njerëzit, ashtu si jemi sot dhe me atë drejtim që kemi, kemi zgjedhur një rroku-

llisje drejt mundësisë më të keqe, asaj fatales. Nevojitet një kthim i shpejtë dhe i fortë drejt besatimit të moçëm, që kjo mundësi të mos bëhet e pashmangshme.

Debatit se ku është e ruajtur dhe kush është dëshmitar i kësaj marrëveshjeje midis Allahut dhe bijve të Ademit, i jep fund vetë qenia e njeriut. Ajo gëzon, trashëgon, përmban në thelb të saj këtë betim në formën e natyrës së pastër burimore. Është kjo arsyeja pse të shpëtuar, në ditën e Gjykimit, do të quhen ata që dalin përpara Zotit të tyre me zemër të pastër. Është ruajtja e pastërtisë së zemrës, që Zoti ka vendosur në njeriun, ajo që garanton rikonfirmimin e kërkuar të paktit të kryehershëm. Në ç'shikallë është ruajtur kjo natyrë burimore e zemrës, përcakton edhe forcën me të cilën njeriu aspiro të njohë dhe dëshmojë Zotin në unitet të kulluar. E thënë më ndryshe, është qartësia e jehonës së atij pohimi – *"Po, dëshmojmë se Ti je."* – kumbimi i tij në zgafellat e qenies njerëzore, që shkakton këtë aspiratë të njeriut.

Kurani, ashtu si vetë krijimi i njeriut përsëpari, i bën jehonë këtij pakti dhe i bën apel njeriut të kthejë sytë nga vetja, ashtu si nuk i bën apel kaq të fortë të hedhë vështrimin jashtë tij. Sepse gjurma më e qartë dhe, me gjasë, më e ruajtur e kësaj besëlidhjeje gjendet pikërisht në vetë njeriun. Me leximin ritual të tij, myslimani e rigjen atë gjuhë të vjetër dhe e rishqipton atë aspiratë, duke e ripërtërirë dhe realizuar potencialisht. *"Fjala është një kumbim i brendshëm."* Ky kumbim buron pjesërisht (në mos kryesisht) nga objekti që shënon fjala. Por, nëse nuk e shohim vetë objektin dhe dëgjojmë thjesht emrin e tij,

1. Kuran, surja El-A'raf, 172.

2. Kuran, surja El-A'raf, 171.

në kokën e dëgjuesit lind një imazh abstrakt, një objekt i çmaterializuar që ngjall menjëherë dridhje në zemër³. Por Kurani nuk është një hajmali, një formulë e pakuptueshme apo një relike magjike. Ai ofron parimet udhëheqëse të jetës, që rikonfirmon paprerë besëlidhjen e vjetër.

* * *

Myslmanët e shekullit të njëzetë dhe njëzetënjëtë janë të troshitur ndërmjet objektivash qendërikëse të suksesit, progresit dhe mirëqenies. Islami u mëson atyre të bëjnë një jetë të moderuar, të drejtë dhe shpirtërore. Mësimet e fesë u thonë atyre të mos derdhen në konsum, luks dhe kënaqje, pasi ky është trualli i teprimit, shpërdorimit dhe idhujtarisë. Vënia e jetës në shërbim të përjetësisë, apo shërbimi ndaj jetës si një synim autonom, kjo është dilema. Në fakt, përgjigja në rrafshin teorik është e qartë: jeta është një mundësi, jo një synim. Çfarë ngjall diskutim është sfera e konkretes, e të përditshmes dhe fusha e veprimit të myslimanit të thjeshtë. Sharrimet moderne të kuptimeve të gjërave në fenë islame, e kanë kthyer dukshëm vështrimin e myslimanit nga kjo botë.

Të jesh mysliman i gjithëfarlojshëm është e mundur sot: mysliman praktikant, modern, progresist, evropian, amerikan, paqësor, moderator, i vërtetë etj. Mirëpo, të gjithë këta togfjalësh gjymtues e përdorjnë emrin mysliman si një identitet socio-politik, si një përkatësi solidare, si një model sociologjik e që këtej, injorojnë thelbin e ngarkesës kuptimore e intelektuale dhe kuadrin e plotë të pritshmërive që duhen përbushur për të merituar këtë emër. Por, pasi e ka zhbërë myslimanin bashkëkohor përmes asaj makinerie instrumentash dhe metodash mendjebjerrëse dhe shpirtngurtësuese, qytetërimi bashkëkohor i dëftën atij se mund ta gëzojë titullimin mysliman, vetëm duke trajtësuar atë sipas karakterizimeve të reja, kryekreje të palidhura me, dhe shpeshherë reduktuese të qenësisë myslimane.

Të jesh mysliman, sipas kuptimësisë dhe ngarkesës që mbart ky nocion, është ajo që kërkohet dhe mjafton për njeriun. Meqenëse, nuk është e mundur të shkruhet një platformë e plotë apo manual i hollësishëm i myslimanit shembullor, është e mundur të theksojmë çfarë mungon më shumë në jetën e besimtarit mysliman shqiptar: shpirtërorja e mirëfilltë. Në vend që të keqkup-

3. Vasili Kandinski, *Mbi Shpirtëroren në Art*, Botime Perpjekja, Tiranë 1998, fq. 38.

tohet si një shtim sasior i adhurimeve, jeta shpirtërore duhet të kuptohet si një shtrirje e pranisë së përmasës shpirtërore të gjërave në të gjithë veprimtarinë e njeriut. Jeta shpirtërore duhet të konsistojë në përkushtimin në adhurim, përkushtimin e tërësishtëm ndaj Allahut, Më të Lartit, mospërfillje ndaj stolive dhe bukurisë së botës, vetëpërmbytje nga kënaqësia, pasuria dhe prestigji i vërejtur në shumicën e njerëzve dhe veçimi prej të tjerëve për të adhuruar në vetmi. Ky ishte rregulli i përgjithshëm i shokëve të Profetit (a.s.).

Gjithçka në jetë dhe qytetërim duhet të jetë në funksion të shpirtit. Shtëpia, puna, bashkëshortët, qeverisja, qyteti dhe festa kanë si funksion të shërbejnë si lëvozhgë për bërthamën shpirtërore të ekzistencës sonë. Qëndrimi i myslimanit në shtëpi nuk duhet të dallojë nga qëndrimi në xhami: në të dy rastet, njeriu duhet të jetë njësoj i vetëdijshëm mbi praninë e Allahut, mbi plotvështrimin dhe gjithëdëgjimin e Tij. Namazi në shtëpi, në punë apo në festë duhet të jetë i njëjti: gjithëherë një takim me Zotin dhe një ndijim i pranisë hyjnore. Ndarja dhe kategorizimi i gjërave në shpirtërore dhe të kësaj bote, është e huaj dhe gjithëpoaq e helmët.

Së fundmi, është me vend të kthehet vëmendja edhe tek përfaqësuesi *par excellence* i veprimtarisë shpirtërore: *dhikri*. Për një shumicë njerëzish, ai është një akt vullnetar dhe shfaqet në formën e shqiptimit të përsëritur të disa formulave të shkurtra në gjuhën arabe. S'do mend se dhikri është (duhet të jetë) thelbi i adhurimit dhe veprimit njerëzor në tokë. Çdo gjë që i ndodh njeriut, duhet t'i kujtojë atij Zotin. Ndërkaq, çdo gjë që ai (njeriu) bën, duhet bërë si formë e rivendosjes së lidhjes së kryehershme me Qiellin. Mirëpo, shfaqja më klasike e dhikrit është kredhja (në vetmi ose në kuvend) në përmendjen e Allahut, që shërben si mekanizëm korrigjues i deformimeve shpirtërore e intelektuale, përshpejtues i afrimit pranë Tij dhe amplifikues i thirrjes së brendshme (*fitra*) për ripohimin e paktit të kryehershëm. Rikthimi i traditës së kuvendeve të dhikrit është një sfidë kryesore për myslimanët dhe një domosdoshmëri e patjetërsueshme. Për sa kohë ato mungojnë apo shikohen me frikë si shtojca në fe dhe aq më tepër nuk njihen, Islami do të vijojë të shihet si ideologji, identitet social dhe si krenari politike. Dhe, ç'është më e keqja, Islami nuk do të jetë rruga e urtë drejt lumturisë së përjetshme, por rruga e shkurtër dhe e vrazhdë kah gara për këtë jetë gjithaq të shkurtër dhe të vrazhdë.

Hadithi i dobët

Muhamed El-Gazali

Një lexues më pyeti:

- Përse, nganjëherë në librat e tu transmeton disa hadithe të dobëta?

Iu përgjigja:

- Sepse unë kam shembuj apo argumente të tjerë të saktë, të cilët e forcojnë hadithin dhe ia largojnë dobësinë.

P.sh., merr hadithin: *"Duajeni Allahun për shkak se Ai ju furnizon me të mira, më doni mua për hatër të dashurisë që keni për Allahun dhe duajeni Ehli Bejtin (familjen time), për hatër të dashurisë që keni për mua."* Këtë hadith e ka dobësuar Albani, por unë nuk kam rënë dakord!

Le të shikojmë së bashku fjalinë e parë të hadithit. A vihet në dyshim dashuria ndaj Allahut? Ai njeri, i cili të mirat e Allahut i pret me mosmirënjohje, është njeri i ulët. Pastaj, kë të duam, nëse harrojmë Allahun?

Tani, le të shikojmë dashurinë për të Dërguarin! Cili është sekreti? Pa dyshim, ai na tregoi rrugën për tek Allahu, na e zbardhi Madhësitin e Tij dhe e përsosi Lavdërimin dhe Njësimin me fjalët dhe veprat e tij. Unë jam më shumë se i bindur se nuk gjendet njeri në botë, që nga fillimi e deri në fund të saj, që të jetë sprovuar, siç është sprovuar i Dërguari (a.s.), në njohjen e Krijuesit për krijesat dhe pasimin e tyre në rrugën e tij!

Për këtë, Allahu i Madhëruar thotë: **"Thuaj: Në qoftë se e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë mëkatet tuaja..."** (Ali Imran: 31)

Pra, dashuria për të Dërguarin buron nga dashuria jonë për Allahun!

Ndërsa, Ehli Bejtin e tij, familjen njerëzit nga Lindja deri në Perëndim nderojnë personalitetet pas vdekjes së tyre. A nuk keni vënë re se të gjitha qeveritë i nderojnë zyrtarët e tyre kur vdesin, duke u garantuar familjeve mbrojtje dhe ndihmë sociale? Prandaj edhe ne, për hatër të Pejgamberit e duam familjen e tij, Ehli Bejtin dhe u dërgojmë përhëndetje (salavat) si vlerësim dhe falënderim për

barrën e mirësisë që kemi në kurriz!

Zemra më copëtohet kur lexoj vargjet poetike, të cilat përshkruajnë shtëpinë e të Dërguarit të Allahut pas vdekjes së tij:

Shkolla e ajeteve zbrazur prej leximit

Dhe shpija e Shpalljes tokë e shkretimit.

Vajzat e Jezidit në kështjella të fortifikuara

Dhe vajza e Dërguarit të Allahut në kasolle të rrënuara.

Përse ta dobësoj këtë hadith e të përpiqem të hedh akuza ndaj zinxhirit të transmetimit, ndërkohë që përmbajtja (*meteni*) nuk ka kurrfarë problemi?

Merr hadithin e mësimit përmendsh të Kuranit Famëlar-të, të cilin e transmeton Ibn Abasi prej Ali ibn Ebi Talibit. Tri fjalitë e para që janë në fillim të hadithit, për mua janë prej argumenteve të pejgamberllëkut: *"O Allah, më mëshiro duke u larguar prej gjynaheve sa të kem frymë në këtë botë. Dhe më mëshiro, që të mos ndërhyj në atë që nuk më takon e më jep shikim vetëm në atë që Ti je i kënaqur me mua."*

Me të vërtetë, fuqia e përmendësit (zakirit) nuk arrihet, veçse përmes këtyre tri gjërave, ndërsa gjynahet e shkapërderdhin mendjen!

Ndërhyrja në çdo punë dhe send e ndalon aftësinë dhe mundësinë e zënies përmendsh, ndërsa vlerësimi i gabuar për atë që kënaq Allahun, të çon drejt ndalimit të mirësive të Tij...

Hadithi është i gjatë dhe unë e kam provuar e kam përfituar prej tij. Për këtë, Pejgamberi (a.s.), ka thënë për Aliun, pasi zbatoi porosinë e tij: *"Besimtar, pasha Zotin e Qabes, o babai i Hasanit (o Ali)!"*!!

Diturinë fetare, Allahu nuk ua dhuron njerëzve ekstremistë dhe të ulët, por ua dhuron dhe ua shton atyre që punojnë me të dhe janë të sjellshëm ndaj saj. Ndërsa, diturinë e jetës së kësaj bote e shfaq për nevojtarët.

Këtë që po them, e kanë thënë përpara meje edhe di-

jetarët se hadithin e dobët, kur e mbështesin argumente dhe shembuj të fortë e pranojmë dhe nuk e refuzojmë.

Kritikët kanë rënë dakord se trashëgimia e Muhamedit (a.s.), është mbrojtur dhe ruajtur si asnjë trashëgimi tjetër njerëzore në këtë botë, që në **ezel** e deri në **exhel**.

Lënda e Islamit ka qëndruar e pacenuar, e pastër dhe e plotë në gjithë rrjedhën e kohës dhe në çdo vend. Sepse Allahu e ka marrë përsipër ruajtjen e kësaj feje, ndërkohë që librat e tjerë i ka përshkuar deformimi, nga rrënja deri në majë.

Nuk jam prej dijetarëve të seleksionimit dhe redaktimit (*xherh ve tadil*), megjithëse do të kisha dëshirë të isha prej tyre, sepse në disa transmetime, ku kam shfaqur dyshimet e mia, më ka rezultuar se vargu i transmetimi të tyre ishte i futur dhe kritikët përpara meje i kanë mohuar ato.

Belaja, fatkeqësia vjen prej transmetuesit me kuptim të paktë ose prej hadithologut që nuk ka dituri në **Usul**. Sepse gjithë dituritë fetare plotësojnë dhe mbështetin njëra-tjetrën, duke plotësuar mangësitë e tyre.

Dikush më tha:

- Ebu Hamid El-Gazali ka përdorur dy hadithe të dobëta për zgjedhjen e bashkëshortes!

I thashë:

- Cilët janë ato dy hadithe?

Përmendi hadithin: *"Largohuni prej 'gjelbërimit të prishur'! I thanë: Kush është 'gjelbërimi i prishur'? Tha: 'Gruaja e bukur prej origjinës së keqe.' Ndërsa hadithi tjetër: 'Zgjidhni me kujdes se me kë martoheni, sepse raca ndërfutet'!*

I thashë: Ndoshta vargu i transmetimeve të këtyre haditheve mund të jetë i dobët, por për to dëshmon thënia e Pejgamberit (a.s.), në një hadith tjetër, për të cilin nuk ka kundërshtim në saktësinë e tij: *"Njerëzit janë si xeherorët (mineralet), më i miri prej tyre para Islamit është më i miri i tyre në Islam, në qoftë se e kupton saktë"*, për këtë arsye,

unë nuk e quaj gabim Ebu Hamid-in në citimin e tij të këtyre dy haditheve!!

Prej Enes ibn Malikut transmetohet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: **"Zebanitët (rojet e xhehenemit) janë më të shpejtë ndaj të shthururve të Kuranit se sa ndaj adhuresve të idhujve. Thonë: Fillohet me ne, përpara adhuresve të idhujve? Atyre u thuhet: Nuk janë të njëjtë ata që dinë me ata që nuk dinë"!!**

Këtë hadith, të shumtë janë ata që e kanë dobësuar, por Hafidh Mundhiri u ka pranuar dhe ka thënë: "Për këtë hadith dëshmon hadithi i Muslimit në librin e saktë të tij për tre të parët, me të cilin ndizet zjarri në Ditën e Kiametit. Ndërmjet tyre personi që ka mësuar Kuran sa për t'iu thënë që di të lexojë, apo hafiz!

Dhe prej gjërave të bukura të Mundhiriut është se ai në kapitullin e asketizmit transmeton prej Sehl ibn Sead se ka thënë: "Një njeri erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: "Më trego për një punë, të cilën po qe se e bëj do të më dojë Allahu dhe do të më duan njerëzit." Ai (a.s.), i tha: "Hiq dorë nga dynjaja, të të dojë Allahu dhe hiq dorë nga ajo që njerëzit kanë në dorë, të të duan njerëzit"!!

Mundhiri u ka cilësuar këtë hadith të manipuluar dhe e ka refuzuar vargun e transmetimit të tij. Pastaj ka thënë: "Por, ky hadith ka shkëlqim prej dritave të pejgamberllëkut!! Të heqësh dorë nga dynjaja, është e refuzuar, kur ajo shërben si ndihmë për fenë, mbrojtje për nderin dhe pavarësi ndaj njerëzve, sepse nuk ka ekzistencë të fesë po nuk e mbrojt dynjaja. Por, nëse dynjaja vjen në shërbim të dhunës dhe për refuzimin e të vërtetës, atëherë jo.

Dijetarët që veprojnë në fushën e thirrjes, e dinë mirë qëllimin e fjalëve. Pasi, ndryshimi i vendndodhjes së fjalëve është bela e madhe.

Përktheu dhe përshtati në shqip
Lavdim Hamja

APLIKIMI I MËSIMIT FETAR ISLAM NË SISTEMIN SHKOLLOR TË KOSOVËS

Ma. Muhidin Ahmeti

Më lejoni të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë që në kuadër të diskutimeve mbi arsimin fetar si një kontribut potencial për zhvillimin e shoqërisë multikulturore të Evropës së re, të jap mendimin tim personal lidhur me rëndësinë dhe arsyeshmërinë e inkuadrimin të mësimin të fesë në shkollat e Kosovës.

Inkuadrimi i mësimin fetar në sistemin shkollor të Kosovës, për të cilin besoj se një ditë do të realizohet, sikurse po ndodh tash tri dekada në pjesën dërmuese të vendeve të Evropës, do të ishte ngjarja më e rëndësishme kulturoro-shpirtërore në historinë më të re të shkollës sonë. Ai përsëri do të ripërfshinte idenë e Zotit dhe vlerat themelore të fesë në arsim dhe me këtë do t'i siguronte statusin e vlerës publike; do të fitonte një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e nxënësve për ekzistencën e njëmendësive jashtëshqisore e metafizike dhe do t'i kundërvijë reduktimit fatal të diturisë në nivelin më të ulët të manifestimit fizik të Realitetit. Ai, (religjioni) po t'i kushtonim kujdes të mjaftueshëm, do të mund të ishte zëri i kuptimit shpirtëror, dëlirësisë morale, dashurisë dhe ndjesisë për tjetrin; do të mund të ishte kërkesë për një edukim dhe arsimim integral që do të mbështetej në vetëdijen që njeriu nuk është i lidhur vetëm për "errësirën" e tokës, por edhe për dritën e Qiellit, që është qenie e unitetit shpirtëror dhe trupor, d.m.th. unitetit të atyre vlerave pa të cilat nuk është i mundur plotësimi i njeriut si qenie njerëzore. Mësimi fetar, po ashtu, ka rëndësinë më të madhe për ballafaqimin e nxënësit me vetveten e kjo është në funksion të krijimit të premisë themelore për ballafaqim me të tjerët. Nuk ka rrugë për tek tjetri pa mbizotërimin paraprak të rrugës për tek vetja (...). Nëse kultura religjioze dëshiron të përgatitë nxënësin për takim dhe njohje me religjionet dhe traditat kulturore të popujve të tjerë, mësimi fetar mund t'i ndihmojë që për këtë të sigurojë premisën e parë themelore.

Një nga elementet pozitivë që del si përfundim i këtij studimi dhe që po bëhet gjithnjë e më i qartë dhe më i përhapur në këtë shekull, është njohja e rëndësisë së trashëgimisë religjioze si një kodeks i domosdoshëm i kulturës, burim i vlerave etike, ofertë e horizonteve të kuptimit dhe të ardhmes; trashëgimi që duhet promovuar brenda institucionit shkollor; trashëgimi që mund t'i kontribuojë edukimit të qytetarisë së hapur dhe dialoguese kosovare, evropiane dhe botërore. Shembulli i vendeve ish-komuniste, si dhe diskutimi i hapur mbi konceptin e laicitetit në Francë, janë shumë të qartë dhe shumë domethënës në këtë kuptim. Shkolla merr përsipër më shumë se në vitet e fundit, detyra për të ofruar njohuri lidhur me fenë, me gjuhën dhe simbolet e saj.

Formula për të cilën personalisht mendoj se mund ta ndihmojë shoqërinë kosovare dhe sistemin arsimor të saj, është ajo që ofron vetë feja me potencialet e saj të pashfrytëzuara sa duhet deri më tani. Nëse ka ndonjë popull në botë që nuk duhet të ketë frikë nga feja dhe filozofia e saj vepruese, atëherë ata janë shqiptarët, sepse feja te shqiptarët nuk ka qenë asnjëherë problem, përkundrazi ka qenë pjesë e zgjidhjes. Të njëjtin rol ajo mund ta luajë edhe sot e gjithëherë, duke thelluar dhe forcuar edhe më shumë harmoninë ekzistuese ndërfaqetare të fëmijët dhe rinia shqiptare. Misionin e saj historik të fisnikërimit të shpirtit të njeriut do ta transferojë edhe në shkollë, duke u ndihmuar fëmijëve tanë të formojnë kompetencat e tyre ndërfaqetare dhe në të njëjtën kohë, të ruajnë identitetet e tyre të veçanta. Feja shpesh sot konsiderohet shkaktare e problemeve në shoqëritë kulturore. Mirëpo, potenciali i saj pozitiv për kohezion social dhe promovim të mirëkuptimit midis kulturave, shpesh është minimizuar dhe nënvlerësuar. Me fillimin e mijëvjeçarit të ri dhe zhvillimeve të shoqërisë globaliste, u vërtetua edhe njëherë se religjioni është një fakt kulturor, po aq universal sa edhe ajri e uji. Se ai zotëron energji të mëdha që mundësojnë

ruajtjen e identitetit dhe kontinuitetit fetar dhe kombëtar, metafizik e historik, shpirtëror e moral. Prandaj, mbi bazën e kësaj, studiuesit, sidomos sociologët e religjionit, ofruan një lloj përcaktimi (për aq sa ai mund të bëhet) mbi funksionin e tij në jetën e njerëzve, i cili thotë: “Religjioni është një element integruar i kulturës, i cili duhet të luajë rolin e humanizmit të shoqërisë, krijimin e strukturave të solidaritetit dhe ruajtjen e diversiteteve.”

Tashmë jam i bindur se feja do ta ketë vendin e vet dhe rolin e saj në shkollën e Kosovës së shekullit 21. Besoj se nuk ka vend për dyshime në këtë aspekt dhe kjo është e padiskutueshme, por shtrohet pyetja se çfarë modeli duhet të ndjekë Kosova në aplikimin e fesë në shkollë. Në këtë pikëpamje, sot në Evropë janë të njohura tri modele të mësimi fetar. Modeli konfesional, multikonfesional dhe jokonfesional. Mendoj se Bashkësia islame e Kosovës duhet të përcaktohet për modelin konfesional, prandaj, pa humbur kohë, më lejon ta arsyetoj dhe ta argumentoj këtë.

MËSIMI FETAR KONFESIONAL

Përvoja e disa vendeve të mëdha me traditë të fortë edukativo-arsimore dhe shkollore, në të cilat është i pranishëm mësimi fetar i modelit konfesional “në kuadër të qëllimeve të shkollës”, jo që nuk duhet neglizhuar, por duhet marrë në konsideratë dhe studiuar me seriozitet. Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, në shkollat shtetërore aplikohet mësimi fetar konfesional. Duke u mbështetur në hulumtimet e bëra kohët e fundit, del qartë në pah se rruga më e bazuar dhe më e përshtatshme për arsimin fetar brenda institucioneve shkollore publike, përveç se është treguesi më i mirë për nevojat e edukimit, është edhe një ofertë pluraliste, në të cilën si shtyllë mbartëse është mësimi konfesional (mundësia u ofrohet të gjitha bashkësive fetare në një hapësirë të caktuar). Krahas mësimi konfesional, është mirë të jetë, për ata të cilët nuk duan të ndjekin atë, lënda filozofiko-etike, në të cilën do të ketë vend dhe kontribut për traditën e ndryshme fetare të pranishme në një hapësirë të caktuar.

Në kërkim të modelit më të përshtatshëm konfesional shkollor, duhet marrë parasysh nevoja për të gjetur stilin dhe metodat që respektojnë pluralizmin. Në çdo rast, theksojnë autorët, duhet të shmangen qëndrimet dhe aktivitetet e papërshtatshme mësimore, sikurse janë: sinkretizmi, i cili shpie në përzierjen e religjioneve të ndryshme; paraqitja deskriptive dhe fenomenologjike

e traditave të ndryshme fetare, simboleve të tyre, kodekseve dhe porosive; modeli komparativ që synon në një nivel neutral, të prezantojë në mënyrë komparative përgjigje të ndryshme të religjioneve në lidhje me disa çështje nga jeta, shoqëria etj.

Një lëndë e cila do të theksonte vetëm elementet e jashtëm (traditën, devotshmërinë e rëndomtë, institucionet, shtresëzimet historike, etj.), e jo thelbin e vërtetë të fesë së gjallë (të jetuar), për shkak të të folurit neutral, do të mund ta humbiste dimensionin e saj religjioz. Të kufizuarit e ligjërit mbi “historinë e religjioneve” mund të çojë në një thellim të relativizmit në lidhje me problematikën religjioze dhe të kuptuarit e religjionit si diçka që i përket së kaluarës, eventualisht i dobishëm për forcimin e identitetit vetanak kulturor.

Rruga që duhet ndjekur është ajo e cila me të vërtetë pranon veçantitë (specifikat) e mësimi fetar shkollor konfesional, duke vlerësuar forcën e saj. Të pranuarit korrekt dhe me respekt të traditave të ndryshme fetare dhe një angazhim serioz rreth njohjes së tyre, është kërkesë e domosdoshme dhe kusht për realizimin e mësimi fetar konfesional, por brenda një projekti të studiuar mirë.

Mësuesi i fesë është i përfshirë ekzistencialisht dhe profesionalisht në veprimtarinë e tij të mësimdhënies në një shkollë, e cila gjithnjë e më shumë është e ndryshme. I kja nga kjo situatë komplekse dhe pluraliste nuk është e mundur. Vlerat e vërteta njerëzore nuk mund të transferohen as nuk mund të kërkohet prej të tjerëve t’i respektojnë ato pa dëshminë personale të mësuesit: asnjë mësues nuk mund t’i dëshmojë me besnikëri vlerat e fesë duke u treguar indiferent në krahasim me atë çka flet. Edhe më e pabesueshme është që ligjërimi (ekspozimi) i tillë neutral do të mund t’i edukonte nxënësit për të kuptuarit e vërtetë të “religjiozitetit”. Përkatësia, e dëshmuar publikisht, më shumë e garanton të vërtetën dhe i kontribuon asaj se objektiviteti (joreal) i atij që nuk e pranon anshmërinë vetanake.

Respekti për çdo nxënës, modestia karshi së vërtetës, që është gjithmonë mbi të gjitha përpjekjet njerëzore dhe sensi ndaj misteriozes, do të inkurajojë mësuesin e fesë që të futet në dialog të kërkuar me nxënësit, me pyetjet dhe dyshimet e tyre.

Disa theksojnë se rëndësia e mësimdhënies së mësimi fetar nuk është kryesisht në rrafshin e përmbajtjes. Megjithatë, informacioni religjioz ka vlerën e vet; kjo është veçanërisht e qartë sot kur në disa vende, por edhe te

Inkuadrimi i mësimi fetar në sistemin shkollor të Kosovës, për të cilin besoj se një ditë do të realizohet, sikurse po ndodh tash tri dekada në pjesën dërmuese të vendeve të Evropës, do të ishte ngjarja më e rëndësishme kulturoro-shpirtërore në historinë më të re të shkollës sonë.

ne në Kosovë, del në pah problemi i analfabetizmit fetar. Rëndësia e mësimi fetar, megjithatë akoma varet nga kuptimi që informacioni arrin të shkaktojë tek nxënësi. Mësimdhënia është e rëndësishme, kur ndihmon të jepen përgjigje në pyetjet themelore mbi njeriun, universin dhe Zotin.

MËSIMI FETAR KONFESIONAL ISLAM

Kriza bashkëkohore e edukimit dhe arsimimit, e cila në disa mjedise ka arritur kufijtë e patolerueshmërisë, në kushtet tona reduktohet në parullën "mbi zhvillimin e gjithanshëm të njeriut." Ajo çfarë u ofrohet të rinjve në sferën e ngritjes, nuk i plotëson as nevojat më elementare, e lëre më synimin e vërtetë të sistemit të gjithëmbarshtëm të edukimit dhe arsimimit.

Në mënyrë që të mbizotërojmë krizën ekzistuese të ne dhe në botë, është e domosdoshme të krijojmë një pozicion të ri metapedagogjik dhe t'i ofrojmë praktikës edukative një bazë të re antropologjike, filozofike dhe para së gjithash, tradicionale fetare.

Një arsimim solid rreth përmbajtjes islame, i shoqëruar me një paketë të mendimit kritik, i cili frymëzon (nxit) mësimdhënie që edukon për një qëndrim të moderuar dhe vetëdije mbi përgjegjësinë vetanake sociale me interes publik dhe me një veprim etik, që fokusohet në respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjelltë. Islami ofron një pasuri përmbajtësore që duhet të përshkruhet me konceptin modern të "edukimit për paqe". Ky është fokusi i punës së mësuesit dhe mësueses në arsimin fetar islam.

Programi i mësim-besimit islam ka për qëllim, përmes njohjes dhe mësimi të parimeve burimore vetanake, t'i edukojë fëmijët dhe të rinjtë për një ballafaqim të vërtetë dialogues me vizionet dhe mendimet e atyre që besojnë ndryshe ose nuk besojnë fare, me respektimin e të tjerëve dhe me një diskutim të angazhuar me ta, duke i vendosur në qendër të vëmendjes ato probleme ekzistenciale që janë të përbashkëta për të gjitha religjionet dhe për të gjithë njerëzit. Erich Frommi pati pohuar që herët, që në **rrënjë të të gjitha religjioneve është dashuria**. Prandaj, është e rëndësishme të njihen parimet burimore të besimit vetanak, me qëllim që të mposhten stereotipet, paragjykimet dhe keqpërdorimet e fesë, e cila për çdo besimtar është diçka e madhërishme dhe fisnikëuese.

Fëmijët, me anë të mësim-besimit në mënyrë të dokumentuar, me shpirt të hapur për dialog, duhet të kenë mundësinë t'i njohin bazat e besimit të vet, në mënyrë që shkollës së tyre t'i garantohet, si mënyra shkencore e procesit didaktik, ashtu edhe respektimi i ndërgjegjes së nxënësit, që ka të drejtë ta mësojë me vërtetësi dhe siguri besimin të cilit i takon. Askush nuk ka të drejtë, asnjë institucion, qoftë shtetëror apo jo, të cenojë të drejtën natyrore të prindërve për edukimin e fëmijëve sipas bindjeve të tyre fetare dhe morale. Kjo është e garantuar me të gjitha konventat ndërkombëtare mbi lirinë e besimit

dhe lirinë e ndërgjegjes. Kjo është e përcaktuar edhe në Ligjin mbi liritë fetare në Kushtetutën e Kosovës.

NË VEND TË PËRMBYLLJES

Është fakt që në dialogun ndërdisiplinor me lëndët e tjera mësimore në shkollë, me theks të veçantë në të mësuarit mbi botën, mbi domethënien e historisë, mbi bazën e vlerave etike, mbi raportin ndaj natyrës dhe kontributin e fesë e kulturës, mësim-besimi në shkollë mund të forcojë, zhvillojë dhe plotësojë veprimtarinë edukative të shkollës.

Tipari dialogues i mësimi fetar fillon nga fakti që vetëm ai që ka qëndrimin e vet (personal), mund ta kuptojë atë që është tjetër dhe i ndryshëm, me ç'rast i hapet rrugë tolerancës së vërtetë dhe bashkëjetesës.

Mësimi fetar islam në shkollat publike hap mundësi të reja për përdorimin e metodave moderne pedagogjike dhe didaktike.

Dhe së fundi, dëshiroj të theksoj nevojën që mësimi fetar konfesional në të gjitha shoqëritë pluraliste të jetë i bazuar që të promovojë dialogun dhe mirëkuptimin në mes religjioneve dhe botëkuptimeve të ndryshme, t'i kontribuojë bashkëjetesës midis njerëzve dhe të hapë forma të reja të bashkëpunimit me bashkësitë fetare.

P. S. Artikulli është lexuar si referat në Konferencën ndërkombëtare "Edukata fetare ne sistemin shkollor në Kosovë", organizuar nga Bashkësia islame e Kosovës me 14-15 mars 2011.

REFERENCAT

1. Adnan Aslan, Religiöse Erziehung der muslimischen Kinder in Deutschland und Österreich, Stuttgart, 1998.
2. Kalb/Potz/ Schinkele, Religionsrecht, Wien, 2003.
3. Ednan Aslan, Islamische Erziehung in Europa (Islamic Education in Europe), Wien, 2008
4. Österreichische Imam-Konferenz – Aktivitäten der Islamischen Galubensgemeinschaft in Österreich, Wien, 2006
5. Islam in Europe, Europäische Islam – Konferenzen der Islamischen Glaubens-gemeinschaft in Österreich (II) Wien, 2006
6. Novi Muallim, nr. 4, Sarajevë, 2000
7. www.islamgjakova.net/artikulli.
8. www.wien.gv.at/bh-hr-sr/zajednicki-zivot/religija.htm
9. www.wapedia.mobi/hr/Obrazovanje_u_Austriji.
10. www.euro-islam.info
11. www.islamawareness.net/Europe/Austria/early.html
12. www.bs.wikipedia.org
13. www.integrationsfonds.at/
14. www.schulamt-islam.at/
15. www.islaminitiative.at
16. www.diepresse.com/home/panorama/oesterreich/
17. www.dzematg.ch/html
18. www.bsr.tsn.at/pix_db
19. www.veraznanjemir.bos.rs/
20. www.regionalexpress.hr/site/more/
21. www.iltizam.org/tekstovi/read/1919/
22. www.islamska-zajednica.hr/vijesti/udzbenici.

ENIGMA E PERSONIT DHE FILOZOFIA PERSONALISTE

Soc. Raimonda Draçini

Nocioni metafizik dhe morali i personit nuk duhet të ngatërrohen me nocionin psikologjik të personalitetit. Të flasësh për personalitetet, do të thotë të bësh inventarin e këtij apo atij "uni", të flasësh për personin, do të thotë të merresh me unin, jo si përmbajtje e përcaktuar, por si njësi formale. Secili prej nesh e di veten për person, në ndryshim me gjërat, e quan veten subjekt përballë gjërave të botës së jashtme dhe thotë UNË, kur flet për veten e tij.

A keni menduar ndonjëherë për karakterin paradoksal të shprehjes: "unë kam ndryshuar"? Të thuash "unë kam ndryshuar", do të thotë, nga njëra anë të pohosh evolucionin e personalitetit tënd dhe nga ana tjetër, pavarësisht nga gjithçka, t'i grumbullosh të gjitha ndryshimet tek i njëjti person, tek i njëjti UNË. Sepse, nëse gjithçka do të kishte ndryshuar, unë nuk do të mund t'i lidhja këto ndryshime me unitetin, me praninë e përhershme të këtij UNI, që unë vazhdoj ta pohoj, të njoh ndryshimin tim do të thotë të mbizotëroj peripecitë me veprimin e një UNI të ndërgjegjshëm që i mbështjell dhe i ndriçon. Po si ta shpjegojmë këtë të vërtetë më të lartë se UNI? Cili është bazamenti i përhershmërisë së personit?

Në nivelin e trupit apo të organizmit, mund të gjejmë burimin e parë të unitetit të UNIT. Çdo qenie njerëzore është një unitet apo pushon së qeni, në qoftë se uniteti prishet. Uniteti dhe vazhdueshmëria e organizmit tonë do të ishte baza e ndjenjës së ndërgjegjshme dhe të unitetit tonë. Ndjenja e të qenit një person do të ishte pasqyrimi i unitetit biologjik, bazë e qenies sonë. Nëse individualiteti ynë biologjik përbën bazën e ndjenjës sonë si persona, nuk është e mundur në këtë mënyrë të themi se personi thjeshtëzohet në një individ. Individu është vetëm qenie biologjike, ndërsa personi është edhe një kategori morale (fjala person përgjithësisht përdoret për të mirë, fjala individ shpesh në kuptimin e keq, një individ i trishtuar dhe një person i mirë). Mund të duket se uniteti i personit nuk është një e dhënë e thjeshtë biologjike, por që e ka

në burimin e tij në një ndërtim të vullnetshëm, të nxitur nga vlera rreth të cilave do të organizohej uniteti i unit. Nga mund të vijë vallë këto vlera? Ndoshta nëpërmjet edukimit – ato vijnë nga shoqëria, e cila na detyron të unifikojmë qëndrimet tona, t'i japim koherencë jetës sonë. Të ndihem përgjegjës, do të thotë të pranoj të jem autor i veprimeve të mia të djeshme. Por, në përgjithësi duhet të përgjigjesh dhe për t'u përgjigjur nuk duhet të jesh i vetëm, duhet që të tjerët të na kenë bërë pyetje, të na kenë kërkuar të kryejmë një detyrë. Personi është në fillim një funksion social, një personazh. Dhe nëse ne do të ngjitemi deri tek origjinat, do të shohim se fjala person vjen nga latinishtja "persona", që do të thotë maskë. Aktorët e pjesëve antike mbanin një maskë, që e ngrirë në shprehjen e saj të palëvizshme gjatë gjithë kohës së lojës, nënvizonte unitetin e rolit. A s'është sot uniteti i personit tonë ende uniteti i funksionit të tij? Ne jemi mesues, doktorë, inxhinierë, jo vetëm mbi kartvizitat tona, por në ekzistencën tonë të plotë, titujt tanë që na shoqërojnë, janë pjesë e jona.

Pol Valeri shkruan: "Në çdo karrierë publike, pasi e kemi ndërtuar personazhin dhe, kur zhurma që ai bën rivjen tek autori i tij dhe i mëson se cili duket ai, ky i fundit luan personazhin e tij ose më mirë, personazhi e luan atë dhe nuk e lëshon më kurrë".

Me sa duket, personi pra i gjen kushtet e ekzistencës së tij konkrete në realitetet impersonale të nivelit biologjik e shoqëror.





DOMOSDOSHMERIA E TË LEXUARIT TË KURANIT

Ma. Gilman Kazazi

Pse duhet të lexohet Kurani? Cilat janë motivet që mund ta nxisin opinionin shqiptar të interesohet për Kuranin? Çfarë na ofron Kurani? A do të ndryshojmë apo do vazhdojmë të ngelim buzë paragjytimeve shekullore?

Pyetje të njëjta janë diskutuar edhe në rrethet e jomuslimanëve për Librat e tyre. Le t'i parashtrijmë disa arsye për këtë domosdoshmëri islame. Çdo mysliman duhet të veprojë në përputhje me mësimet e Kuranit, si dhe t'i ftojë të tjerët për ta lexuar dhe ndjekur Udhëzimin Hyjnor.

1 - Kurani duhet të lexohet, sepse ai është baza dhe themeli i besimit islam, legjislatura dhe burimi themelor i mësimetve islame. Mund të themi se, nuk ka Islam pa Kuran dhe pa profet nuk mund të ketë një model perfekt të Islamit. Nuk mund të praktikohen parimet e Islamit dhe porositetë e Allahut, nëse nuk lexohet Kurani. Qëllimi i zbritjes së Kuranit është për t'u lexuar, kuptuar dhe zbatuar në jetë. Kurani nuk është shpallur vetëm për t'u puthur apo për të shërbyer si nuskë që Allahu të na mbrojë prej rreziqeve. Kurani nuk është hajmali, por është receta më e përkryer që i nevojitet njeriut në çdo situatë.

Allahu thotë: *"Ky është Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty atë që t'i studiojnë argumentet e tij dhe të marrin mësim prej tij ata që kanë mend."* (es-Sad, 29)

Në një tjetër verset thuhet: *"Ne të zbritëm ty, (o Muhammed) Librin (Kuranin) me plot të vërteta, që të gjykosësh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu..."* (en-Nisa', 105)

2 - Historia dëshmon se asnjë libër nuk ka pasur ndikim

më të madh në jetën e njerëzimit, sesa Kurani.

Po të vërehet ndikimi i tij tek gjeneratat e para të myslimanëve, do të shohim se arabët, nga njerëz të paqytetëruar e primitivë, u shndërruan në njerëz të zhvilluar. Nga njerëz analfabetë, u kthyen në njerëz të shkolluar, nga njerëz dogmatikë e me bestytini, u bënë njerëz racionalë me logjikë të shëndoshë, nga njerëz pasues e të shtypur, u ngritën në njerëz udhëheqës e sundimtarë. Kurani i shtyu arabët drejt civilizimit. Zhvillimi i çfarëdo disipline shkencore tek arabët, nuk mund të merret me mend pa Kuranin. Në sajë të këtij libri hyjnor, u përhap gjuha arabe në popuj të ndryshëm, të cilët, duke pranuar Islam, pranuan edhe gjuhën e Kuranit dhe kontribuan në përparimin e civilizimit islam në gjuhën arabe. *"Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërtetë (më e mira, më e drejta, më e qarta)..."* (el-Isra', 9), kurse profeti Muhamed (a.s.), thotë: *"Me të vërtetë Allahu i lartëson me këtë Libër disa popuj (njerëz), e disa të tjerë i nënçmon."* (Myslimi).

Ndikimi i Kuranit është prezent edhe sot në botën arabe. Ai është faktori themelor në ruajtjen e gjuhës letrare të dhjetëra shteteve arabë. Arabishtja e Kuranit është gjuha esenciale e shkencave islame dhe gjuha diplomatike e tërë myslimanëve. Kurani dhe gjuha e tij janë faktorët kryesorë në bashkimin e botës islame, aq heterogjene në pikpamje kulturore, ekonomike dhe politike e aq të përhapur gjeografikisht.

Ndikimi dhe udhëzimi i Kuranit vihen re edhe në botën perëndimore. **(Ket Stivens) Jusuf Islami**, prej yjeve të muzikës moderne, vitet '70, në moshën 27- vjeçare pranon Islamin e shkak për këtë ishte leximi i përkthimit të kuptimeve Kuranore. **Fadlullah Wilmont**, një historian nga Australia, gjatë studimeve universitare ka vënë re ndikimin e Islamit në mendimin evropian dhe kontributin e myslimanëve në shkencat e ndryshme. Myslimanët kishin trashëguar urtësinë e lashtë të Egjiptit e Babilonisë, kishin përkthyer dhe ruajtur shumë njohuri nga shkenca dhe filozofia e Persisë dhe e Greqisë së vjetër, që përndryshe do të kishin humbur. Në sajë të kureshtjes dhe mendjes së vyer e të hapur, myslimanët kishin qenë të aftë të sillnin të reja nga shkenca dhe teknikat e Indisë dhe të Kinës. Kështu që, F. Wilmont u interesua për librin e shenjtë të myslimanëve, libër të cilin e gjeti në bibliotekën e universitetit ku studioje. Pasi vendos që ta lexojë Kuranin me një sy kritik, ngelet i ndikuar nga madhështia kuranore dhe pranon Islamin, duke arsyetuar si më poshtë: "Në Kuran nuk ka kundërshtime e kontradikta; Kurani nuk u bie ndesh të vërtetave shkencore; Kurani përfshin çdo aspekt të jetës".

Kurani, i cili vazhdimisht thërret për kultivimin e shkencës, përmban shqyrtime të shumta shkencore me detaje shpjeguese, që janë tërësisht në përputhje me arritjet e shkencës bashkëkohore. Ekuivalentet e këtij lloji nuk ekzistojnë në shkrimet hebraiko-krishtere.¹

"Sa herë që ne i drejtohem Kuranit, në fillim na shkakton neveritje, dhe çdoherë sërish ai së shpejti bëhet tërheqës, na mallëngjen dhe më në fund na detyron ta nderojmë... Stili i tij, në pajtim me kontekstin dhe qëllimin e tij, është i rreptë, madhështor dhe i tmerrshëm – përgjithmonë i lartësuar – kështu që ky libër do të ushtrojë ndikim shumë të fuqishëm gjatë tërë kohës." Johan Volfgang fon Gëte (1794 – 1832)².

"Kurani, sipas mendimit përgjithësisht të pranuar, zë vend të rëndësishëm ndër librat e mëdhenj religjiozë në botë. Ndonëse është më e reja prej veprave më të rëndësishme që i përkasin këtij niveli të literaturës, ai nuk ia lëshon rrugën asnjë vepre tjetër në efektin e mrekullueshëm që ka ndikuar në masat e gjera të njerëzve. Ai ka krijuar një fazë gati të re të mendimit njerëzor dhe një tip të ri të karakterit. Ai së pari ka transformuar një numër të fiseve heterogjene në shkretëtirë e Gadishullit Arabik në një popull heroik, dhe pastaj ka vazhduar të krijojë organizata të panumërta politike-fetare të Botës Islame, të cilat janë një nga format më të mëdha, në të cilat Evropa dhe Lindja duhet të llogarisin sot". George Margoliouth (1853-1924).³

3 - Kurani është i vetmi libër në botë, në të cilin ndodhen fjalët origjinale të Zotit të Gjithësisë, i pandryshuar, i pastër nga çdo ndërhyrje njerëzore. As pejgamber, as sundimtar, as qeveritar e as dijetar nuk kanë guximin të shtojnë apo pakësojnë, qoftë edhe një germë në Kuran.

Origjinaliteti i pakundërshtueshëm i jep tekstit kuranor vend të posaçëm ndër të gjitha librat e Shpalljes. Tekstin

1. Bibla Kurani dhe shkenca, Maurice Bacuille, Istanbul, 2007, fq: 135.
2. Cituar në T.P. Hughes, Dictionary of Islam, p. 526.
3. The Koran, New York, Everymans Library, 1977, fq. VII.

e tij, ashtu siç është shpallur, e kanë mësuar përmendsh Profeti (a.s.) dhe shokët e tij dhe e kanë shënuar shkruarit e tij të afërt. Pra, që në fillim të shpalljes, Kurani përmban këto dy elemente të autenticitetit, që nuk i kanë as Teurati, as Psallmet e as Ungjijtë.

Për dallim nga Bësëlidhja e Vjetër, në të cilën mund të gjejmë versione të ndryshme të të njëjtit tregim, kundërthënie, gabime historike, gjëra të pabesueshme dhe mospërputhje me njohuritë shkencore të vërtetuara mirë. Këto janë krejtësisht të natyrshme në të gjitha veprat njerëzore të lashtësisë.⁴

E njëjta gjë vlen edhe për Ungjijtë. Fantazmagoritë e Mateut, kundërthëniet e hapta mes Ungjijve, gjërat e pabesueshme, mospërputhjet me të arriturat e shkencës bashkëkohore, ndryshimet e vazhdueshme në tekste, bëjnë që Ungjijtë të kenë kapituj dhe fragmente që vetëm e zbulojnë imagjinatën e njeriut. Por këto mangësi nuk e vënë në dyshim ekzistimin e misionit të Jezusit.⁵

4 - Kurani është zbritur për ne, njerëzimin. Ai është dhurata më e madhe që Allahu i ka dhuruar njerëzimit. Kurani nuk u drejtohet vetëm arabëve, në gjuhën e të cilëve është shpallur, ai i drejtohet njeriut si qenie njerëzore: *"O njeri! Çka ju ka larguar juve prej Zotit tuaj"*. (el-Infitar, 6). *"O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj Këshilla (Kurani) dhe Shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj (në zemra), edhe Udhëzimi e Mëshirë për besimtarët."* (Junus, 57). Është shpallur që t'u përgjigjet nevojave të jetës, t'u japë zgjidhje problemeve të jetës, t'i tregojë njerëzimit qëllimin e jetës në këtë botë dhe t'i mundësojë njeriut ta njohë vetveten. Në Kuran gjendet ilaçi i shërimit të ndjenjave egoiste dhe epshore që e robërojnë njeriun dhe e ulin atë me poshtë se kafsha. Në të gjendet çelësi i lumturisë dhe balsami i qetësisë shpirtërore.

Paramendoni, nëse një udhëheqës apo një njeri shumë i dashur ju dërgon një letër ose një shkresë, a do ta lexonit atë letër? Sunduesi dhe Krijuesi i gjithësisë ju ka dërguar Kuranin, që jeta juaj të jetë më e mirë, më e begatë, më e dobishme: *"Ne të shpallim Kuranin, që është Shërim dhe Mëshirë për besimtarët..."* (el-Isra', 82).

Fjalët: *Këshillë, Shërim, Udhëzimi dhe Mëshirë*, janë epitetet e Kuranit dhe mesazhet që ai përçon tek njerëzimi.

Lexues i nderuar, nuk mund të përcillet mesazhi i saktë i Kuranit, nëse nuk e lexojmë dhe nuk e kuptojmë. Nuk mund të reflektojë Kurani në paraqitjen tonë, në mentalitetin tonë dhe në sjelljen tonë, nëse nuk e studiojmë atë.

Në vitin 1895 ish-kryeministri britanik (W. E. Gladstone, 1809-1898), me Kuranin në duar ka thënë: *"Nuk do të realizojë Britania asnjë nga qëllimet e saj ndër arabë e myslimanë, vetëm nëse heq sundimin e këtij libri nga ata. Nxirreni sekretin e këtij libri nga mesi i myslimanëve, do të rrenohen para jush të gjitha pengesat e tjera."*⁶

4. Bibla Kurani dhe shkenca, Maurice Bacuille, fq: 63.

5. Po aty, fq: 129.

6. Min revaill-Kuran, Dr. Muhamed Seid el-Buti, Damask, 2002, fq.7-8.



PASIONI PËR TA QUANTUR VETEN PËRËNDI

Xhemal Nar

Fjalët *La ilahe ilallah* janë gjëja e parë që theksohet në thelbin e mesazhit profetët që u kanë sjellë njerëzve prej Zotit, të cilët qenë udhërrëfyesit tanë dhe të cilët i kujtojmë të gjithë duke thënë selame për ta. Mesazhi thelbësor, që do të thotë se nuk ka zot tjetër, përveç Allahut.

Ndonëse në shikim të parë duket dhe kuptohet si e thënë dhe e përcjellë në lidhje me monoteizmin, lartësimin, madhërimin, shenjtërimin dhe mohimin e çdo të mete për Zotin, ky theksim nga ana tjetër mbart një kuptim lartësues, më saktë përcaktues dhe përkufizues në lidhje me njeriun, të cilin Allahu e ka caktuar si krijesa më superiore në mesin e të gjithë krijesave.

Le të përpiqemi ta sqarojmë pak më shumë këtë çështje:

Njeriu është mëkëmbësi i Zotit (halife) në tokë ose krijesa e krijuar për të qenë i tillë. Ai është pajisur për detyrën e mëkëmbësisë (halife) dhe është dërguar për të jetuar brenda një periudhe kohore të caktuar në mjedisin e tokës, në të cilën gjendet e përhapur çdo lloj mundësie e nevojshme për të krijuar idenë dhe për të realizuar një jetë të përshtatshme me pozitën e mëkëmbësit.

Qiejt, toka dhe çdo gjë që gjendet mes këtyre të dyjave, janë në shërbim të njeriut dhe nën urdhrat e tij. Në një anë gjendet njeriu, ndërsa në anën tjetër "qiejt, toka dhe ato që gjenden mes këtyre të dyjave"... njeriu është marrësi nën zgjedhë, ndërsa gjërat e tjera janë të gjeturat nën zgjedhë...

Pika që nuk duhet të na shpëtojë në këtë çështje, gjendet mes qiejve dhe tokës dhe jeton mes tyre përkundrejt faktit që nuk gjendet nën zgjedhën e njeriut. E vërteta se e drejta e njeriut për të marrë nën zgjedhë, në sajë të cilësisë së tij si halife gjithë "gjërat e tjera", nuk përfshin kurrë dhe në mënyrë të prerë vetë njeriun... Mëkëmbësi

është i tillë, prandaj marrja nën zgjedhë e mëkëmbësit nuk përputhet me qëllimin dhe synimin e krijimit.

Në periudhën që jetonte në Xhenet, sido që ndodhi dhe pa dyshim, si shprehje e një urtësie, njeriu përjetoi në këtë strukturë dhe në këtë pozitë një lëbyrje personaliteti me atin e njerëzimit, profetin Adem dhe si përfundim i kësaj gjendjeje, këmbët e tij shkanë nga vija e qëllimit për të cilën qe krijuar. Një shkarje që rezultoi me humbjen e jetës në Xhenet.

Zgjatja e dorës drejt Pemës së Ndaluar, për të arritur qëllimin e premtuar nga shejtani, për "të pasur mbretërim të patundur, për t'u bërë melek dhe i përhershëm". Zhvillime të tjera pasuan...

Do të duhet që këtë dukuri ta rishikojmë edhe një herë nga tre aspekte të ndryshme:

E para: kur Allahu i mësoi atit tonë Adem (a.s.), emrat e sendeve, pra kur e pajisi atë me çdo lloj informacioni të duhur, që duhet të njohë një mëkëmbës i Zotit në tokë, atëherë shejtani e bëri atë të mendonte se ajo që fshihej pas pëshpërimave dhe këshillave të djallit, që një lloj diturie që nuk e njihte. Duke e perceptuar si një informacion të fshehtë që nuk ia kishin mësuar... Ja, e ashtuquajtura "dituri" sikur rilind brenda Adem (a.s.), si rezultat i pëshpërimës së shejtanit dhe ai tani përpiket të zgjasë dorën drejt pemës së ndaluar. Këtu hidhet hapi i dytë, kur pëshpërimat e shejtanit përfshihen si një lloj informacioni në fushën e njohjes së njeriut. "Dituria" e përhershme, që të bën engjëll dhe të fal sundim të palëkundur. Një lloj diturie që lindi brenda njeriut si rezultat i pëshpërimave të shejtanit, por që lëshoi filiza dhe u harlis në botën evropiane. Në qoftë se do të shpreheshim drejt, hyri në diskutim një burim i dytë diturie...

E dyta: tre qëllimet që vuri përpara njeriut kjo dituri e

brendshme, që lindi tek njeriu nga pëshpërimat e shejtanit. Në qoftë se pika e parë kishte të bënte me burimin dhe natyrën e kësaj lloj diturie, qëllimi dhe synimi përbëjnë pikën e dytë dhe ato janë: mbretëri e patundur, të bërët melek dhe përherësia...

Tashmë, megjithëse ishte mëkëmbësi i tokës, njeriu kapet pas synimeve të tjera që shkojnë përtej autoritetit dhe detyrave të tij si halife e Zotit. Ai do të shkojë pas kërkesave të të tjerëve.

Pika e tretë është "monologu" që ai përjeton pasi ka zgjatur dorën drejt pemës së ndaluar:

"Unë i bëra keq vetes sime..."

"A nuk të kisha thënë se djalli është armiku yt?"

Pas kësaj vjen "pendesa" e shprehur me fjalë. Braktisja e njohurive që të pëshpërit djalli dhe kthimi pas tek fjalët e Allahut, kapja me shpirt pas tyre...

Më pas, një paralajmërim përpara se të dilte nga xheneti: "Kanë për të ardhur tek ju udhërrëfyes..." Një paralajmërim i bërë në lidhje me burimin e vërtetë të diturisë...

Që të vendosim themelin e nevojshëm për temën tonë, do të duhej të shihnim shkurtimisht edhe një ndodhi që ngjau që në periudhën e hershme të njeriut në tokë dhe ajo është ngjarja mes Habilit dhe Kabilit...propozimi i Kabilit, refuzimi i Habilit, therje e kurbanit, kërcënimi dhe në fund fare vrasja...

Nëse në xhenet njeriu u bë bashkëbiseduesi i "premtimeve" që i pëshpëriti shejtani, tani në tokë ai ballafaqohet me "frikën" e personalitetit nën udhëheqjen e djallit. E kërcënuan, kërkuan ta frikësojnë dhe për më tepër edhe e mbytn. Edhe në qoftë se Habili do të kishte treguar rezistencë, tashmë frika, presioni dhe vrasja qenë kthyer në realitet të jetës në tokë për njeriun.

Prej asaj dite, në dorën e shejtanit dhe ushtrisë së tij ekzistonte edhe arma e "frikës", së bashku me metodën e "premtimeve" që ai kishte përdorur në Xhenet.

Fakti që shejtani mashtrues dhe ushtria e tij e përdorën kundër njeriut në mënyrë hileqare autoritetin dhe fuqinë e "premtimit" dhe të "frikës", të cilat në të vërtetë i takojnë në mënyrë absolute vetëm Allahut të Madhëruar, përbën pikën e kthimit që i çeli rrugën rrëshqitjeve nga vija e kredos "La ilahe ilallah".

Kjo rrëshqitje nga linja e tevhidit do të thoshte shkëputje nga "njeriu i vërtetë" linjat e të cilët i treguam më sipër, vetëkonsumim, dalje përjashta qëllimit dhe urtësisë së krijimit dhe pozicionim i papërshtatshëm. Shpërbërja, shkatërrimi dhe dekompozimi i strukturës së "lartësimit" me anë të vetëdijes së "La ilahe ilallah"...

Njeriu që e kishte humbur këtë vetëdije, ose ishte skllavi i "premtimeve" me udhëheqës shejtanin, ose qe robi i "frikës" së tij.

Tashmë hynin në zgjedhën e "miqve të shejtanit" që kishin ngritur kurthin, duke ftuar të vrapohej pas diturive të fshehta, që të bënin të mundur "një mbretëri të palëkundur, përherësi dhe të bërët melek" dhe duke bërë të pandehje vërtet se mund t'i shtiesh në dorë këto gjëra me

mënyrën e djallit. Në të vërtetë, për shkak të marshimit krah për krah me shejtanin, miqtë e djallit me pamje engjëlli kishin arritur në dukje mbretëri të palëkundur dhe përherësi, por në të vërtetë, ata kishin shpallur mbretërinë e tyre mbi botën financiare dhe shpirtërore, duke vënë përposhtë këtë grup të madh sklleverish dhe robërish.

Me këtë zhvillim, tashmë fama e atyre që bashkëpunonin me djallin "prepotent" qe shndërruar në fatin e "të dobëtve" që u bindeshin atyre.

Si rezultat i humbjes së vetëdijes rreth fjalës "La ilahe ilallah", për shkak të atyre që kishte bërë me duart e tij, njeriun e larguar nga pozicioni i vërtetë i humanizmit e kishte rrethuar një kokëçarje e madhe.

Kjo qe arsyeja përse fjalët *La ilahe ilallah*, që përbënin thelbin e iletit-së së profetëve, të cilët Allahu ua dërgoi njerëzve si udhërrëfyes (dhe të cilët i kujtojmë të gjithë duke thënë selame për ta) dhe që diskutohej si realiteti i parë që duhet theksuar në udhëzimin e njeriut, në të njëjtën kohë mbartin një kuptim lartësues për njeriun.

Në qoftë se njeriu fillon të mendojë se fuqia dhe autoriteti për "premtim" dhe "frikë" ekziston tek dikush tjetër përveç Allahut, kjo do të thotë se ai ka braktisur fjalën "La ilahe ilallah" dhe aty ku ndodh kjo gjë, është e pashmangshme që të mos formohen bashkësi "të dobtësh" në formën e masave të gjera, mbi të cilët ushtrojnë sundimin e tyre miqtë "prepotentë" të shejtanit.

Por nuk duhet harruar se, ashtu sikurse qëndrimi dhe pozicionimi i prepotentëve shkel autoritetin e Zotit që është Gajjur, edhe kokat e përkulura dhe lotët e të dobëtve tërheqin mbi vete mëshirën dhe dhembshurinë e Allahut që është Rrahim.

Lëre pastaj faktin që prepotentët përfitojnë nga "dituria sekrete", që pretendojnë se e kanë vetëm ata, në mënyrë varësie dhe bashkëpunimi mbështetur në një traditë prodhimi prej mijëra vjetësh, ndërsa të dobët, për të cilët është ndërprerë rruga që i çon drejt diturisë, zgjidhjen e vetme për situatën pa zgjidhje në të cilën gjenden, e kanë vetëm tek përfitimi i mëshirës hyjnore.

Trajtimi i gjendjes në të cilën ndodhen të dobët, paralajmërimi se ata presin një shpëtimtar dhe zbritja e urdhëresës hyjnore se besimtarët do t'u bëhen ndihmë, është produkti i një mëshirimi të tillë.

Thirrja që u bëhet besimtarëve në këtë kontekst, nuk është një detyrë për ndihmën dhe përkrahjen që meritojnë të dobët, por një provim që reflektohet nga atributi i mëshirës së Zotit..., sepse në vendet ku komandon njeriu i lartësuar pas ndërgjegjesimit për fjalën La ilahe ilallah, pra aty ku vepron njeriu i vërtetë, nuk ka vend për prepotentët dhe ai vend nuk do të kthehet kurrë në një batak për të dobët.

Vetëdija se jemi robër të Allahut, nuk do të lejojë të shpërthejnë filizat e qëndrimeve të tilla, si shpresë dhe frikë nga ndonjë gjë tjetër përveç Allahut, të cilat i hapin rrugën formimit të pasionit për t'u ndjerë Zot.



Statusi DYJAR I REALITETIT NË BOTËKUPTIMIN ISLAM

Edison Çeraj

Tewhîd-i si botëkuptim

Nga ana gjuhësore *tewhîd* do të thotë t'i bësh gjërat një, t'i njësoh.

Tradicionalisht *tewhîd*-i nënkupton besimin dhe bindjen të dëshmia se "nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut" (*lā ilāhe il-Allāh*). Kjo dëshmi, që së jashtmi duket mohuese dhe shumë e shkurtër, bart dhe ngërthen kuptimet më të epërme dhe më të pasura të Islamit në tërësi. Ndoth që, në disa raste, një kulturë e tërë, ose një qytetërim i tërë, ose një histori e tërë të përmblihet në një sintagmë apo në një formulë të vetme. Natyrisht që e njëjta gjë vlen edhe për dëshminë e mësipërme.

I gjithë Islami me larinë e tij të gjerë, e cila herë pas herë shkakton keqkuptime dhe habi për shumë njerëz, kulturë dhe qytetërim njëherësh, *modus vivendi*, por mbi të gjithë nënshtrim me vullnet ndaj Zotit, përmblihet pikërisht të dëshmia *lā ilāhe il-Allāh*.

Tewhîd-i është një pikëpamje e përgjithshme rreth realitetit, rreth së vërtetës, kulturës dhe qytetërimit, botës, hapësirës dhe kohës, rreth historisë dhe fatit të njeriut.¹

Gjithashtu *tewhîd*-i është edhe besimi i mesëm, ndërmjet besimit në shumë zota (idhujtaria, paganizmi) dhe mosbesimit (ateizmi, por edhe laicizmi nga një këndvështrim).

Dualiteti

Një nga parimet që qëndron në thelbin e *tewhîd*-it është dualiteti, ose statusi dyjar i realitetit; domethënë, realiteti është i përbërë nga dy rende kryesore: nga Zoti dhe jo-Zoti, ose Krijuesi dhe krijimi.

Rendi i parë ka vetëm një qenësi: Allahun, Qenien e qenieve. Ai është vetë Zoti, i Përhershmi, i Gjithëdijshmi, Krijuesi, i Pari pa fillim dhe i Fundit pa mbarim, Absolut dhe Transcendent. Emri *Allāh*, që do të thotë *i adhuruar*, është i posaçëm vetëm për Të; nuk ka gjini dhe as trajtë. Si Ai nuk është askush dhe asgjë.² Ai është gjithnjë absolutisht i vetëm dhe nuk ka shokë, ortakë apo rivalë. Natyra e Zotit, siç është dhënë në Islam, rrjedh nga Zbulesa. Me zbulesë nuk nënkuptohen

vizionet e papritura që pretendojnë për veten poetët dhe artistët e mëdhenj; as frymëzimi apostolik i shkruarve të shkrimit të shenjtë; as intuita përndritëse e të urtëve dhe dallimbërësve. Me të nënkuptojmë të folurën e Zotit për Vetën, atë që Ai ka krijuar, raportin midis tyre dhe rrugën e shpëtimit komunikuar të Dërguarit dhe Profetit të zgjedhur të Tij, jo me zë apo me shkronja, e megjithatë që përfshin çdo gjë që Ai ka paraqitur me fjalë, ku më pas, me anë të Profetit ia ka përcjellë njerëzimit në formën gjuhësore, *të re për nga natyra*, por megjithëkëtë të kuptueshme; të përzier me subjektivitetin apo imagjinatën njohëse vetjake të vetë Profetit. Kjo Zbulesë është përfundimtare, dhe jo vetëm që konfirmon vërtetësinë e zbulesave të mëparshme në trajtat e tyre burimore, por përfshin edhe përmbajtjen e tyre, duke ndarë të vërtetën nga krijimet kulturore dhe sajatat etnike.

Me pak fjalë, njohja e Zotit sipas Islamit bazohet në dy burime: Kurani dhe Tradita autentike profetike. Por, pas leximit dhe përsiatjes mbi këto dy burime, përpjekjes për të njohur Zotin i bashkëngjitet edhe të menduarit dhe të medituarit, gjë për të cilën bën fjalë sa Kurani e sa Tradita Profetike.

I dyti është rendi i kohës dhe i hapësirës, i përvojës dhe i krijimit. Në këtë rend përfshihen të gjitha krijesat: bota e gjërave ose e sendeve, bimët, kafshët, njerëzit, xhindet, engjëjt, qielli, toka, parajsja, ferri dhe çdo gjë tjetër që ne njohim dhe që nuk njohim, si dhe të gjitha zhvillimet e tyre prej çastit që janë krijuar.³

Këto dy rende, ai i Krijuesit dhe i krijimit janë plotësisht të ndarë nga njëri-tjetri, për sa i takon qenies, apo aspektit ontologjik, si dhe përvojave dhe rrugëve të ekzistencës së tyre. Nuk është e mundur kursesi që njëri nga këto dy rende të bashkohet me tjetrin, të shkrihet, të përzihet apo të shtrihet në tjetrin. Nga pikëpamja ontologjike, Krijuesi nuk mund të shndërrohet në krijesë dhe as krijesa, në kurrfarë mënyre, forme apo trajte nuk mund të shndërrohet në Krijues.⁴

3. *Tevhidi*, f. 39, vep. e cit.

4. "Vallë, a mos i kanë marrë zotat prej dheu, që të ishin në gjendje t'i ngjalin të vdekurit? Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij! Ai nuk mund të pyetet për atë që

1. Faruki, I. (2006) *Tevhidi*, f. 39. Përkth.: Rejhan Neziri. Shkup: Logos-A.

2. "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha." (Esh-Shūra, 11)

Duke e zhvilluar më tej aspektin dyjar të realiteti, le të kujtojmë këtu se “të vjetrit thoshin se substancat janë vetëm dy: shpirti dhe materia, duke nënkuptuar me to dy botë, dy rende gjërash që kanë origjinë dhe natyrë të ndryshme, që nuk rrjedhin nga njëri-tjetri dhe as që mund të reduktohen te njëri-tjetri.

Edhe prijësit më të mëdhenj shpirtërorë e mendorë të botës nuk kanë pasur mundësi t’i shmangen këtij dallimi, pavarësisht se qasjet kanë qenë të ndryshme. Do të mund t’i mendonim ato dy botë si të ndryshme në kohë, dy botë, “të njëpasnjëshme” (e tashmja dhe e ardhmja), ose t’i kundrojmë si të ndryshme për nga natyra e kuptimi, por edhe si dy botë të njëkohshme, dhe kjo është më afër thelbit.

Dualizmi është ndjenja më intime njerëzore, por s’është filozofia më e lartë njerëzore. Përkundrazi, të gjitha drejtimet e mëdha filozofike kanë qenë moniste.

Njerëzit jetojnë, ndiejnë dhe e pranojnë botën në mënyrë dualiste, mirëpo monizmi gjendet në natyrën e çdo filozofie dhe mendimi. Filozofia nuk e duron dualizmin. Megjithatë, ky fakt s’ka edhe aq rëndësi; sepse mendimi nuk mund ta gjykojë jetën që është më e lartë se ai.

Në të vërtetë, duke qenë njerëz, ne gjendemi vetvetiu në dy realitete. Ato dy botë mund t’i mohojmë e të mos i pranojmë, por s’mund të dalim prej tyre.

Jeta nuk varet nga fakti se sa e kuptojmë.

Prandaj, çështja se a do të jetojmë njëkohësisht dy jetë (sepse as që mund të bëhet ndryshe) nuk parashtrohet dot, por a do të jetojmë në atë mënyrë me vullnet dhe duke qenë thellë të vetëdijshëm për këtë gjë?! Këtu qëndron rëndësia më madhore në Islam.

Çdo jetë është dytrajtëshe. Të jetuarit e vetëm një jete, për njeriun është një lloj pamundësie “teknike” që nga çasti kur pushoi së qeni dru ose kafshë, që nga “*kālū belā*” – po si jo/patjetër (citim nga Kurani), që kur u vendos enigma morale në qiell, që kur njeriu u flak në “botë” ose në “realitetin shoqëror”.

Njeriu mund të mendojë ose mund të besojë një jetë, por kur jeton, ai jeton dy jetë.⁵

Parimi i metafizikës

Sipas kozmologjisë hindu, natyra është një ngjarje e pafat që i ka ndodhur Brahmanit, Absolutes. Krijimi (çdo krijesë më vete) është një sendëzim/konkretizim i Absolutes, që nuk duhej të ndodhte, sepse kjo përbën degradim të përsosmërisë së saj absolute. Së këndejmi, çdo gjë në natyrë konsiderohet si një lajthitje, si diç e burgosur në formën e saj të krijuar, që pret të lirohet e t’i rikthehet burimit si Brahmani. Ndërkohë që vazhdon të jetojë në këtë botë si një krijesë, ai i nënshtrohet Ligjit të Karmës, nëpërmjet të cilit ngrihet e lartohet ose përulet e poshtërohet, në varësi të faktit se sa ai e njeh dhe i bindet këtij parimi të parë kozmologjik; pra, faktit që ai është vetëm një dështim i Absolutes.⁶

Kozmologjia e krishterë e konsideron natyrën krijesë të Zotit, që në kryeherë ka qenë e përkryer, por që me “mëkatit” është prishur dhe ligësuar.⁷

punon, kurse ata do të pyeten. Vallë, a adhurojnë ata të tjerë zota, në vend të Atij?! Thuaj: ‘Sillni provën tuaj!’...’ (El-Enbijā, 21-24)

5. Izetbegović, A. (2000) *Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit*, f. 5-6. Shkup: Logos-A.

6. *Tevhidi*, f. 105, vep. e cit.

7. “Prandaj, ashtu siç hyri mëkati në botë dhe, me anë të mëkatit, vdekja, për mes një njeriu të vetëm, po ashtu u shtri te të gjithë njerëzit, sepse të gjithë mëkatuan; sepse, derisa u shpall ligji, mëkati ekzistonte në botë; por, mëkati merret

E keqja ontologjike, pra qenësore dhe e përhapur e krijimit është shkak i dramës shpëtimtare të Zotit, i vetë-mishërimit të Tij në Jezuin, i kryqëzimit dhe i vdekjes së Tij. Gjithnjë sipas Krishterimit, pas kësaj drame, rindërtimi, për nga aspekti teorik është realizuar, por edhe nuk është realizuar.

Praktikisht, mendimi i krishterë e ka quajtur vazhdimisht krijimin si mëkatar, ndërsa natyrën si të keqe. Armiqësia e madhe ndaj materies, që ishte veçori e gnosticizmit, kaloi te Krishterimi dhe përforcoi fyerjen dhe antagonizmin ndaj natyrës dhe “botës”, që ndiqej me aq lakmi në çdo shkallë te romakët – armiqtë e parë të të krishterëve. Natyra, me gjithë mundësitë dhe prirjet materiale, me lëvizjen e saj nënkuptonte shkëputjen nga “bota tjetër” drejt “mishit”, “mëkatit”. Në sferën shoqërore ishte një ngasje drejt politikës, drejt pushtetit dhe vetautoritetit, ndaj “Cezarit”. Sipas përcaktimit të krishterë, programimi, pra vullneti për ta rregulluar lëvizjen e historisë drejt transformimit të natyrës, konsiderohet i kotë.⁸ Për më shumë se një mijëvjeçar “natyra” është vënë përballë “hirit”/“mëshirës” si e kundërt me të. Të dyja janë trajtuar si përjashtuese të njëra-tjetrës; ndjekja e njëres ka nënkuptuar doemos shkeljen e tjetrës.⁹

Para së gjithash, nën ndikimin e mendimit islam, e më pas edhe të Rilindjes, të skolasticizmit e të iluminizmit, të krishterët u hapën drejt jetës dhe afirmimit botëror. Mohimi dhe qortimi i botës, megjithëkëtë, asnjëherë nuk është çrrënjësuar në tërësi; është shoqëruar thjesht me heshtje. Me fitoren e romantizmit dhe të shekullarizmit, që rrodhën pas Revolucionit Francez, “natyralizmi” arrin të pushtojë dhe, herë pas here edhe ta mbizotërojë qëndrimin e krishterë ndaj natyrës dhe botës.

Islami nuk e pranon ndarjen në të shenjtë dhe profane. Botëkuptimi i Islamit përfshin sa *ed-dunjā*-në¹⁰ dhe sa *el-āhirah*¹¹, ku aspekti *dunjā* duhet të jetë plotësisht dhe pa shkëputje i lidhur me aspektin *āhirah*; gjë që tregon se aspekti *āhirah* ka rëndësinë absolute dhe përfundimtare. Aspekti *dunjā* shihet si përgatitje për aspektin *āhirah*. Në Islam çdo gjë është e përqendruar përfundimisht mbi aspektin *āhirah*; por që kjo nuk nënkupton asnjë lloj sjelljeje shpërfillëse apo të shkujesur ndaj aspektit *dunjā*.¹²

Myslimanët janë të vetëdijshëm për urdhrin e Zotit në Kuran, ku ata urdhërohen për të marrë pjesën që u takon në këtë botë.

Sipas Islamit, natyra është krijim dhe dhuratë. Si krijim ajo është teleologjike¹³, e përkryer dhe njëkohësisht, e hapur ndaj rregullimit. Ndërsa si dhuratë, ajo është një e mirë e padjallëzuar, e lënë në dorën e njeriut. Qëllimi i saj është t’i mundësojë njeriut realizmin e së mirës dhe arritjen e lumturisë. Ky gjykim i trefishtë: i rregullsisë, i qëllimësisë dhe i mirësisë karakterizon dhe përmbledh pikëpamjen e Islamit për natyrën.

për mëkat, nëse nuk ka ligj. Por vdekja mbretëroi nga Adami deri te Moisiu dhe mbi ata që nuk kishin mëkatar me një shkelje të ngjashme nga ajo e Adami, që është figura e atij që duhej të vinte.” (Romakëve, 5/12-14)

8. “Prandaj po ju them: mos u shqetësoni për jetën tuaj, për atë që do të hani dhe do të pini, as për trupin tuaj e as për atë që do të vishni. A nuk është vallë jeta më me vlerë se ushqimi dhe trupi, më me vlerë se veshja? Vini re zogjtë e qiellit.

9. *Tevhidi*, f. 106, vep. e cit.

10. Këtë jetë.

11. Jeta tjetër, ajo që vjen pas jetës në këtë botë.

12. El- Attas, S. M. N. (2011) *Hyrje në metafizikën e Islamit*, f. 11-12. Shkup: Logos-A.

13. E qëllimshme; domethënë, e krijuar me një qëllim të mirëpërcaktuar.



Pesë stacione në leximin e *Israsë* dhe të *Miraxhit*

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Temën time të kësaj nate të madhnueshme, dua ta fokusoj në pesë ndalesa, nëpërmjet të cilave shpresoj të hedh sadopak dritë në leximin e drejtë, që pason kuptimin dhe nxjerrjen e mësimëve nga ndodhia e *Israsë* dhe e *Miraxhit*, mrekullisë së përjetësuar në dy prej sureve të Kuranit, në “*El-Isra*” dhe në “*En-Nexhm*”.

Së pari, duhet të kuptojmë drejt se kushtet dhe rrethanat në të cilat ndodhej Resulull-llahi (a.s.), pas dhjetë viteve thirrje plot përkushtim, të kurejshëve dhe banorëve të Mekës drejt Thirrjes së Teuhidit, ishin rënduar maksimalisht.

35 ditë pas vdekjes së nënës tonë Hadixhe, gruas së tij fisnike, ndërroi jetë edhe xhaxhai i pejgamberit tonë, Ebu Talibi. Ai njihej si përkrahësi dhe mbrojtësi i tij kryesor nga çytjet dhe agresioni i kurejshëve.

Në ato ditë të vështira për moralin dhe gjendjen emocionale të profetit, kurejshët nisën ta intensifikonin armiqësinë e tyre ndaj të dërguarit, duke u shtuar fjalëve vepra konkrete. Dy janë personazhet e palës idhujtare, që spikasin me arrogancën e tyre kundër Resulull-llahit (a.s.), Ukbe ibn Ebi Muajjit dhe Ebu Xhehl ibni Hisham.

I pari, arriti deri në atë gradë, sa ta thoshte shehadetin në tallje dhe më pas të pështynte në fytyrën e Resulull-llahit (a.s.), natën kur i dërguari mori pjesë në gostinë e shtruar nga Ukbe, me rastin e martesës së të birit¹. Ndërkohë, Ebu Xhehli, një ditë teksa Resulull-llahi (a.s.), falej para Qabes së Madhnueshme, urdhëroi dikë që, kur profeti të shkonte në sexhde, t’i hidhte mbi shpinë e kokë të brendshmet e disa deveve të therrura një ditë më parë,

1. Muhamed El-Habesh, “Siretu Resulil-lah”, Damask, 1996, fq. 84.

dhe ashtu u veprua.²

Ibni Is’haku tregon se, pasi vdiq Ebu Talibi, kurejshët nisën ta lëndonin shumë Resulull-llahin (a.s.), sa një ditë, njëri prej tyre i hodhi një grusht dhë mbi kokë. Ashtu në atë gjendje, i dërguari hyri në shtëpinë e tij dhe, teksa e bija që qante nga kjo pamje, i pastronte kokën, ai (a.s.), i thoshte: “Mos qaj moj bijë, se Allahu e ruan babën tënd!”³ Pra, një armiqësi e dukshme dhe një mungesë dialogu pa shpresë!

Së dyti, i dërguari i Allahut është shembull dhe si i tillë, me veprën e tij na mëson se thirrësi drejt të vërtetave nuk ndalet asnjëherë në rrugën e tij. Ai rend nga një vend në një tjetër, por asnjëherë nuk heq dorë nga thirrja drejt së vërtetës!

Pasi mekasit e refuzuan thirrjen e tij, hz. Muhamedi (a.s.), u drejtua nga qyteti i Taifit, 75 km larg Mekës. I shoqëruar edhe nga Zejd ibni Harithe, u largua nga vendlindja drejt një realiteti tjetër, me shpresë se dikush do të udhëzohej në besimin e Njësisë së Zotit! Fillimisht, trokiti në dyert e zotërinjve të Taifit, Abd Jalejl, Mesud dhe Habib, të bijtë e Amr ibn Umejr Thekafut.

I pari i tha: “Unë e shqyej mbulesën e Qabes, nëse Allahu të ka dërguar ty profet!”.

I dyti i tha: “A nuk ka gjetur Allahu dikë tjetër përveç teje, që ta dërgonte profet?!”.

I treti, nuk denjoi as ta priste, por i nxori një nga shërbëtorët e tij dhe i tha: “Nëse ti je profet, nuk i takon një

2. Po aty, fq. 84-85.

3. Safijjurr-rrahman El-Mubarekfuri, “Siretu Resulil-lah”, Bejrut, 1997, fq. 118.

njeriu si unë të flasë me profetë. E, nëse je mjeran, një si unë nuk denjon të flasë me mjeranë!”⁴

Pasi kërkoi prej tyre ta lejonin, qoftë edhe të jetonte i izoluar në mes tyre, t’u mësonte fenë e Allahut njerëzve përreth, ata e refuzuan dhe urdhëruan fëmijët ta gjuanin me gurë, derisa i ra të fikët. Nuk u mjaftuan me kaq, e kapën për krahësh dhe vazhduan ta godisnin e ta gjuanin, sa i rrodhi gjak nga koka te këmbët...

Me ndihmën e Zejdut u largua e, pasi u zgjua nga ajo gjendje e rëndë, i mërzitur, i thyer, i lënduar iu drejtua Zotit të tij me një lutje, që është pikë referimi për secilin prej nesh, kur kaplohet nga padrejtësia dhe hallet në jetë: *“All-llahumme ty të ankohen për dobësinë e fuqive të mia dhe situatën e rëndë në të cilën gjendem... Të lutem të më mbrosh nga poshtërimi njerëzor. Ja Errhamerr-Rrahimine! Ti je Mbrojtës i të dobtëve. Ti je Zoti im. Në dorë të kujt po më lë?... O Krijuesi im, nëse Ti nuk je i hidhëruar me mua, atëherë nuk mërzitem për të gjitha këto vuajtje...”*⁵

Në ato momente, kur e ngriti kokën, kishte mbërritur Xhibrili dhe meleku i maleve. Tashmë, fatet e Taiftit ishin në dorën e Resulull-llahit (a.s.), i cili përzgjedhi mëshirën dhe shpresën e brezave të ardhshëm, që do ta lartësonin Fjalën e Teuhidit dhe ashtu ndodhi...

Së treti, nata e 27- të e muajit Rexheb. Kishte mbërritur nata e shpërblimit të durimit, nata e mrekullive, nata e shpërblimeve universale. Atë natë e përshkruajnë ajetet e para të sures El-Isra: *“I patëmeta është Ai që bëri të mundur udhëtimin natën të robit të Tij nga Meka në Kuds, rrethinat e së cilës i kemi begatuar, që t’i tregojmë Atij prej argumenteve tona...”*⁶

Atë natë, librat e historisë rrëfejnë namazin e Zotërisë së bijve të Ademit, si imam i krejt peygamberëve!⁷ Ky argument është thirrje që myslimani të jetojë me krenari, si pasues i Muhamedit (a.s.). Prandaj, është e domosdoshme t’i themi njëri-tjetrit: *“Ngrije kokën, se profeti yt është Muhamedi (a.s.)”*.

Së katërti, lartësimi nga Kudsi drejt hapësirave qiellore, sipas rrëfimit të Malik ibni Sa’sasë, që dëshmon se kur i dërguari fliste për Isranë dhe Miraxhin, ndër të tjera thoshte: *“...Pastaj u fala dy rekate në Bejtul-Makdis dhe dola. Xhibrili më solli dy enë, njëra me qumësht dhe tjetra me verë; zgjodha qumështin. Xhibrili më tha: Zgjedhe fitran (natyrën e pastër, me të cilën i ka krijuar Zoti krijesat e Tij)”. Pastaj u ngritëm në qiellin e parë, ku u takova me Ademin, i cili më mirëpriti dhe u lut për mua. Pastaj në qiellin e dytë, ku u takova me Isain, të birin e Merjemes dhe Jahja ibni Zekerijanë. Pastaj në qiellin e tretë, me Jusufin. Pastaj në të katërtin, me Idrisin. Pastaj në të pestin, me Harunin. Pastaj në të gjashtin, me Musain. Dhe në të shtatin, me Ibrahimin, që kishte mbështetur shpinën e tij te Bejti Ma’muri, në të cilin hynin çdo ditë 70 mijë melekë, që nuk dilnin më prej aty. Pastaj u*

4. Muhamed Rida, “Muhamedun Resulull-llah”, Bejrut, pa vit botimi, fq. 136-137.

5. Ibn Hisham, “Es-sirretun-nebevije”, Bejrut, 1996, botimi i tretë, vëll. II, fq. 47.

6. Kur’ani, sureja “El-Isra”, ajeti: 1.

7. Dr. Mervan Shejkhulerd, “Es-sirretun-nebevije”, Damask, 2003, vëll. I, fq. 274.

*mora drejt pemës së Sidretul-Muntehasë me gjethe të mëdha si veshë elefanti... derisa e mbuloi urdhri i Zotit dhe askush prej krijesave nuk mund ta përshkruajë më bukurinë e saj... Aty Allahu më urdhëroi faljen e 50 namazeve në ditë...”*⁸

Së pesti, kthimi në Mekë dhe lajmërimi për ndodhinë. Kush do ta besonte një ngjarje të tillë, që ndodhi brenda një nate, rreth 1420 vite më parë? Për këtë Allahu urdhëron në suren El-Enam, 111: *“Edhe sikur t’u dërgonim atyre melekët, t’i bënim të vdekurit t’u flisin atyre dhe t’u tubonim të gjitha gjërat para tyre”,* ata përsëri nuk do të besonin, nëse Allahu nuk do të donte; por shumica e tyre janë të paditur!¹⁰

Të nderuar lexues!

Ajo që dua të nxis nëpërmjet kujtimit të këtyre stacioneve, në leximin e Israsë dhe Miraxhit, është vullneti për të shikuar secili në zemrën e tij, për të gjetur dashurinë e Allahut dhe të dërguarit të Tij. Më pas, i udhëhequr nga kjo dashuri, të ndërtojë jetën, sado që ta ketë shkatërruar më parë, sepse Allahu është falës dhe udhëzimi është vetëm në dorën e Tij!

Duke lexuar Isranë dhe Miraxhin, myslimani në çdo kohë, mëson se Allahu (xh.sh.), nuk e lë në baltë robin e Tij, të përlurur, atë që i ka kushtuar jetën dhe ka vendosur ta ndërtojë atë sipas pëlqimit të Tij. E pëlqimi i Allahut është miradia e njeriut në këtë botë dhe në tjetrën! Si jo, kur në Kuran ka urdhëruar zënien e dijës dhe perfeksionimin e shkencave. Ka nxitur pastërtinë, martesën, fitimin e hallallit, dhënien dhe solidarizimin me të varfrit. Ka urdhëruar ndërtimin e një shteti të fortë, bindjen ndaj prijësit të drejtë, këshillën në shoqëri, ruajtjen nga thashethemi dhe distancimin nga përfolja. Ka ndaluar në mënyrë kategorike konsumimin e pijeve dehëse. Ka nxitur ruajtjen e nderit dhe të kurorës, mbulimin e femrës dhe ruajtjen e shikimit. Ka shenjtëruar vëllazërimin dhe dashurinë për hir të Tij, si dhe ka udhëzuar drejt harmonisë dhe dialogut ndërtues me pasuesit e Librit. Ka urdhëruar respektin ndaj prindit dhe na ka ndaluar t’u themi qoftë edhe “uf”. Të gjitha këto e të tjera, të përshkuara nga lidhësa e përmendjes së vazhdueshme e Allahut, në të mirë dhe në të keqe. Në këmbë e të shtrirë. Në qetësi e në lëvizje.

A mund ta bëjmë ne këtë, që të meritojmë të quhemi myslimanë apo e kemi të vështirë të ndahemi nga zakonët dhe veset e rëndomta që na përkufizojnë si njerëz primitivë dhe të paqytetëruar?

Përgjigjen më të drejtë duhet ta dëshmojë sjellja dhe vepra e secilit prej nesh!

Mubarek Isranë dhe Miraxhin!

Shkodër, 15 qershor 2012

8. Sipas transmetimit të Bukhariut.

9. Dmth: “T’u tubonim para syve krejt mrekullitë e kërkuara prej tyre” – Grup autorësh, “El-meusuatul-Kur’anijjetul-mujessere”, Damask, 2002, botimi i dytë, fq. 143.

10. Kuptimet e këtij ajeti janë marrë nga: “Kurani i madhërishtëm”, përkthyer nga prof. Hasan Nahi, botim i AIITC, Tiranë, 2008, botimi i VI-të, fq. 181. Duhet të theksoj se në përkthimin e këtij ajeti në këtë botim, ka një gabim të dukshëm: “dhe t’i tubonim”, që në fakt duhet të jetë: “dhe t’u tubonim”, siç e kam shkruar më lart. Vall-llahu a’lem. Prandaj, lexuesi të jetë i kujdesshëm me këtë fakt! Autori.

NJERËZIT QË HANË BESIMIN E TYRE

Abdurrahman Xhandan

Ndodhemi midis së shkuarës dhe së ardhmes, brenda vorbullës së kohës. Me gjithë thyerjet historike që kemi jetuar, Kurani na pyet: **“Ende nuk po mendoni?”** Prishja e vazhdueshme që po ndodh, po bie si një kancer mbi të gjithë shoqërinë. Anët e pangopshme të njeriut po kacavirren me egërsi në mendjen e tij dhe bota po bëhet dëshmitare e gjenocideve të paimagjinueshme. Kriza ekonomike dhe padrejtësitë sociale, të cilat ranë si ortek mbi qenien e dobët njerëzore, kanë kthyer përmbys edhe vlerat e saj.

Njerëzit që kanë uri trupore dhe shpirtërore, hanë besimin e tyre. Një njeri që e ka barkun bosh, mund të tentojë vjedhjen pa frikë dhe pa e vvarë ndërgjegjja. Dikush tjetër, thjesht për interesa të ngushta, mund të gënjejë ose të mashtrrojë. Ndërsa ligjet ekzistuese po e humbasin dita ditës fuqinë e tyre. Besa e dhënë nuk respektohet, sepse nuk respektohet as besimi në botën tjetër. Në çdo fushë të jetës, shkelja e të drejtave është bërë diçka e pandalshme. Amaneti nuk respektohet. Numri i myslimanëve, të cilët e

neglizhojnë namazin, po shtohet. Zemrat, të cilat janë të sigurta se pasuria shtohet duke dhënë për hir të Allahut, po pakësohen. Po vërehet se ata që janë të ngarkuar për të siguruar paqen dhe qetësinë shoqërore, nuk po e kryejnë detyrën e tyre. *“Kur pasuria është tek koprinci, arma tek frikacaku dhe mendimi tek i dobëti, prishet rregulli shoqëror.”* Kjo thënie e Ebu Bekrit (r.a.), sikur është posaçërisht për kohën në të cilën jetojmë.

Në një kohë, kur sipas “vlerave të përbashkëta” njerëzore të quajtura kritere, grabitja, intrigat, dhuna dhe veprimet e shëmtuara janë të ndaluara dhe asnjë sistem nuk i pranon, përse njerëzit, të cilët pranojnë se i kanë përvetësuar këto vlera, hedhin hije mbi to? “Koha e krizës është kohë kur sprovohet besimi i njerëzve.” Çfarë personaliteti kanë ata që, sapo të bien në vështirësi, shkelin vlerat në të cilat besojnë? Njerëzit që nuk respektojnë vlerat të cilat i kanë përvetësuar më parë, padyshim që kanë probleme me moralin, sepse ajo që u jep formë veprimeve të njerëzve, është ajo që mbartin përbrenda tyre. Ajo që cakton drejtimin e lëvizjes së tyre, nuk është vetëm dituria. Nëse çdo dituri që kalon në sitën e vahjit (shpalljes) nuk zë vend në të

“Njeriu i uritur ha besimin e vet.”

Viktor Hygo

njëjtën kohë edhe në mendje edhe në zemër, pra nëse individ i nuk ka arritur të formojë moralin e tij, humbja nuk është e largët. Nëse niveli i shkencës që ka arritur një njeri apo një shoqëri nuk është i njëjtë me nivelin e virtyteve morale, nuk është e drejtë të themi se ata kanë përparuar.

Për shkak se besimi i myslimanit është dëmtuar, edhe veprat e tij kanë filluar të prishen. Kur nuk konceptohet mjaftueshëm përbërja e “asaj” që besohet, shkatërrimi mund të vijë edhe nga një goditje e lehtë. Bota shpirtërore e individëve që nuk e kanë të fortë dinamizmin e brendshëm, është e errët. Prandaj, nuk mjaftojnë disa shkëndija për ta ndriçuar atë. Në kohën tonë, kur problemet psikologjike kanë shënuar rritje drastike, po kërkohen gjëra të cilat do të mbushin boshllëkun e brendshëm dhe do të qetësojnë zemrat.

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (er-Ra’d, 28)

Ja pra, dorëzimi pa asnjë lloj dyshimi ndaj Zotëruarit të gjithësisë, është zgjidhja e vetme, e cila do ta çojë shoqërinë drejt paqes dhe qetësisë. Ndonjëherë mund të ndodhë që edhe një mysliman të bjerë në këtë gjendje të vështirë shpirtërore. Kjo, për arsye se nuk e përmend sa duhet dhe siç duhet Allahun dhe se nuk i praktikon me përpikëri urdhrat e Tij. Dorëzimi ndaj pengesave dhe hileve, të cilat e largojnë atë nga detyra e tij, bëhet shkak i shkatërrimeve të tilla.

Shkaku kryesor i krizës që po kalon shoqëria njerëzore, është mosaplikimi në standardin jetësor i të vërtetave të cilat i besojnë. Vlerat që neglizhohen në çdo pjesë të jetës së tyre të copëtuar, duke synuar përmirësimin e së ardhmes, i bën ata edhe më të humbur. Njerëzit që tregojnë dobësi në besim, janë më afër humnerës. Sjelljet që janë

në kundërshtim me natyrën e pastër njerëzore, e bëjnë njeriun më të mjerë (jo të lumtur). Nëse ka ndonjë konflikt midis mënyrës së jetesës dhe vlerave që mësohen dhe, nëse ky konflikt shtohet vazhdimisht, do të thotë se aty ka lindur një problem shoqëror. Humbja e drejtësisë dhe sigurisë, tregon urinë e madhe materiale dhe shpirtërore. Mbushja e barkut të një njeriu me shpirt të uritur, nuk mund të ruajë ekuilibrin shoqëror. E rëndësishme është që zemra të ushqehet me një ushqim të pastër. Ndërsa kjo arrihet vetëm me anë të Kuranit. Njeriu, shpirti i të cilit ka arritur paqen, tregon durim edhe në besimin e tij.

“Bindju asaj që të është shpallur nga Zoti yt...” (el-Ahzab, 2.) Ky urdher hyjnor hap derën e paqes dhe fitimit më të madh. Nëse mirësitë e kësaj bote nuk kanë formuar ambicie brenda njeriut, nuk është e mundur që ai të veprojë diçka që nuk i ka hije besimit të tij. Njerëz të tillë, kur bien në vështirësi, nuk i kthejnë kurrizin të vërtetës, qoftë ajo edhe kundër tyre. Sido që të jetë **“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun...”** (el-Fatir, 15.) Pra, për shkak se ata e dinë se janë nevojtarë për Të dhe që të kenë fytyrë për t’i kërkuar Atij, qëndrojnë larg nga këto lloj gabimesh. Ata gjithmonë mundohen që për hir të Allahut të mbajnë në këmbë drejtësinë.

Viktor Hygo, në shtratin e vdekjes tha: **“Unë i besoj Allahut dhe botës tjetër. Jeta ime është dëshmia më e fortë për këtë.”** Për të arritur qetësinë dhe sigurinë e kësaj ata mundohen t’u qëndrojnë besnikë vlerave të cilat i besojnë. Shkaku i vetëm, i cili e mban të gjallë në mendje këtë mendim, është forcimi i mendjes dhe i zemrës nën aprovimin e vahjit (shpalljes).



Përbërja thelbësore
e njeriut
është
dhe *Dëlirësia*
Pafajësia

Prof. dr. Shinazi Gyndyz

Këndvështrimi i feve rreth përbërjes thelbësore të njeriut është i rëndësishëm. Islami, i cili e përkufizon njeriun si mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë, e përcakton atë si një qenie që mund të përdorë vullnetin e tij të lirë me mendimet, sjelljet dhe veprimet personale. Gjithashtu në Islam, njeriu shikohet si **eshref-i mahlukat**, d.m.th. si krijesa më e ndershme dhe thekson se njeriu është krijuar në formën më të përsosur.

Me fjalë të tjera, Islami tërheq vëmendjen për vlerat e barabarta nga aspekti se gjithë njerëzia duhet të jetë një: pa dallim race, ngjyre dhe gjinie. Ai është krijesa që ka aftësi të përdorë vullnetin e vet. Paralelisht me këtë, ai është i përgjegjshëm dhe është krijesa më e ndershme midis të gjitha krijesave të tjera.

Gjithashtu, Islami thekson se përbërja thelbësore e njeriut është dëlirësia dhe pastërtia-sinqeriteti. Kurani na bën të ditur se të gjithë njerëzit kanë prejardhje nga

një racë dhe se babai i të gjithëve është Ademi bashkë me Havanë. Ai na sjell ndërmend një fjalë-premtim që është marrë nga njeriu qysh para se të ekzistonte si individ. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë: **“Përkujto kur Zoti yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuës të vetes së tyre (duke u thënë): “A nuk jam Zoti juaj?” Ata thanë: “Po, dëshmuam!” Të mos thoni në Ditën e Kijametit: “Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur.”**

Çfarë paraqet ky premtim që u mor nga e gjithë njerëzia? Këtë e shpjegon më mirë hadithi i Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, i cili në një transmetim të Ebu Hurejres, *radijallahu anhu*, thotë: *“Çdo bir i Ademit lind në natyrshmëri (për të besuar një Zot). Pastaj prindërit e tij e kthejnë atë në hebre (çifut), në të krishterë dhe (ose) e bëjnë zjarr-adhurues. Nëse prindërit e tij janë myslimanë*

1. Araf: (7/172).

edhe fëmija e tyre do të jetë mysliman.”²

Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, këtu na tërheq vëmendjen se të gjithë njerëzit lindin me natyrë të dëlirë dhe të pastër dhe se Allahu i Lartësuar e ka krijuar çdo njeri të pastër nga mëkatet. Islami e ka quajtur këtë gjendje të dëlirësisë dhe të partërtisë si një **“natyrshmëri”**. Sipas kësaj, njeriu që lind me këtë natyrshmëri, e formon dhe e zhvillon më pas personalitetin e tij fetar dhe moral sipas udhëzimeve që merr nga mjedisi shoqëror dhe veçanërisht nga udhëzimet edukative, kulturore dhe disiplinore të prindërve të tij. Ndërsa formimi personal i njeriut, pothuajse përfundon që nga periudha e adoleshencës. Prandaj, para periudhës së pubertetit (*adoleshencës*), Islami e ka çliruar njeriun nga përgjegjësia, të cilën e quan **“përgjegjësi e bartjes së obligimeve fetare”**. Për rrjedhojë, Islami nuk i vështron fëmijët vetëm nga pikëpamja e kombeve prej të cilëve kanë ardhur, por i vështron të gjithë ata si në origjinën që i ka krijuar Allahu: të thjeshtë, të pastër dhe të pafajshëm, pa marrë parasysh racën, ngjyrën dhe gjininë, cilado qoftë ajo. Edhe Profeti, *salallahu alejhi ue selem*, në hadithin që po trajtojmë na tërheq vëmendjen për këtë gjë.

Në disa fe, si Krishtërimi, në raport me këtë qëndrim të Islamit, njeriu përkufizohet si **“një qenie e robëruar nga mëkati i parë dhe nga vdekja”**. Krishtërimi, në raport me qëndrimin e Islamit, i cili konsideron pafajësinë e njeriut që nga lindja e tij, ose pavarësinë e tij ndaj mëkatisë dhe pajisjen e tij me vullnet të lirë, mbron varësinë e njeriut ndaj mëkatisë që prej lindjes së tij. Ky dallim teologjik formon themelin e trajtimeve të ndryshme të secilës palë nga të dyja fetë, në aspektin e të gjitha pikëpamjeve rreth njeriut.

Mendimi i krishterë mbron mëkatin dhe vdekjen që i është trashëguar njeriut që nga Ademi, robërimin e tij që prej lindjes dhe se mund të shpëtojë nga ky robërim vetëm me anë të besimit ndaj birit shpëtimtar të perëndisë, Mesihut (*Isait*) dhe se do të veshë rrobën e pavdekshmërisë. Si rrjedhim, Krishtërimi nëpërmjet pranimit të teorisë teologjike që parashikon, pretendon se njeriu do të shpëtojë nga ky robërim që është pjesë e unit natyror.

Por nga ana tjetër, Krishtërimi shpjegon robërimin e çdo njeriu nga mëkatet e të këqijat dhe si pasojë, nga robërimi ndaj dhunës që lind prej tyre si trashëgimi që ka mbetur prej njeriut të parë, Ademit dhe do të për-

hapet me një fuqi hyjnore të e gjithë raca njerëzore. Ndërsa të këqijat dhe veprat e dhunshme që rrjedhin prej njeriut, në një farë mënyre ia atribuojnë vullnetit hyjnor të karakteri i Ademit.

Kurani na bën të ditur se feja Islame, e cila është feja e vetme e pranuar te Allahu, thekson se përbërja thelbësore e njeriut është dëlirësia, pastërtia-sinqeriteti dhe pafajësia dhe shpreh se ky është nënshtrimi ndaj Allahut. **Ajo që kërkohet nga njeriu është që ai të qëndrojë i lidhur me karakterin e tij thelbësor dhe të mos e shkëpusë këtë lidhje.** Islami e shqyrton prishjen e këtij karakteri thelbësor si **“dëmtimi i vetë personit”** dhe e nxit njeriun të largohet nga kjo sjellje dhe qëndrim i tillë. Lidhja e ngushtë njeriut me përbërjen e tij thelbësore, së pari është mospranimi i një fuqie tjetër supreme përveç Allahut në jetën e tij, pra të pranojë vetëm Allahun si Zot dhe të mos i bëjë Atij asnjë ortak, partner. Me këtë udhëzim,

Kurani tërheq vëmendjen ndaj zotrave, perëndive të ndryshme ose fuqive sovraane që dalin në pah si fuqi supreme në jetën e njeriut; i propozon atij vetëm një fuqi supreme dhe kërkon prej tij që të disiplinojë jetën e tij sipas udhëzimeve të kësaj fuqie supreme. Kjo fuqi supreme që propozon Kurani nuk është një sistem / qeverisje sociale ose politike, as ambicie dhe dëshirë e njeriut për përfitime të interesave vetjake, nuk janë as krijesa të ndryshme metafizike dhe të ngjashme me to, që pranon dhe beson njeriu se ekzistojnë, por është Allahu krijuesi dhe sunduesi i gjithçkaje.

Me këtë, Islami në një anë thekson se fusha e lirisë së njeriut, i cili është krijuar si mëkëmbës i Zotit në tokë dhe me një karakter thelbësor të dëlirë, të pastër dhe të pafajshëm është e kufizuar nga kufijtë që ka përcaktuar vetëm Allahu; dhe nga ana tjetër thekson se sjelljet dhe veprat e njeriut me mendimin e tij të pastër e të painedoktrinuar nga ideologji e besime të kota, e ruajnë atë në jetën e tij nga përcaktimi i mjedisit social, politik dhe kulturor që e rrethon. Me fjalë të tjera, **Kurani kundërshton të gjitha fuqitë e tjera supreme që përpiqen të përcaktojnë me çfarëdo lloj mënyre fushën e lirisë së njeriut, nën pretekstin e sovranitetit ndaj tij; dhe e çliron atë nga mjedisi i tij shoqëror nën sovranitetin e Allahut.**

2. Muslim, Babu'l-Kaderi.





DOGANA E SHKODRËS
MARUBI 1890-1919

FOTOJA E MUAJIT



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, ndaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.” (Huxhurat, 10)

Çdo pjesë përbërëse e gjithësisë merr pjesë aktive, duke luajtur rolin e vet në gjithësi. Në këtë mënyrë, të gjithë elementët që përbëjnë gjithësinë, janë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin. Dimri përgatit pranverën, pranvera lajmëron për verën, kurse vera lajmëron për vjeshtën. Gjallesat kanë nevojë për bimë, bimët për tokë dhe toka ka nevojë për ujë.

Ndërsa pjesët e veçanta që përbëjnë natyrën, nuk shprehin asgjë, të pavaruara nga njëra-tjetra, kur janë të gjitha së bashku, krijojnë një panoramë, sa të bukur edhe estetike. Në këtë mënyrë, të gjithë së bashku, elementet përbërëse të natyrës formojnë një strukturë të vetme organike. Por çdo element në këtë gjithësi, merr pjesë ose jep kontributin e vet me veçoritë e tij individuale. Kjo i ngjason më shumë zërit që nxjerr një instrument muzikor, i cili përmes zërave të ndryshëm, krijon një zë të vetëm qetësues dhe të ëmbël për veshin e njeriut. Çdo element i gjithësisë i përngjason një pjesëtari të një kori të madh, të cilët këndojnë të njëjtën këngë.

Kurani i konsideron besimtarët si një shoqëri të përkushtuar ndaj të drejtës dhe që luftojnë së bashku për të vendosur drejtësinë në tokë. Besimtarët ushqejnë dashuri dhe dhembshuri për njëri-tjetrin dhe janë të palëkundur e të panënshtuar përballë jobesimtarëve.

Një herë Pejgamberi (a.s.), ndërsa po qëndronte me sahabët, thotë: “Në ditën e gjykimit do të ketë robër të Allahut, të cilët për nga afërsia që kanë me Allahun do të lakmohen nga pejgamberët dhe dëshmorët e rënë në rrugë të Allahut.” Sahabët pyetën me kureshtje: “Kush janë ata, o i dërguari i Allahut? “Ata janë besimtarët që e duan njëri tjetrin vetëm për hir të Allahut, pa ndonjë interes material apo lidhje fisnore.” (Ebu Davud, 76)

Ndjenja e dashurisë dhe harmonisë midis besimtarëve, është krejt ndryshe nga dashuria apo harmonia që ekziston në shoqëritë e tjera. Kjo dashuri, mbi të gjitha është një dhuratë e Allahut për besimtarët. Allahu i zbut zemrat e besimtarëve, duke i bërë vëllezër. (Allahu) **“duke i bashkuar zemrat e tyre** (si një zemër e vetme). **Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato. Ai është vërtet i Plotfuqishëm dhe i Urtë.”** (Enfal, 63) Ajeti e vendos vëllazërinë në zemër, në qendrën e dashurisë larg vëllazërisë formale dhe sipërfaqësore.

Sot, për të bashkuar njerëzit po krijohen organizata kulturore, politike dhe ekonomike dhe po harxhohet mund e pasuri për të arritur bashkimin. Por ky bashkim nuk mund të krahasohet me bashkimin rreth kauzës islame. Sepse ka një ndryshim të madh midis bashkimit fizik të një grupi njerëzish dhe bashkimit të zemrave.

Miqësia dhe vëllazëria midis besimtarëve nuk është thjesht një marrëdhënie emocionale, sepse marrëdhëniet emocionale janë të natyrshme për të gjitha qeniet njerëzore. Kurse vëllazëria dhe miqësia midis besimtarëve, është rezultat i lidhjeve pas besimit, mendimit dhe ndjenjave të përbashkëta.

Fatkeqësisht, sot bashkësia islame ka rënë pre e fanatizmit etnik, krahinor dhe sektar. Një sërë lojrash politike rrezikojnë bashkimin dhe unitetin e ymetit islam. Për këtë arsye, myslimanët kanë nevojë më shumë se kurrë për vëllazëri dhe bashkim ndërmjet tyre.

Një Hadith

*Transmetohet nga Ubade ibn Samit (r.a.)
se Resulullahi (s.a.v.s.) i ka thënë:*



“Më premtoni gjashtë gjëra, që t’ju premtoj xhenetin: Kur flisni, thoni të vërtetën, kur premtoni, mbajeni premtimin, kur t’ju jepet një amanet, çojeni në vend atë, ruani nderin, ruajuni prej shikimit haram dhe mos bëni padrejtësi.”

Ky hadith i Pejgamberit (a.s.), i transmetuar nga Ubade ibn Samit, ndër qindra vepra të mira, numëron gjashtë vepra të rëndësishme, zbatimi i të cilave e bën këtë botë parajsë, kurse në botën tjetër i garanton zbatuesit xhenetin. Në një hadith tjetër të Pejgamberit (a.s.), moszbatimi i tre të parave, pra gënjeshtria, mosmbajtja e premtimit dhe tradhtimi i amanetit, është konsideruar prej shenjave të hipokrizisë. Prandaj, cilësitë e përmendura më sipër, janë veçori të besimtarit të mirë.

Këto gjashtë virtyte janë parimet themelore të moralit individual dhe shoqëror. Besimtari i zbaton këto vlera të vyera morale, jo nga presioni i shoqërisë, por nga vetëdija se janë të mira. Besimtari përvetëson moralin e bukur, ngaqë ai beson se urdhëresat dhe këshillat e Allahut dhe të të dërguarit janë të mira. Nga gjashtë vlerat morale të përmendura, dy të parat kanë lidhje me gjuhën. Thënia e së vërtetës dhe mbajtja e premtimit janë dy çështje të rëndësishme, në zbatimin e të cilave nuk po kemi sukses. Kjo dobësi është konstatuar edhe në periudhën e Pejgamberit (a.s.). **“O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!”** (Saff, 2-3)

Premtimi i pambajtur, nga një anë është gënjeshtër, nga ana tjetër mosmbajtje fjale. Gënjeshtria është prej mëkateve të mëdha. Mbajtja e premtimit është tregues i cilësisë së besimit, prandaj Allahu e ka konsideruar si veçori të të devotshmëve. Pejgamberi (a.s.), në një hytbe i urdhëroi besimtarët të respektojnë me rigorozitet të gjitha marrëveshjet e nënshkuara në periudhën paraislame, sepse myslimani e ka obligim qëndrimin mbas fjalës së dhënë. Për këtë arsye, Pejgamberi (a.s.), u qëndroi besnik marrëveshjeve të bëra me politeistët dhe për hir të marrëveshjes, bëri shumë sakrificat. Në këtë kontekst, mund të përmendim rastin e Ebu Basirit, i cili u burgos, ngaqë pranoi Islamin, por që arriti të largohej nga Meka për në Medine, pas marrëveshjes së Hudejbijes. Sipas marrëveshjes, çdo Mekas mysliman që kërkonte strehim në Medine, do të kthehej mbrapsht dhe Kurejshët nuk vonuan dhe erdhën për të kërkuar Ebu Basirin, sipas marrëveshjes së nënshkruar. Muhamedi (a.s.), iu drejtua Ebu Basirit me këto fjalë: **“O Ebu Basir, siç e di edhe ti, ne u kemi dhënë fjalën Kurejshëve dhe në fenë tonë nuk ka vend pabesia. Ty dhe besimtarëve të tjerë si ti, Allahu do t’ju gjejë një zgjidhje.”** Pas kësaj, e nisi me kurejshët.

Një rast tjetër i ngjashëm, është edhe rasti i Ebu Rafiut, të cilin Kurejshët e patën dërguar si përfaqësuesin e tyre në Medine, por sapo kontaktoi me Pejgamberin (a.s.), i lindi dëshira për t’u bërë mysliman dhe shprehu dëshirën për të qëndruar në Medine. Por Pejgamberi (a.s.), i tha: **“Unë nuk e prish marrëveshjen.”** Nga jeta e Pejgamberit mësojmë se mbajtja e fjalës së dhënë, qoftë edhe karshi armiqve, është prej moralit të besimtarit. Vlerat që përmend hadithi, janë vlera që e ngrenë njeriun, nga një qenie biologjike, në një qenie morale. Identiteti mysliman mund të ruhet vetëm duke i zbatuar këto vlera, prandaj të parët tanë kanë thënë: **“Fjala është nder”.**

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Rëndësia e zbatimit të këtyre gjashtë porosive.
2. Garantimi i xhenetit përmes tyre.

Nga lulishita e zemrës

Osman Nuri Topbash



Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

GJENDJA E HIÇIT

“Nëse ti prej vetes del, vetëm Ai që të ka krijuar ngel!”

Ashtu si çdo krijesë, njeriu ishte “asgjë” dhe nuk i përmendej as emri. Pastaj, doli në skenën e jetës me urdhrin hyjnor **“Kun! / Bëhu!”** falë mirësisë dhe bujarisë së Allahut. Pra, doli prej mosekzistimit në botën e “ekzistencës”.

Njeriu nuk ka paguar asgjë për të “ekzistuar”. Ai ekziston thjesht për shkak të mirësisë dhe bujarisë hyjnore. Mbi të gjitha, është krijuar në **“ahsen-itakuim / formën më të bukur”** dhe është pajisur me aftësi të veçanta që e kanë bërë atë **“eshref-i mahlukat”**, pra, **“më fisnikun prej krijesave”**. Për këtë arsye, njeriu ka për borxh falënderime të pafundme ndaj Krijuesit të tij.

Pika më e rëndësishme e kësaj çështjeje, është të paguarit për mirësinë e **“imanit”**, sepse të pretendosh pronësi mbi diçka për të cilën nuk ke paguar, do të thotë të merresh me punë të padobishme. Kurse xheneti dhe shikimi i Allahut, janë mirësia dhe bujaria e veçantë e Allahut Mëshirëplotë si shpërblimi i besnikërisë, miqësisë dhe devotshmërisë.

Edhe vetë profetët që kanë bërë një jetë të devotshme, kanë rrefyer dobësinë e tyre për të larë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut ashtu siç e meriton. Profeti ynë (a.s.), ka falur namaz nate deri sa i janë enjtur këmbët. Rrobat, mjekra e tij e bekuar dhe vendi ku binte në sexhde, janë lagur nga lotët e tij të bekuar. Kur i thanë:

“O i Dërguar i Allahut! Përse qani kaq shumë, kur Allahu jua ka falur të gjitha gabimet e shkuara dhe të ardhme?”, ai është përgjigjur:

“A të mos bëhem prej robërve që e falënderojnë shumë Allahun?..” (Shih. Ibën Hibban, II, 386)

Pra edhe vetë Profeti (a.s.), që ishte robi më i dashur i Allahut, jetonte me vetëdijen se, sado që të bënte adhurime, nuk do t’ia arrinte kurrë të lante borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut ashtu siç duhet. Zemra që mbështillte botët me mëshirë, përpëlitej përpara Hakut me ndjenjën e të qenit asgjë. Për këtë arsye, çdo gjë që bënte, e quante gjithmonë të pamjaftueshme, madje “asgjë” dhe vazhdimisht mendohej të shtonte nënshtrimin dhe përgjërimin.

Sa herë që e shihte se sa e mangët dhe e zhveshur ishte gjendja e tij e devotshmërisë përballë Madhësisë së Allahut, bënte teube dhe kërkonte falje. Në disa hadithe fisnike Profeti (a.s.), është shprehur:

“*Vallahi unë i kërkoj falje Allahut më shumë se shtatëdhjetë herë në ditë...*” (Buhari, Deauat, 3; Tirmidhi, Tefsir, 47)

“*Ndonjëherë ndodh që zemra ime të turbullohet. Por unë i kërkoj falje Allahut njëqind herë në ditë.*” (Muslim, Dhikir, 41)

Sigurisht, që në të shumtën e rasteve, Profeti (a.s.), nuk kërkonte falje dhe nuk bënte teube për shkak të gjynaheve apo gabimeve, por nga një anë për të larë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut dhe nga një anë tjetër për të arritur kënaqësinë e Tij. Pra, për shkak të dëshirës së tij të madhe për t’iu afruar sa më shumë Allahut. Kjo, sepse Profeti (a.s.), ndodhej gjithmonë në një ngritje shpirtërore të vazhdueshme dhe kërkonte falje e bënte teube për gjendjen në të cilën ndodhej më parë.

Përgjërimin e tij ndaj Zotit brenda një horizonti të tillë shpirtëror, na e transmeton edhe nëna e besimtarëve, Aisheja (r.anha.):

“Një natë, kur u ngrita nga shtrati, nuk e gjeta pranë meje të Dërguarin e Allahut. Menjëherë mendova se

mund të kishte shkuar tek ndonjë prej grave të tjera. Por kur kontrollova me dorë përreth vetes, dora ime ceku këmbët e tij. Në atë moment e kuptova se i Dërguari i Allahut ndodhej në sexhde. Fillova të dëgjoja dhe ndjeva se ai po qante me dënësë dhe i përgjerohej Allahut kështu:

"O Allah! Strehohem në kënaqësinë Tënde prej zemërit Tënd dhe në faljen Tënde prej dënimit Tënd! O Allah! Strehohem tek Ti prej Teje. Unë nuk jam i aftë të të lavdëroj e të të falënderoj ashtu siç e meriton! Ti je ashtu siç e ke lëvduar dhe madhëruar veten Tënde!" (Muslim, Salat, 222.; Tirmidhi, Deauat, 75/3493)

THELBI I DEVOTSHMËRISË SË PASTËR

Detyra më e rëndësishme për ne njerëzit, është të mundohemi të lajmë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut. Edhe krijimi prej asgjësë, është një mirësi për të cilën jemi të paaftë të falënderojmë... Po mirësia e të qenit njeri midis të gjitha krijesave, e të qenit besimtar midis gjithë njerëzve, e të qenit prej umetit të Muhammed Mustafait (a.s.), në mesin (sipas transmetimeve) e 124 mijë profetëve?..

Edhe sikur të biem në sexhde, në shenjë falënderimi përballë Allahut për të gjitha këto mirësi dhe të mos e ngremë kokën gjatë gjithë jetës, përsëri është pak, përsëri është e mangët, madje

një "hiç"...

Sa bukur dhe sa qartë e shpreh ky hadith këtë fakt:

"Nëse një njeri, me qëllim që të fitojë kënaqësinë e Allahut, do të mendohej të mos e ngrinte kokën prej sexhdes që nga dita në të cilën lind e deri në ditën që do të plaket e do të vdesë, në ditën e kijametit, (me mendimin se ka qenë i dobët në falënderimin e Allahut për të gjitha mirësitë që i ka falur) përsëri veprat e tij do t'i dukeshin të pakta". (Ahmed, V. IV, s. 185)



*"Mbështetu në të Plotfuqishmin,
Mëshirëplotin."* (Shuara, 217)

"O Allah! Strehohem në kënaqësinë Tënde prej zemërit Tënd dhe në faljen Tënde prej dënimit Tënd! O Allah! Strehohem tek Ti prej Teje. Unë nuk jam i aftë të të lavdëroj e të të falënderoj ashtu siç e meriton! Ti je ashtu siç e ke lëvduar dhe madhëruar veten Tënde!"

Pra, edhe një jetë e tillë, e mbushur me adhurime, nuk do të mjaftonte për shpëtimin e përjetshëm. Mirëpo, Allahu, së bashku me punët, do të shohë edhe zemrat tona, sepse Ai kërkon prej nesh zemra të pastra. Dhe zemra e pastër është e lidhur ngushtë me shpirtin e mbushur me ndjenjat e **"hiçit dhe dobësisë"** përballë Allahut...

Tek Allahu fitojmë vlera vetëm:

Kur mundohemi të bëjmë një jetë me pjekuri shpirtërore. Kur jemi të devotshëm dhe të bindur. Kur falënderojmë dhe i lutemi Allahut...

Kur jemi të vetëdijshëm se, nëse nuk na mëshiron Allahu, asnjë prej punëve tona të sinqerta nuk do të mund të na shpëtojë...

Kur të mos harrojmë se ashtu si lutjet tona, edhe adhurimet tona kanë nevojë për pranimin hyjnor...

Kur, në vend që t'ua besojmë veprave tona, lutemi dhe shpresojmë që Allahu të na falë...

Kjo pra është pjekuria shpirtërore, që përbën thelbin e një devotshmërie të pastër...

ÇDO GJË FILLON PAS MOSEKZISTENCËS

Jeta që kalohet me adhurime dhe me pjekuri shpirtërore, e ngre robin në lartësitë e miqësisë me Allahun, sepse dritarja e zemrës nuk hapet, nëse nuk përparon në përlulësi, modesti dhe devotshmëri ndaj Allahut...

Për këtë arsye, nënshtrimi i "egos" me aq sa mundesh, është një nga çështjet më të rëndësishme të tasavufit. Në lidhje me këtë çështje, që prej shumë kohësh është bërë zakon që në muret e teqeve të vendosen tabela, ku me art kaligrafie shkruhen thënie që përmbajnë këshilla dhe tërheqin vëmendjen.

Në një nga këto tabela, shkruhet "**hiç**", e cila nënkupton faktin se për të përfituar prej mëshirës hyjnore, është kusht që më parë të çlirohesh nga dëshirat dhe epshet e nefsit. Pra, pa arritur gjendjen e "hiç"-it, duke u zhveshur prej egos, nuk mund të bëhet fjalë për përsosmëri shpirtërore.

Bota e brendshme e çdo njeriu, ndjek një udhëtim midis animeve nga gjynahu dhe devotshmërisë... Jeta sipas qejfeve të egos, në çdo ngjarje e rrit më tepër egon, ndërsa jeta sipas vlerave morale dhe shpirtërore, nxit gjendjen e hiçit dhe të bën të kuptosh se çdo mirësi është dhuratë prej Allahut Teala.

Edhe lufta brenda nesh, është luftë midis egos dhe hiçit. Nëse arrijmë t'i mundim dëshirat e nefsit dhe gjynahet, do e kthejmë "egon", pra mendjemadhësinë, mburrjen dhe krenarinë në një "hiç". Në rrugën e pjekurisë shpirtërore, çdo gjë fillon pasi "hiç"-i të ketë fituar mbi "egon". Edhe e fshehta e thënies: "**Kush e njeh nefsën e tij, njeh edhe Zotin e tij**", arrihet të kuptohet pas asaj pike. Pra, pas asaj pike i bëhet e mundur "marifetullahu / njohja e Zotit me zemër".

Një besimtar që ka mundur ta njohë Zotin e tij me zemër, duke arritur gjendjen e hiçit, fillon t'i lexojë në shpirtin e tij të fshehtat dhe urtësitë hyjnore të kësaj bote të përkohshme. Në këtë pikë, këtij robi fatlum, i

shfaqet urtësia që dëgjoi Abdulkadir Gejlani prej Hakut:

"Unë jam e fshehta e njeriut..."

Të dashurit e Allahut, gjatë gjithë jetës së tyre janë përpjekur ta eliminojnë krejtësisht egon e tyre, prandaj dhe kanë thënë:

"Nëse tek dikush ngelet qoftë edhe një gërmë prej egos, ai nuk mund të bëhet i dashur i Allahut."

Kjo, sepse për të gjetur rrugën e vendit të madhësisë, më parë duhet ngritur perdja e egos. Prandaj dhe të urtët kanë thënë: "*Nëse ti prej vetes del, vetëm Ai që të ka krijuar nge!*"

I dashuri i Allahut, i nderuari **Mevlana**, për shkak se arriti ta shndërronte egon e tij në një hiç, hyri në hauzin ku gjendeshin lebrozët dhe me një pjekuri të madhe shpirtërore i ripërtëriti zemrat e tyre të lënduara.

Ndërsa i nderuari **Bahauddin Nakshibendi**, për të kapërcyer pengesën e egos, u shërbente kafshëve, i hapte rrugë çdo gjallesë, duke menduar se "edhe mua, edhe atë e ka krijuar Allahu" dhe e barazonte nefsën e tij me to.

Kadiu i Bursës, i nderuari **Hydai**, për të shembur murin e ekzistencës dhe egos në shpirtin e tij, me urdhër të mësuesit të tij, u bë shitës mëlçish në pazarin e Bursës, i veshur me kaftan të qëndisur me argjend. Gjithashtu, punoi edhe si pastues i abdes'hanës së teqes. Në këtë mënyrë, ai filloi të përparonte në botën shpirtërore, vetëm pasi eliminoi egon e tij.

Tek ata që arrijnë ta kuptojnë ashtu si duhet fuqinë dhe madhësinë e Hakut, edhe shqetësimi për ekzistencë, edhe pretendimi për ego e humbasin fuqinë e tyre. Kjo, sepse në sajë të ndjenjës së dobësisë dhe hiçit, ata shndërrohen në qirinj që shkrihen. Këta talente të mëdhenj, që arrijnë majat e ndjenjës së "**hiç**"-it, duke pirë eliksirin e dobësisë përballë Hakut, bëhen të dashurit e Hakut.

KTHEHU NË "HIÇ", QË TË BËHESH DIELLI I DIEJVE...

Sipas një transmetimi, i nderuari **Halid Bagdadi**, megjithëse gëzonte famë në të gjithë botën islame



1. Shih: Fususu'l-Hikem, Përkthimi me shpjegim, I, 48.

dhe zotëronte një dituri të gjerë, pas një viti udhëtimi, me një edukatë shembullore, u ul në gjunjë para të nderuarit **Abdullah Dehleviut**. Duke fshirë krenarinë dhe mburrjen prej zemrës së tij dhe duke shtypur kryeneçësinë dhe dëshirat e nefsit, pranoi të kryente detyrën e pastruesit të abdes'hanës. Si rezultat i kësaj modestie, i gjendjes së "hiç"-it që kishte arritur dhe edukimit që kishte marrë, meritoi lavdërimet e mësuesit të tij dhe mirësitë shpirtërore.

Kur erdhi koha të ndahej prej teqes së Abdullah Dehleviut, në sytë e tij shkëlqente drita e dashurisë. Midis ardhjes dhe ikjes së tij, kishte shumë ndryshim. Kur erdhi, Abdullah Dehleviu, me qëllim që t'i jepte mësimin e parë të gjendjes së "hiç"-it, nuk doli për ta pritur, ndërsa, kur po ndahej, doli ta përcillte me respektin më të madh. Madje, megjithëse Halid Bagdadi u turpërua shumë, mësuesi i tij mbajti me dorë vendin ku vihet këmba për të hipur në kalë dhe e ngriti nxënësin e tij të bekuar me duart e veta. Pasi e përcolli përreth katër milje, atyre që ndodheshin pranë u thotë këto fjalë, në lidhje me nxënësin e tij:

"Halidi mori me vete gjithçka."

Kjo do të thotë që, edhe pse njeriu mund të arrijë majat më të larta të diturisë, është i detyruar ta zbukurojë diturinë e tij me bukuritë shpirtërore. Dhe për këtë arsye, edukata shpirtërore është shumë e domosdoshme. Në të kundërtën, njeriu zhytet në batakun e krenarisë dhe mendjemadhësisë së nefsit dhe nuk mund t'i shpëtojë shkaktërimit. Kush nuk e merr nën këmbë nefsin e tij, nuk mund të arrijë majat e përsosmërisë shpirtërore.

Për arsye se Halid Bagdadi zotëronte edhe dijet dhahiri edhe dijet batini², është thirrur me emrin "Dielli i Diejve". Nxënësit e tij u shtuan shumë dhe rrethi i mësimëve tij shpirtërore sa vinte e zgjerohej. Madje edhe sot e kësaj dite, myslimanët anekënd botës përfitojnë prej dijeve të tij.

Letrat që ka shkruar i nderuari Halid Bagdadi drejtuar bijve dhe vëllezërve të tij shpirtërorë, na japin mësim të rëndësishme në lidhje me gjendjen e hiçit. Ndërsa në një letër drejtuar vëllait të tij të gjakut, veten e tij e

2. Në tasavuf ka dy lloj dijesh. Dhahiri dhe batini. Dijet dhahiri janë ato dije që fitohen me të lexuar dhe mësuar, siç janë shkenca e hadithit, tefsirit, fikhut etj. Ndërsa dijet batini janë ato dije që kanë të bëjnë me botën e shpirtit dhe fshehtësitë e tij. Këto dije Allahu ua fal profetëve dhe robërve të Tij me grada të larta devotshmërie.

përshkruan me këto fjalë:

"..Beto hem në Allahun Teala se, që kur më ka lindur nëna e deri më sot, nuk besoj të kem bërë ndonjë të mirë, e cila është e pranuar dhe me vlerë tek Allahu, aq sa të mos kërkohet llogari për të."

Padyshim se ajo që e shtynte këtë lider të madh shpirtëror në këto ndjenja, ishte gjendja e "hiç"-it, që ndjente përballë Allahut.

Pra, sado punë të mira të ketë bërë një njeri, asnjëherë nuk duhet t'u besojë atyre dhe të mbështet në to, por gjithmonë duhet t'i shohë të mangëta dhe të strehohet në mëshirën e Allahut.

Pas këtyre fjalëve, Halid Bagdadi vazhdoi duke thënë:

"Nëse gjatë kryerjes së punëve të mira nuk e sheh të falimentuar nefsin tënd, ky është niveli më i lartë i injorancës. Nëse e ndjen të falimentuar, mos e humb shpresën tek Allahu, sepse mirësia dhe bujaria e Allahut Teala për njeriun, është shumë më e dobishme se të gjitha punët e mira të njerëzve dhe xhindëve."

Allahu Teala urdhëron:

"Thuaj: "Me dhuntinë e Allahut dhe mëshirën e Tij, vetëm me këto le të gëzohen! Kjo është më e mirë se ajo që grumbullojnë." (Junus, 58)

Ibën Abbasi (r.a.), në komentimin e shprehjes «**ajo që grumbullojnë**», thotë se kuptimi i saj është "ajo që kanë fituar."

Kurrë mos i negligizo adhurimet duke u mbështetur në mirësinë dhe bujarinë e Allahut ashtu siç vepruan ata, me mendjet e të cilëve luan shejtani! Vazhdoje kontrollin ndaj vetes në mënyrë vigjilente! Mos u ndaj prej Tij (Allahut), qoftë edhe kur je duke ecur në rrugë..."³

Me një fjalë, ashtu si adhurimet, të gjitha veprat tona kanë nevojë për pranimin nga ana e Allahut. Prandaj, veprat e mira nuk duhet të bëhen shkas që në zemrën e besimtarit të zënë vend cilësitë egoiste.

Por nga ana tjetër, besimtari nuk duhet të shkojë në skajin tjetër dhe të bjerë në gjendje të pashpresë. Historia e Junusit (a.s.), është një shembull mësimdhënës në lidhje me humbjen e shpresës:

Junusi (a.s.), në vend që të zbatonte urdhrin hyjnor

3. Mektubat-i Mevlana Halid, Letra e 28.

dhe të kumtonte fenë për dyzet ditë, në ditën e tridhjeteshtatë u zemërua me popullin e tij, i cili nuk po vinte në rrugën e besimit dhe i braktisi ata. Prej afatit që i kishte dhënë Allahu Teala, kishin ngelur edhe tri ditë. Por Junusi (a.s.), u largua prej popullit të tij i pashpresë. Më vonë, kur e hodhën nga anija në të cilën kishte hipur dhe po qortonte veten për gabimin që kishte bërë, papritur gëlltitet nga një peshk.

Kur ishte në barkun e peshkut, Junusi (a.s.), bëri teube, kërkoi falje prej Allahut dhe u angazhua vetëm me përmendjen e Allahut. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Po të mos ishte nga ata që i luten Allahut, me siguri do të mbetej në barkun e tij deri në Ditën e Ringjalljes.” (es-Saffat, 143-144)

Në një ajet tjetër, Allahu Teala i drejtohet Profetit tonë (a.s.), duke e këshilluar të mos i humbë shpresat:

“Prandaj, duro për gjykimin e Zotit tënd dhe mos u bëj si Njeriu i Peshkut (Junusi, a.s.), kur iu lut Zotit të vet i dëshpëruar (në barkun e balenës)! Sikur të mos i vinte mëshira prej Zotit tënd, ai do të hidhej në një shkretëtirë, i fajësuar!” (el-Kalem, 48-49)

Pra, robi gjithmonë ka nevojë për mëshirën dhe mirësinë e Allahut. Prandaj, asnjëherë nuk duhet t’u besojë veprave të veta dhe të nxjerrë në pah egon e tij. Por nuk duhet të bëjë as të kundërtën e saj dhe t’i nënvleftësojë ato plotësisht e të bjerë në gjendje të pashpresë. Deri në frymën e fundit ai duhet të përmbushë detyrën e tij si rob i Allahut me thjeshtësi të madhe. Gjithashtu, duhet të jetojë në mes frikës dhe shpresës dhe gjithmonë të strehohet në mëshirën e Allahut.

Në një letër tjetër të Halid Bagdadit, e cila i drejtohet si këshillë një nxënësi të tij që e kishte ngarkuar me detyrën e mësimdhënies, zënë vend shprehje që na lënë të kuptojmë qartë gjendjen e “hiç”-it në të cilën ndodhej:

“...Ju këshilloj të angazhoheni me punë të cilat do t’u bëjnë dobi në frymën e fundit, të zbatoni sunetin e Profetit (a.s.), të mos shkoni pas bukurive të jashtme të kësaj bote mashtruese, të mos ndiqni zakonet e popullit (pra të mos zbatoni zakone të cilat janë në kundërshtim me fjalën

*e Allahut) dhe të mos e harroni me lutje për sukses dhe përfundim të mirë këtë rob të varfër.”*⁴

Pra, ai rob i devotshëm i Allahut, i kërkonte nxënësit të tij të bënte dua për të, me qëllim që frymën e fundit ta jepte duke qenë besimtar.

ZEMRAT QË KANË ARRITUR GJENDJEN E HIÇIT

Edhe babai ynë i nderuari **MusaTopbash**, të cilin e përcollëm në përjetësi pas një jete të pastër e të zbuluar me besnikëri dhe shërbim, në sajë të modestisë së madhe që zotëronte, ishte kthyer në një shembull të gjallë të vetëdijes së gjendjes së “hiç”-it. Në lidhje me këtë çështje, ai edhe pas vdekjes u bë shkak udhëzimi për zemrat e atyre që e donin, duke u lënë kujtime dhe mësim të vlefshme. Kur u hap testamenti që kishte lënë, që në paragrafin e parë zinin vend këto shprehje,

të cilat tregojnë vetëdijen e tij në lidhje me gjendjen e “hiç”-it që ndjente përballë Allahut:

“Çdokush që vjen në këtë botë, do të emigrojë për në botën e përjetshme, pasi t’i ketë plotësuar orët e tij dhe frymëmarrjet e numëruara. Lum për atë që e ka shpenzuar jetën e tij në rrugën e Hakut dhe ka emigruar në botën tjetër me faqe të bardhë!..

Edhe unë i mjeri, megjithëse e dija këtë fakt me aq sa më ishte dhënë mundësia, nuk

arrita t’i bëhem rob Zotit ashtu siç e meriton Ai. Megjithëse jam i moshuar dhe i kam braktisur mirësitë e kësaj bote, nuk munda ta përmirësoj veten. Kam lexuar biografite e jetës së ndershme dhe të vetëdijshme të të mëdhenjve të islamit, por nuk munda të bëhem si ata. Pas një jete të mbushur me gabime, po shkoj pranë Allahut Teala vetëm duke shpresuar në faljen e tij, sepse Ai është Rrahman dhe Gaffar.”

Nëse një i dashur i Hakut, që ia ka kushtuar të gjithë jetën shërbimit në rrugë të Allahut mendon kështu për veten, po ne çfarë duhet të themi për gjendjen tonë? Allahu na pranofte të gjithëve në mëshirën e Tij!

EGOJA: SHKAKU I KRYENEÇËSISË NDAJ HAKUT

Allahu i Madhëruar urdhëron:

4. Mektubat-i-Mevlana Halid, letra e 25.

"A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës e megjithatë, ai bëhet kundërshtar i hapët?!"
(Ja Sin, 77)

Të shkujdesurit që kanë harruar se natyra e tyre e vërtetë është **"hiçi dhe mosekzistimi"**, nuk mund të shpëtojnë nga vorbulla e egos, krenarisë dhe mendjemadhësisë, të cilat janë fatkeqësitë më të mëdha shpirtërore.

Për shkak të egos së tij, **Iblisi** guxoi të debatojë me Allahun, duke thënë për Ademin (a.s.), "unë jam më i lartë se ai" dhe në fund u shkatërrua.

Karuni, i cili u mbyt në thesare si sprovë hyjnore, e kundërshtoi Musain (a.s.), që i llogariti zekatin dhe dëshiroi t'ia marrë. Ai mbajti qëndrim të ashpër dhe me arrogancë të madhe tha: "Këto thesare i fitova me dijen time". Por në të vërtetë ai harroi se ato ishin mirësia dhe sprova e Allahut Teala. Prandaj dhe u varros në fund të dheut bashkë me thesaret e tij.

Ndërsa **Bel'ambin Baura** ia atribuoi vetes suksesin shpirtëror që arriti dhe me mendjemadhësi anoi nga dëshira e tij. Por Allahu Teala e shkatërrroi, duke e çmendur si një qen që merr frymë duke nxjerrë gjuhën jashtë.

Në vitin 1912, kur anija gjigande **Titanik** doli në udhëtimin e saj të parë, me krenari dhe mburrje u tha: "Këtë anije nuk mund ta fundosë asnjë forcë". Por që në udhëtimin e parë, anija u përplas me një ajsberg dhe humbi në thellësitë e oqeanit së bashku me ata që kishte brenda.

Në vitin 1986 anija kozmike **"Challenger"**, që do të thotë "Sfiduesja", shpërtheu 73 sekonda pas lëshimit dhe i gjithë ekuipazhi i saj vdiq.

Në 18 Mars të vitit 1915, luftanija e madhe franceze **"Inflexible"** që do të thotë "e papërthyeshme, e papërkulshme", u dëmtua rëndë dhe ngeli jashtë luftimi në luftën legjendare të Çanakalesë. Në të njëjtën ditë, edhe luftanija **"Irresistible"** që do të thotë "e papërballueshme", u përplas dhe u mbyt.

Edhe luftanija e madhe e flotës së Shteteve Aleate⁵, e quajtur **"Goliat"**, emër i frymëzuar nga Xhaluti, gjiga-

ndi i famshëm i ushtrisë mohuese, i cili u vra nga profeti Daud (a.s.), u fundos në ujërat e Ngushticës së Dardaneleve, më 13 Maj të 1915 nga fregata Muavenet-i Millije, e cila dukej shumë më e vogël dhe më e pafuqishme në krahasim me të.

Historia dëshmon se shembuj të tillë janë të panumërt. Ata që guxuan të sfidojnë Allahun Teala në cilësinë e Madhështisë, zullumqarët që thanë **"unë"** përpara Hakut, popujt e fuqishëm si Adi dhe Themudi, të cilët u mburrën duke thënë: **"Kush është më i fuqishëm se ne?"** dhe ata që me mburrje e mendjemadhësi u mbështetën në mjetet të cilat i ndërtuan me aftësitë mendore që u kishte falur Allahu, gjithmonë u bënë shembujt më të këqinj të hakmarrjes hyjnore, duke u shkatërruar nën kamxhikët e dënimit.

Si përfundim, kur besimtari arrin një mirësi, gjithmonë duhet të thotë: **"Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim"** dhe duke ia atribuar atë mirësi pronarit të vërtetë,

duhet të falënderojë i përulur. Në vend që të biem pre e nefsit tonë duke thënë: "E fitova me forcat e mia, apo e arrita me dijet dhe aftësitë e mia", duhet synuar arritja e majës të ndjenjës së **"hiç"**-it, duke thënë: "Të gjitha mirësitë janë prej Teje, o Zot!".

Por, në të kundërtën, kur përballemi me ndonjë vështirësi, në vend që të ankohe-

mi dhe të bëhemi kryeneçë, duhet të përpiqemi të kontrollojmë gjendjen tonë shpirtërore dhe të kompensojmë të metat tona, duke menduar se: "Unë jam fajtor për të gjitha! Ose, vallë cili prej gabimeve të mia u bë shkak i kësaj vështirësie që po kaloj?".


Allahu Teala i bëftë këto ndjenja ushqimin shpirtëror të zemrës sonë. Na bëftë të gjithëve prej robërve të përsosur që kanë arritur të vërtetën e "hiç"-it. Na e bëftë të mundur të jetojmë një jetë me devotshmërinë me të cilën është i kënaqur dhe na pranoftë në grupin e të urtëve, të singertëve dhe besnikëve, të cilët merituan mëshirën dhe faljen e Tij!..

Amin!..



"...Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim..." (Nemi, 40)

5.Në këtë aleancë në fillim bënin pjesë Anglia, Franca dhe Rusia.



ADHURIMI DHE DREJTËSIA SI REFLEKTIME TË DASHURISË NDAJ ALLAHUT

Albert Halili

Adhurimi është nënshtrim dhe përluje me nderim e respekt ndaj Allahut. Në periudhën e injorancës njerëzit adhuronin idhujt që i kishin ndërtuar me duart e veta. Këta idhuj ishin thjesht statuja, tek të cilat arabët para islamit besonin që zotëronin cilësi hyjnore. Është afërmendsh se adhurimi i këtyre qenieve të pavlera e të pafuqishme, jo vetëm që i mbante njerëzit larg nga mendimi dhe ndjenja e gjykimit në ditën e kijametit, por idhujtaria u hapte rrugën padrejtësive të shumta në mesin e shoqërisë. **Ata thonë: “Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote. Vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron”. Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.** (El- Xhathije, 24.) Sipas ajetit, mosbesimi në botën e amëshuar buronte nga mungesa e besimit në një Zot që mund të krijonte një botë tjetër. Mungesa e një besimi të tillë i bënte të jetonin një jetë të papërgjegjshme. Pra, ata kishin përvetësuar një botëkuptim të ndërtuar mbi hyjnizimin e idhujve.

Ky hyjnizim dhe dashuri për idhujt i kishte çuar në adhurimin e interesave personale. Sepse 360 idhujt që gjendeshin në Qabe, ishin shkak për tubimin e njerëzve për tregti dhe ky fakt e gëzonte shumë elitën idhujtare të Mekës. Pra, adhurimi i idhujve, përveç karakterit tradicional, mbartte edhe karakterin ekonomik. Nëse shprehemi me gjuhën profetike, ata ishin bërë adhurues të dirhemit dhe dinarit, pra

adhurues të pasurisë materiale. Duke mos pasur një sistem që të mbante nën kontroll shpërthimin e tep-tisjen e egoje të tyre, padrejtësitë nuk njihnin kufij. Edukimi i ndjenjave është i domosdoshëm, sepse ndihmon në zhvillimin e ndjenjave pozitive që shpien në marrëdhënie konstruktive me njerëzit, universin dhe jetën.

ADHURIMI DHE DREJTËSIA SIPAS KURANIT

Kjo ishte gjendja, përsa i përket çështjes së adhurimit, kur filloi zbritja e Kuranit. Kur erdhi islami, nuk urdhëroi për një adhurim pa themel. Së pari, islami hodhi themelin teorik, pra besimin në një krijues të vetëm për të kaluar më vonë në planin praktik. Kuranit e ftoi njeriun të mendonte thellë mbi krijimin, sepse kështu do ta njihje shumë më lehtë krijuesin e vërtetë. Kur njeriu arrin ta njohë Krijuesin nëpërmjet përsiatjes mbi gjithësinë dhe kur shikon që çdo gjë është krijuar në mënyrë të përsosur, fillon të ushqejë dashuri për Allahun. Një njeri që ka në zemër dashurinë për Allahun, nuk mund të rrijë pa e pyetur veten se si mund ta falënderojë Atë për gjithë këto të mira që i ka dhuruar.

Në të vërtetë, shprehja e falënderimit për çdo të mirë është në natyrën e njeriut. Pra, falënderimi që shprehim ndaj Allahut për të gjitha mirësitë e pafundme, është në natyrshmërinë e njeriut. Ndërsa dashuria abstrakte, pa anën praktike, konsiderohet e pavlerë nga ana e njerëzve. As që mund të pretendohet që dashuria e pashprehur në praktikë ndaj Allahut mund



të jetë e vërtetë. Falënderimi ndaj Allahut nuk është gjë tjetër përveçse shprehja e dashurisë në praktikë, që në fenë islame quhet ibadet. Forma dhe mënyra e ibadetit nuk është lënë në dorë të njerëzve, por është përcaktuar saktë nga vetë Allahu i lartësuar. Ajeti kuranor **“O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj”** (El Bekare, 21.) urdhëron të gjithë njerëzit që ndjenjën e falënderimit, e cila vjen si pasojë e dashurisë për Allahun, ta zbatojnë në formë ibadeti. Fundja, njerëzit dhe xhindët janë krijuar vetëm për të t’i bërë ibadet Allahut. Detyra e ibadetit nuk është e kufizuar në kohë, por është e vlefshme deri në vdekje. **“Dhe adhuroje Zotin tënd deri sa të të vijë vdekja”** (El-Hixhr, 99.) Ajeti kuranor e shpreh qartë që detyra e ibadetit vazhdon deri në vdekje, sepse mirësitë dhe begatitë e Allahut ndaj njeriut vazhdojnë deri në vdekje. Me vdekjen mbarojnë sprovat në këtë botë dhe njeriu kalon në një botë tjetër. Nga të gjitha këto, kuptohet qartë se qëllimi kryesor i krijimit të njeriut pas imanit është ibadeti.

Nga ana tjetër, në shumë ajete të Kuranit Allahu i urdhëron njerëzit të jenë të drejtë dhe të udhëheqin me drejtësi. **“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmeve tuaj. Qofshin të pasur ose të varfër”** (Nisa, 135.). Ajeti urdhëron të jemi të drejtë edhe kur drejtësia flet kundër interesave tona.

Allahu përshkruan në Kuran në mënyrë të detajuar drejtësinë dhe i informon besimtarët për qëndrimin që duhet të mbajnë përballë ngjarjeve me të cilat

përballen, si dhe për mënyrën se si duhet ta ushtrojnë drejtësinë. Një udhëzim i tillë përbën një mirësi dhe mëshirë të madhe për besimtarët. Për këtë arsye, ata që besojnë, kanë përgjegjësinë e të ushtuarit të drejtësisë pa bërë dallime, për të fituar aprovimin e Zotit dhe për t’i drejtuar jetët e tyre në paqe e siguri Drejtësia, për të cilën Zoti urdhëron në Kuran, është ajo drejtësi që ushtrohet në mënyrë të barabartë për të gjithë njerëzit, pa dallim gjuhe race apo kombësie.

Dy ajetet e mëposhtme sqarojnë se çfarë duhet të bëhet në emër të drejtësisë:

“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin.” (Nahl, 90)

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” (Mumtehine, 8.)

Siç konstatohet lehtësisht, në ajetet kuranore urdhërohet për drejtësi dhe të qenët i drejtë konsiderohet ibadet. Sepse ibadeti është zbatimi i urdhërësive dhe distancimi i plotë nga ndalesat. Atëherë e drejta është përputhshmëria me parimet kuranore, duke mbrojtur të vërtetën e të mirën kundër të keqes dhe qëndrimi në mesin e barazlanguar ndërmjet dy skajeve ekstreme. Realizimi i të gjitha këtyre është ibadet.

Ibadeti duhet realizuar sipas direktivave kuranore

por mënyrën e realizimit mund ta mësojmë vetëm prej Pejgamberit (a.s.). Kryerja e ibadeteve sipas mënyrës së Pejgamberit (a.s.), është obligim për gjithë besimtarët. Obligimi i ndjekjes së Pejgamberit (a.s.), ceket edhe në Kuran **“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën (e Allahut).”** (Al-Imran, 132.) **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.”** (Nisa, 80.). Këto dy ajete dhe të tjerë të ngjashëm, urdhërojnë besimtarët që të ndjekin Pejgamberin (a.s.), me përpikmëri, sepse Ai është i dërguari i fundit nga Allahu dhe, për pasojë, shembulli më i mirë për t’u pasuar në të gjitha aspektet. Kurani thekson faktin se Pejgamberi (a.s.), zotëron një moral të lartë dhe është shembulli më i mirë për t’u pasuar nga besimtarët.

Ndjekja me bindje të plotë e Muhamedit (a.s.), është e lidhur ngushtë me dashurinë për Allahun e lartësuar. Siç e shpreh edhe Kurani: **Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Ai t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”.** (Ali Imran, 31). Pra, bindja ndaj Pejgamberit (a.s.), është pasojë e dashurisë që ushqejmë për Allahun e lartësuar. Dhe për rrjedhojë, rruga më e saktë, më e drejtë dhe më e shkurtër për tek Allahu është rruga e ndjekur nga Pejgamberi (a.s.). Atëherë ibadeti është bindje ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij. Siç theksohet edhe në Kuran, bindja ndaj Allahut dhe Pejgamberit (a.s.), është për të fituar dashurinë e Allahut dhe faljen e mëkateve.

Nëpërmjet adhurimit, njeriu arrin të kuptojë dobësinë dhe pafuqinë e tij në këtë gjithësi, duke ndjerë nevojën e domosdoshme për Allahun, krijuesin e gjithësisë. Në këtë botë të gjithë kanë nevojë për Allahun, pa përjashtim. Kush e kupton nevojën që ka për të Plotfuqishmin, përpiqet me zell për të rrealizuar kuptimin e vërtetë të ibadetit. Adhurimi ndaj Allahut edukon ndjenjat e njeriut, duke rregulluar marrëdhëniet edhe me Allahun edhe me njerëzit. Edukimi i ndjenjave arrihet duke kufizuar “lirinë” e instinkteve dhe kjo arrihet përmes ibadetit. Sepse ibadeti e nxit njeriun për mirë dhe e pengon nga e

keqja. Një njeri që adhuron Allahun, nga njëra anë kryen obligimet, në anën tjetër përpiqet të përmbushë normat morale të Kuranit. Ngaqë të gjitha këto kryhen për hir të Allahut, ndërmjet Allahut dhe njeriut formohet një lidhje e fortë, që në të njëjtën kohë, është edhe pasojë e një besimi të plotë e të fortë. Një besimtar i tillë është i vetëdijshëm që për çdo të keqe do të gjykohet dhe për çdo të mirë do të shpërblehet në botën e amëshuar. Në këtë mënyrë shfaqet drejtësia, sepse, së pari formon ekuilibrin, i cili pasqyrohet pastaj edhe jashtë tij, duke u sjellë me drejtësi me të gjithë krijesat e Allahut. Ai nuk gjendet në sjellje që dëmtojnë të tjerët, sepse kjo bie ndesh me ibadetin.

Lidhja mes adhurimit dhe drejtësisë konsiston në faktin se, sa herë bëhet ibadet, kujtojmë Allahun.

Realizimi i detyrimeve fetare, si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, norma morale dhe distancimi i plotë nga ndalesat, forcon imanin e besimtarit. Nëpërmjet adhurimit forcohet besimi në Allahun, në pejgamberët, në engjëjt, në ditën e gjykimit dhe caktimin e Allahut. Realizimi i kushteve të imanit e nxit njeriun për të mirë dhe e pengon nga e keqja. Kështu formohet një bashkëveprim i ndërsjellë, ku imani forcon ibadetin dhe ibadeti forcon imanin. Një njeri që beson se do të gjykohet për çdo veprim të keq që kryen në këtë botë, nuk mund të bëhet i dëmshëm për shoqërinë. Përkundrazi, ai bëhet një njeri i cili i respekton, i nderon dhe i ndihon të gjithë njerëzit. Ai përpiqet të jetë i drejtë, sepse e di që Allahu i do të drejtët. I drejti është i dashur si për Allahun, ashtu edhe për shoqërinë.

Ky është njeri që kërkon Kurani, larg rrymave filozofike, të cilat parashikojnë një njeri hedonist, egoist, mendjemadh e fuqiplotë. Kurse Kurani na ofron një njeri me besim, me adhurim dhe me moral të bukur, i cili është në gjendje të ekuilibrojë ndjenjat. Ky ekuilibrim është garant për qetësinë publike dhe drejtësinë sociale. Këto janë dy alternativat për stil jete; zgjedhja e njëres alternativë është në vullnetin tonë të lirë.

Ky është njeri që kërkon Kurani, larg rrymave filozofike, të cilat parashikojnë një njeri hedonist, egoist, mendjemadh e fuqiplotë. Kurse Kurani na ofron një njeri me besim, me adhurim dhe me moral të bukur, i cili është në gjendje të ekuilibrojë ndjenjat. Ky ekuilibrim është garant për qetësinë publike dhe drejtësinë sociale. Këto janë dy alternativat për stil jete; zgjedhja e njëres alternativë është në vullnetin tonë të lirë.



Allahu është i BUKUR dhe e DO të BUKURËN

Fatmir Sulaj

Një ditë, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, tha:

"Nuk do të hyjë në xhenet ai që ka në zemër diçka prej mendjemadhësisë, qoftë edhe sa grimca..."

Ky ishte një paralajmërim shumë i rëndësishëm. Ata që e dëgjuan, sigurisht u tronditën. E mblodhën veten dhe të brengosur pyetën, me qëllim që ta kuptonin gjendjen më mirë e për të marrë masat e duhura:

"Çdo njeri dëshiron t'i ketë rrobat të bukura, këpucët t'i ketë të bukura... (Domethënë, edhe kjo është shenjë mendjemadhësie?)."

I Dërguari i Allahut (a.s.) tha:

*"Allahu është i bukur dhe e do të bukurën. Mendjemadhësia e vërtetë është neglizhimi e nënvlerësimi i së vërtetës dhe t'i shohësh njerëzit nga lart duke i përçmuar."*¹

Nga ky hadith fisnik, dalin shumë mësimet përfituese për ne:

Para së gjithash, kuptohet qartë se disa sjellje dhe vepra mund ta shkatërrojnë njeriun. Atëherë, ne duhet t'i lëmë patjetër sjelljet e këqija, zemrën duhet ta kemi të pastër, moralin të lartë duke e zbukuruar me sjellje të mira, fisnike e të pjekura dhe duhet të bëhemi njerëz të plotë, të ditur në fe dhe me edukatë. Njëri prej synimeve më të mëdha të fesë sonë, është pjekuria etike. Faktikisht edhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, e ka shprehur qartë se është dërguar për të plotësuar moralin e lartë.²

Veçanërisht, gjithmonë duhet të kemi respekt për të

1. Për hadithin e transmetuar nga Ibn Mes'udi, radijallahu anh, shih Muslim, "Iman", 147, 149; Ebu Davud, "Libas", 29, hadith nr: 4091; Tirmidhi, "Birr", 61, hadith nr: 1998-1999; Ibn Maxhe, "Iftitah", 9, hadith nr: 59; "Zuhd", 16, hadith nr: 4173.

2. Për hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejre, radijallahu anh, shih M - lik, "Husnu'l-hulk", 8; Ahmed b. Hanbel, II, 381, hadith nr: 8939; Buhari, el-Edebu'l-mufred, fq. 104, hadith nr: 273; Hakim, II, 670, hadith nr: 4221; Kuda'i, Musnedu'sh-Shihab, II, 192, hadith nr: 1165.

vërtetën, duhet ta duam atë, duhet t'i pranojmë të vërtetat, edhe nëse janë të hidhura, duhet t'i lëmë inatet dhe kontradiktat, të cilat lindin për shkak të mendjemadhësisë dhe krenarisë, në çdo vend e në çdo punë duhet të veprojmë sipas masave të drejtësisë, duhet t'u dalim kundër padrejtësisë, duhet të themi të vërtetën, nuk duhet ta kundërshtojmë fjalën e vërtetë dhe duhet të dëshmojmë të vërtetën, edhe nëse është kundër nesh apo të afërmeve tanë.

Përsëri duhet ta dimë se njëra prej sjelljeve më të bukura dhe më të rëndësishme është modestia dhe përlësisia. Sjellja e keqe, e cila është e kundërta e kësaj, quhet "mburrje" dhe del në pah duke e pëlqyer veten, duke e mbajtur kokën përpjetë, duke i parë njerëzit nga lart, duke i nënçmuar, poshtëruar dhe tallur ata. Mburria është pengesë për teufiki ilahijje, domethënë, ajo bëhet shkak që njeriu të ndëshkohet duke iu ndërprerë ndihma hyjnore, gjë e cila është tragjedia më e madhe për të.

Njeriu nuk duhet të mburret e të pëlqejë veten, duhet ta dijë kufirin në fjalë, në punë e në sjellje, duhet ta kuptojë paaftësinë e tij dhe duhet të jetë modest, duke menduar se ka njerëz më të ditur, më të pjekur dhe më të mirë se ai.

Së fundi, te të gjithë duhet të jetë vendosur dhe zhvilluar fuqishëm aftësia e perceptimit të shëndoshë estetik, dashuria ndaj së bukurës, të dashurit dhe vlerësimi i së bukurës.

Ne synojmë që çdo gjë ta bëjmë në formën më të bukur, veten tonë ta zbukurojmë me cilësitë më të bukura dhe të arrijmë rezultatet më të mira e shpërblimet më të mëdha në këtë botë dhe botën tjetër. Allahu i madhëruar na mundësoftë t'i fitojmë dhe t'i arrijmë këto.

Amin!

DISA FAKTE MBI REFORMËN DHE NDRYSHIMIN NË ISLAM

Prof. dr. Ahmet Akgundyz

I- TË VËRTETAT QË NUK VJETËROHEN DHE ISLAMI

Vitet e fundit po diskutohen shumë parime të besimit, moralit dhe jurisprudencës që Islami i solli njerëzimit. Për shkak se njerëzimi është në kërkim të fesë së vërtetë, disa qarqe dëshirojnë të fusin dyshime dhe ngurrim në zemrat e atyre që po orientohen në islam. Në emër të reformave dhe përshtatjes me jetën moderne, po mundohen të bëjnë ndryshime në çështjet themelore të fesë.

Në krye të shkaqeve për këto dyshime dhe ngurrime, duket se qëndron preteksti, se gjoja parimet morale dhe juridike të islamit, të cilat kanë ardhur 1433 vjet më parë, nuk mund t'i përshtaten mënyrës së jetesës në shekullin modern. Pra, sipas atyre që kanë informacione të mangëta rreth islamit, parimet e besimit islam do të merren, por parimet morale dhe juridike që ka sjellë islami para 1433 vjetëve, do të braktisen ose do t'u nënshtrohen ndryshimeve sipas dëshirave të tyre, me pretekstin se tashmë ato nuk mund t'i përshtaten më kohës në të cilën jetojmë.

Me keqardhje mund të themi se edhe disa prej dijetarëve dhe njerëzve të fesë, të cilët nuk i kuptojnë siç duhet parimet morale dhe juridike të islamit, kanë filluar të shfaqin veprime që i bëjnë këto dyshime dhe ngurrime të fitojnë njëfarë serioziteti dhe vërtetësie. Për këtë arsye, nën titullin "Islami në periudhën e ndryshimit dhe të vërtetat që nuk duhen harruar", do të mundohemi të prekim disa çështje themelore, të cilat janë të lidhura ngushtë me këtë temë.

Tani, le ta hapim këtë çështje duke i bërë lexuesit këto pyetje:

Nëse njeriu gjatë një ore përsërit të njëjtat fjalë, p.sh: "Sot do të shkoj në shtëpi", sigurisht që më në fund do t'i mërzitet shpirti. Gjithashtu, e njëjta gjë ndodh, edhe nëse dëgjon vazhdimisht për njëqind herë ligjëratën e dikujt që e pëlqen jashtë mase. Edhe nëse një nxënës që e do shumë fakultetin e mjekësisë thotë se do të studiojë 15

vjet në atë fakultet, do të vijë një ditë që ai do ta urrejë atë. E gjithë kjo ndodh, sepse kur gjërat që i "përkasin njeriut" përsëriten më shumë se ç'është nevoja, shkaktojnë mërzitje tek ai. Ka ndonjë që nuk është dakord me këtë? Sigurisht që jo!

Të bëjmë edhe një pyetje tjetër: Dikush ka një automobil të markës Ford, modeli i 1946-ës. Megjithëse në treg kanë dalë automobila më të rinj dhe më modernë, ai këmbëngul të mbajë po atë automobil. A mund të quhet i drejtë ky veprim? Në vitin 1940 ka dalë një libër në lidhje me fushën e dermatologjisë. A mundet që ky libër të përdoret për të dhënë mësim në fakultetet e mjekësisë në vitin 1996, megjithëse janë shkruar shumë libra të rinj në bazë të zbulimeve të reja? Padyshim se të dyja këtyre pyetjeve do t'u përgjigjeshit me jo.

Arsyeja e kësaj është se gjërat që u përkasin njerëzve, vjetërohen me kalimin e kohës dhe ju nuk mund t'i përshtateni rrethit ku jetoni. Nuk mund të ecni rehat nëpër autostrada me një Ford të 1946-ës. Pjesët e automobilin gjenden më me vështirësi dhe në defektin më të vogël, ngeleni në rrugë.

Tani le t'i kthehemi anës tjetër të çështjes dhe të bëjmë disa pyetje të tjera:

Të dashur lexues! Në kohën kur gjyshërit dhe gjyshet tuaj erdhën në jetë, botën e ngrohte po ky diell, që është edhe sot dhe ata përfituan 70-80 vjet nga ai. Edhe ju, kur lindët, gjetët po të njëjtin diell. Dikush prej jush do të përfitojë prej tij 20 vjet, dikush tjetër 50 apo 70 vjet. A është dikush prej jush që mendon apo thotë se koha ka ndryshuar, moda e këtij dielli ka kaluar etj. dhe se tashmë duhet të kërkohet një diell tjetër?

Të bëjmë një pyetje tjetër: Gjyshërit dhe gjyshet tona, me vite të tëra kanë ngrënë mollë, dardha, portokalle etj. Edhe sot, ne po hamë prej këtyre frutave. Dikush që 20 vjet, dikush tjetër që 50 apo 70 vjet. A thotë ndonjëri

se nuk do t'i hajë më këto fruta, sepse u ka kaluar moda dhe është mërziur prej tyre? A është dikush prej jush, të cilit i është mërziur shpirti nga ajri që thith prej kohës kur ka lindur?

Sigurisht që jo, sepse këto që përmendëm, janë gjëra për të cilat njerëzimi ka nevojë në çdo kohë e shekull, sepse këto janë gjëra që i "takojnë Allahut". Ato që i takojnë Allahut, nuk vjetërohen kurrë, nuk sjellin mërzi dhe njerëzimi nuk mund të thotë kurrë se nuk ka nevojë për to.

Allahu ka vënë dy kategori rregullash dhe ligjesh:

E para është kategoria e ligjit të krijimit, që vjen prej atributit të Allahut, të cilin e quajmë "Kudret", fuqia e Allahut dhe që në mënyrë të gabuar disa e quajnë natyrë. Siç e pamë edhe prej shembujve që dhamë pak më sipër, prej rregullave të ligjit krijues, p.sh; prej dritës së diellit, prej ngrohjes së zjarrit, prej shijes së ujit etj., nuk është mërziur njeri. Këto janë gjëra që nuk vjetërohen, prandaj dhe nuk sjellin mërzi.

Ndërsa e dyta, është kategoria e ligjit që vjen prej atributit të Allahut, të cilin e quajmë "Kalam", fjala e Allahut, burimi i së cilës është Kurani Kerim dhe që ne e njohim si Islam. Parimet e Kuranit, të cilat ndriçojnë si një diell, e ruajnë freskinë e tyre, edhe pse mund të kalojë shumë kohë. Dhe me të vërtetë që Kurani Kerim e ruan freskinë e vet sikur të zbritej në çdo shekull. Po! Për arsye se Kurani është fjalë e përjetshme dhe i drejtohet çdo shtrese njerëzore në çdo shekull, është e domosdoshme që ai të ketë freski të përjetshme. Madje, ai duket sikur i drejtohet posaçërisht dhe i jep mësim çdo shekulli, sado të ndryshëm mund të jenë ata.

Veprat dhe ligjet e njeriut, vjetërohen ashtu si njeriu. Ndryshojnë dhe u kalon moda. Mirëpo, parimet dhe ligjet e Kuranit janë aq të forta dhe të qëndrueshme, saqë me kalimin e shekujve, fuqia e tyre rritet edhe më shumë.

Po! Thirrja e Kuranit "Ja ehle'l-kitab, ja ehle'l-kitab!", duket se i drejtohet më së shumti "ehl-i kitab"-it të shekullit tonë, që i beson shumë vetes dhe mbyll veshët përballë fjalëve të Kuranit. Ajo thirrje sikur është posaçërisht për këtë shekull dhe shprehja "Ja ehle'l-kitab", sikur përmban edhe kuptimin "Ja ehle'l- mekteb".

Këtu mund të japim dy shembuj. Një nga shkencat

ekzakte dhe një nga shkencat shoqërore, më saktësisht nga jurisprudenca:

1- Shembulli nga shkencat ekzakte:

Në një ajet udhërohet:

"... Dhe për çdo lloj fruti, Ai ka krijuar nga një çift..." (er-Ra'd, 3.)

"Zeuxhejn (Çift): Pra, një çift i përbërë nga dy gjini të kundërta, një mashkull dhe një femër. Megjithëse disa e komentojnë vetëm si "ithnejn", pra nga "dy", këtu është e qartë se bëhet fjalë për një ndarje. Sipas kësaj:

Në lulet e çdo fruti ka një çift, mashkull-femër, ashtu si te kafshët. Pra, fruti del nga çiftëzimi i këtyre luleve. Në një ajet tjetër, urdhërohet: **"Ne i dërgojmë erërat për pllenim..."** (el-Hixhr, 22)

Çiftet janë dy llojesh: Te një pjesë e luleve, mashkulli vjen nga një pemë, ndërsa femra nga një pemë tjetër. P.sh., Mashkulli i fikut është në një pemë, ndërsa femra në një pemë tjetër. Në pjesën tjetër të luleve, edhe mashkulli edhe femra ndodhen në të njëjtën lule. Lulja çel me dy gjini, mashkull-femër dhe çiftëzimin e bën brenda vetes. Shumica e luleve gjenden në formën e llojit të dytë.

Pra, me shprehjen "zeuxhejn (çift)", nënkuptohet çifti mashkull-femër, që çiftëzohet në çdo lule, ndërsa me shprehjen "ithnejn (nga dy)", nënkuptohen dy llojet e çiftëzimeve. Megjithëse prej kohësh dihej se lulet e disa pemëve, si ato të fikut dhe të hurmës arabe, çiftëzohen me partnerë që ndodhen në pemë të tjera, fakti se lulet e disa pemëve të tjera çiftëzohen brenda vetes, është zbuluar vetëm kohët e fundit. Kjo e vërtetë është kuptuar pas zbulimit dhe vënies në përdorim të mikroskopit, me të cilin është bërë i mundur edhe studimi i fiziologjisë së bimëve. Për këtë arsye, evidentimet dhe shpjegimet e disa dijetarëve të vjetër të tefsirit në lidhje me këtë temë, nuk janë edhe aq të sakta.

Por fjalët dhe mendimet e Fahrudin Raziut duket se janë më afër këtij kuptimi. Veçanërisht, kur Raziu e përngjet këtë fenomen me krijimin e njeriut prej Ademit (a.s.) dhe Havasë. Pra, të gjitha pemët dhe bimët e tjera i ka përgjithësuar me atë krahasim dhe ky përfundim është nxjerrë drejtpërdrejt nga kuptimi i vetë ajetit. Sot, me ndihmën e shkencës së botanikës, ne mund të kuptojmë



shumë mirë se në këtë ajet ndodhet një mrekulli shkencore e mirëfilltë. Dhënia e këtij informacioni në Kuranin Kerim para 1433 vjetësh, përbën një dëshmi të qartë se Kurani është libër i Allahut dhe ai që e ka sjellë atë, është i Dërguari i Tij besnik”¹.

2- Për sa i përket shembullit nga shkencat sociale, mund të përmendim ndryshimin deri në 100 % midis sistemit juridik perëndimor dhe atij lindor ose më mirë të themi, midis sistemeve juridike që janë fryt i mendjes njerëzore dhe sistemit juridik islam me burim hyjnor. Nga ato që mësojmë në librat e së drejtës civile, zhvillimet në fushën e të drejtave dhe lirive njerëzore kanë njohur ndryshime themelore me “Magna Charta Libertatum”, Marrëveshjen Angleze për Liri, të vitit 1215 dhe me Revolucionin Francez, të viti 1789. Por me këmbëngulje mund të them, se kjo vlen vetëm për vendet joislame, sepse liritë dhe të drejtat e njeriut, të cilat në Perëndim janë fituar shumë vonë me mund e me gjak, përveç abuzimeve dhe zbatimeve të gabuara, gjenden në të Drejtën Islame që në fillim të Islamit.

Kushtetuta e Medinës që është përgatitur në kohën e Profetit (a.s.), në shekullin VII, Hutbja e lamtumirës, e cila cilësohet si deklarata e lirive dhe të drejtave dhe deklaratat e Kuranit dhe haditheve, në lidhje me të drejtat dhe liritë njerëzore, kanë përcaktuar që në atë kohë një pjesë të madhe të lirive dhe të drejtave që ekzistojnë sot në vendet perëndimore. Por nuk mund të lemë pa përmendur edhe faktin se në islam, njeriu shihet si një krijesë e nderuar e Allahut dhe si një qenie e shenjtë. Fjala e urtë e poetit popullor Junus Emre: “E dua krijesën për shkak të Krijuesit”, shpreh qartë ndikimin e së Drejtës Islame, sidomos në periudhën e ngritjes.

Nëse dëshironi, le ta lemë mënjandë njeriun dhe të drejtat e tij dhe të shohim se si është sjellë islami me kafshët. Më parë do t’ju paraqes një dokument, pastaj do t’i kthehem përsëri njeriut dhe të drejtave të tij. Pikësëpari, desha t’ju kujtoj se në perëndim, nocioni i të drejtave të kafshëve është shfaqur në çerekun e fundit të shekullit të 19-të dhe Kombet e Bashkuara e kanë pranuar Deklaratën e të Drejtave të Kafshëve, në vitin 1948. Por nga ana tjetër, të njëjtat parime, madje edhe në një nivel më të lartë, kanë zënë vend në kushtetutën e Perandorisë Osmane që prej fillimeve të saj. Le të lexojmë së bashku këtë ligj të bashkisë së Stambollit, që është përgatitur në vitin 1502, vit ky që përkon me periudhën e Bejazidit II:

“Të mos vënë në punë kafshën me këmbë të vrrarë. Të ruajnë në këmbët e kuajve, mushkave dhe gomarëve. Të riparojnë

1. Elmalılı Muhammed Hamdi Yazır, Hak Dini Kur’an Dili, 123-124; Zemahşeri, Keşşâf, II, 349; Râzi, Fahrüddin, Mefâtihi’ul-Gayb, XIX, sh. 6.

samarët e tyre dhe të mos i ngarkojnë shumë. Nëse (kafshët) kanë ndonjë mangësi, t’ua plotësojë i zoti. Nëse i zoti nuk e bën ose nuk i jep rëndësi, të dënohet!”

“Me një fjalë, këto që u përmendën dhe të tjera si këto, janë krijesa të Allahut dhe për to ka ligje, të cilat garantojnë të drejtat e tyre.”²

Nuk është mundur që një sistem drejtësie, i cili ndalon keqtrajtimin e kafshëve, madje edhe të milingonave, të mos tregojë respekt për të drejtat dhe liritë e njeriut. Por për fat të keq, për shkak se disa dëshirojnë që ndër popuj të përhapet mendimi i kundërt, është e domosdoshme që kjo çështje të shpjegohet duke u mbështetur në dokumente.

II. LIGJET E KURANIT NUK MUND TË KRAHASOHEN ME SISTEMET NJERËZORE

Të gjitha qytetërimet që janë fryt i mendjes njerëzore, mbase edhe i xhindëve, janë të paaftë të qëndrojnë përballë Kuranit Kerim dhe vazhdimisht mundohen ta sfidojnë atë. Por Allahu Teala e ka sfiduar njerëzimin përballë kësaj mrekullie, duke u thënë:

“Thuj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindët për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin.” (el-Isra, 88)

Për të vërtetuar këtë mrekulli të pashoqe, do të sjellim një krahasim të ligjeve të Kuranit me ato të disa qytetërimeve të ndryshme:

Ligjet e Kuranit nuk kanë fillim, prandaj dhe nuk do të kenë as fund. Ato nuk janë si ligjet e qytetërimeve të cilat plaken dhe janë të dënuara të vdesin, por janë gjithmonë dinamike dhe të forta. Asnjë prej organizatave më të mira të civilizimit, së bashku me masat e sigurisë që kanë marrë dhe të gjitha shkollat e edukatës morale që zotërojnë, nuk kanë mundur t’i zgjidhin as dy prej çështjeve ashtu siç i ka zgjidhur Kurani Kerim.

Le të shqyrtojmë këtu dy prej ligjeve Kuranore: ***“Falen namazin, jepen zekatin...”*** (el-Bekare, 43) dhe ***“...Allahu e ka lejuar tregtinë dhe e ka ndaluar kamatën...”*** (el-Bekare, 275)

Nuk duhet të harrojmë se burimi i çdo revolucioni apo ngatërrese në historinë njerëzore dhe burimi i moralit të keq, janë vetëm dy thënie:

1 - “Të ngopem unë, pa të tjerët le të vdesin!”

2 - “Ti mbytu në vuajtje, që unë të jetoj në mirësi dhe rehati”.

2. Istanbul Ihtisâb Kanunnâmesi, Topkapı Sarayı, R. 1935, Vrk. 96/b-106/b, md. 58, 73; Akgündüz Ahmed, Osmanlı Kanunnameleri Ve Hukukî Tahlilleri, II. Kitap, II: Bâyezid Devri Kanunnâmeleri, Istanbul 1990, sh. 296-297

Jeta shoqërore lind nga ndihma reciproke. Ilaçi i çdo fatkeqësie që shfaqet për shkak të kryengritjeve, revolucioneve dhe mosmarrëveshjeve, të cilat pengojnë zhvillimin njerëzor, është ndihma reciproke. Njerëzit janë krijuar të ndryshëm, si nga ana e kapacitetit mendor, ashtu edhe nga ana e fuqisë trupore dhe ekonomike. Në shoqëri ka edhe të dobët edhe të fuqishëm. Por kushti më i rëndësishëm që ruan rregullin dhe sigurinë e jetës shoqërore, është mosformimi i boshllëqeve midis këtyre dy shtresave të shoqërisë, duke ruajtur ekuilibrin shoqëror.

Këto dy shtresa nuk duhet të largohen dhe të shkëputen nga njëra-tjetra. Faktori më i rëndësishëm që siguron afrimin midis këtyre dy shtresave, është ndihma reciproke. Tek të dobëtit ekziston gjithmonë një ndjenjë strehimi. Kurse tek të fuqishmit vërehet një ndjenjë mbrojtjeje. Këto ndjenja i shtyjnë njerëzit të jetojnë në bashkësi. Prandaj dhe prej të dobëtve lindin ndjenja respekti, bindjeje dhe dashurie ndaj të fuqishmëve, ndërsa prej të fuqishmëve ndjenja mirësie dhe mëshire ndaj të dobëtve.

Në të kundërtën, prej të dobëtve ngrihen zëra kryengritjeje, thirrje xhelozie dhe hakërrima urrejtjeje. Ndërsa prej të fuqishmëve, lëshohen zjarre tiranie, shtypjeje dhe poshtërime. Shkurtimisht, ndihma reciproke është kusht për të qenë i qytetëruar.

Një nga dy format e ndihmës reciproke, është ajo që bëhet pa pritur shpërblim. Ndërsa më e mira e saj, është sadakaja, vakëfi dhe zekati. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), duke dashur të shpjegojë atë që po mundohemi të shpjegojmë edhe ne, ka thënë: *"Zekati është ura e Islamit"*³

Nuk është e mundur ta mohosh faktin që njeriu do të jetojë më i qetë në shoqëri, nëse do të vendoset ekuilibri midis të varfërve dhe të pasurve. Por bazat e këtij ekuilibri janë mëshira dhe mirësia e shtresës së pasur dhe respekti e bindja e shtresës së varfër.

Thënia e parë, e ka shtyrë shtresën e pasur në tirani, amoralitet dhe mizori. Ndërsa thënia e dytë, e ka shtyrë shtresën e varfër në urrejtje dhe xhelozie ndaj të pasurve.

3. Sujuti, Xhelaluddin Abdurrahman (911/ 1505), El-Xhamius Sagir (Munav - me shpjegim), Egjipt 1938, Vëll. IV, fq. 71; El-Axhluni, Ismail b. Muhammed (1162 H.), Keshful-Hafadhe Muzilul-Ilbas, Bejrut 1351, Vëll. I, fq. 439; Mardin, Ebul-Ula, Ahkam-i Eukaf, 1339-1340 shënime, Stamboll, fq. 3; Coulson, N.J., A History Of Islamic Law, Edinburg, 1964, sh. 154.

Kjo gjendje, gjithmonë ia ka prishur paqen dhe qetësinë njerëzimit. Si rezultat i luftës së biznesit të vogël me bizneset e fuqishme dhe mosmarrëveshjeve të vazhdueshme midis punëtorit dhe punëdhënësit, doli në skenë komunizmi.

Ja pra, ky qytetërim me të gjitha organizatat e bamirësisë, shkollat e tyre të edukatës dhe ligjet e tyre të rrepta të drejtësisë, nuk mundi t'i pajtojë kurrë këto dy shtresa të shoqërisë dhe nuk mundi t'i shërojë dy plagët më të mëdha, të cilat e kanë venë në rrezik jetën njerëzore.

Kurani, thënien e parë e shkëlqon nga rrënjët dhe e kuron vetëm duke bërë farz (të detyrueshëm) zekatin. Ndërsa thënien e dytë e kuron duke bërë haram kamatën. Kurani del përballë botës dhe i thotë "nda!" kamatës. "Për t'u mbyllur derën ngatërresave, mbyllini derën kamatës", e urdhëron ai (Kurani) njerëzimin.

Në lidhje me zekatin, i cili përmban çdo lloj ndihme reciproke, transmetohet një hadith sahih (i vërtetë) i Profeti (a.s.), kuptimi i të cilit është: *"Ndihma e myslimanëve ndaj njërit-tjetrit bëhet vetëm duke kaluar mbi urën e zekatit, sepse zekati është mjet ndihme"*. (El-Mundhiri, et-Tergibue't-Terhib, 1: 517) Zekati është ura që siguron rregullin dhe qetësinë në jetën shoqërore.

Megjithatë, nuk është shkencore të marrim vendime pa e shqyrtuar këtë çështje si një trup i vetëm. Nëse syri i të voglit të një sorkadheje ju pëlqen më shumë se fëmija juaj, duke gjykuar vetëm nga bukuria e syrit, ju po bëni një gabim shumë të madh. Por, nëse krahasimet bëhen duke shqyrtuar gjithçka, atëherë edhe fëmija më i shëmtuar do t'ju duket më i ëmbël dhe më i bukur se i vogli i një sorkadheje. Kështu janë edhe sistemet e drejtësisë. Të kritikosh parimet dhe ligjet e Kuranit, pa i ditur të gjitha anët, por vetëm duke u fokusuar tek gjërat që nuk i pëlqejnë syrit apo veshit, është kundërshtimi i Allahut dhe i së vërtetës.

Me një fjalë, ligjet dhe rregullat e njerëzimit plaken ashtu si edhe vetë njeriu. Ndërsa ligjet dhe rregullat e Kuranit, janë aq të qëndrueshme dhe të forta, saqë rrihen dhe forcohen sa më shumë që të kalojnë shekujt. Kjo është vetëm një pikë uji prej oqeanit gjigand, vetëm një shenjë e vogël! Dhe me të vërtetë, të mençurit i mjafton vetëm një shenjë.





Edukimi shpirtëror

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Edukimi shpirtëror luan një rol të rëndësishëm në formimin e personalitetit të njeriut, veçanërisht është shumë i rëndësishëm bashkëshoqërimi i arsimit me edukim. Edukimi fetaro-shpirtëror është transmetimi i trashëgimisë fetare dhe kulturore nga njëri brez në tjetrin. Për t'i dalë zot si duhet kësaj trashëgimie, duhet që edukata shpirtërore të mësohet sipas kushteve të caktuara. Në fakt, edukata është shndërrimi i diturisë së fituar përmes arsimit në vepra, thënë ndryshe, shndërrimi i teorisë në praktikë.

Rruga më e shpejtë dhe më e lehtë për të formuar një edukim shpirtëror të shëndoshë, është ndikimi i natyreshëm i njerëzve të urtë. Edukata nuk është thjesht një sistem rregullash të shkruara, por arritja e një shkalle të lartë shpirtërore, duke qëndruar pranë njerëzve të urtë, me moral të përsosur. Kjo gjendje i ngjan procesit të pjekjes së frutave nga rrezet e diellit. Nga kjo pikëpamje, rruga më e mirë për të përfituar edukatë shpirtërore, është qëndrimi dhe shoqërimi me njerëz të urtë.

Shokët e Pejgamberit (a.s.), përfitonin nga Ai përmes katër mënyrave:

- 1- Duke dëgjuar fjalët e Tij.
- 2- Duke ndjekur veprimet e Tij.
- 3- Miratimin e veprimeve të të tjerëve nga ana e Tij.
- 4- Absorbimi i gjendjes dhe ndjenjave të Tij.

Sahabët patën mirësinë të jetonin me Pejgamberin (a.s.). Atë që ne e mësojmë sot përmes librave, sahabët e mësuan direkt nga Pejgamberi (a.s.). Shoqërimi me njerëz të urtë nuk është thjesht shoqërim fizik, por përpjekje

për të transferuar ndjenjat nga zemra e tyre në zemrat e veta. Kjo mënyrë realizon shndërrimin e njohurive në praktikë.

Njohuritë teorike nuk mjaftojnë për të formuar personalitetin e njeriut. Njerëzit përveç përvetësimit të dijes, dëshirojnë dhe kanë nevojë për një shembull. Nga kjo pikëpamje, prindërit, mësuesit dhe të rriturit, janë në pozitën e një modeli dhe shembulli për fëmijët.

Prania e një modeli dhe shembulli të mirë në edukimin shpirtëror, është hapi më i rëndësishëm në procesin e edukimit të rinisë, për të arritur shkallët e përsosmërisë. Por procesi i arritjes së pjekurisë në edukimin shpirtëror nuk është një proces i shkurtër, sepse në rrugën shpirtërore njeriu në mënyrë graduale përmes ibadetit dhe veprave, është gjithmonë në kërkim të përsosmërisë shpirtërore. Në rrugën drejt ngritjes shpirtërore, njeriu duhet të luftojë së pari egon. Një nga faktorët e rëndësishëm në arritjen e përsosmërisë shpirtërore, është përballja me sfidat. Një njeri që nuk përballlet me sfida, nuk mund ta arrijë asnjëherë përsosmërinë shpirtërore. Thuhet që gurët e bardhë të bregdetit kanë qenë copa gurësh të thepisur, të shkëputur nga shkëmbinjat aty afër, por nga goditja e vazhdueshme e dallgëve, nuk u ka mbetur asnjë thep, janë bërë të lëmuar e të sheshtë si një xham. Kjo formë e gurëve ka ardhur si pasojë e goditjeve të vazhdueshme të dallgëve.

Edhe njeriu, sa më shumë t'u bëjë ballë vështirësive dhe problemeve, aq më i aftë dhe i zoti bëhet. Një njeri

që nuk kalon asnjë sprovë, nuk mund të premtojë ndonjë gjë të madhe. Ari më i vlefshëm është ari që merr formë të bukur nga përpunimi me çekiç i argjendarit.

Edukimi shpirtëror, më tepër se njohuri, është dashuri. Në qendër të dashurisë është interesimi dhe ndjenja. Të gjithë njerëzit për nga natyra, kanë një simpati dhe intersim për Krijuesin dhe jetën fetare, por shndërrimi i këtij interesimi në dashuri dhe ushqimi me dituri i këtij interesimi, janë thelbësore. Interesimi i ngjeshur për jetën fetare, duke neglizhuar dijen, sjell fanatizëm të verbër, kurse prirja fetare, e mbështetur vetëm në dituri, duke neglizhuar dashurinë, sjell një fe pa shpirt. Asnjëra nga këto dyja nuk është e dëshirueshme. As dashuria pa dituri dhe as dituria pa dashuri, nuk janë të dobishme. Kur dituria bashkohet me dashurinë, krijon një personalitet dhe identitet të fortë islam, sepse feja nuk është kauza për t'i sjellë kënaqësi dhe lumturi trupit, përkundrazi, është aksioni për t'ia nënshtruar shpirtit trupin dhe jetën. Në edukimin fetar vetëndërgjegjësimi është parësor, sepse njohja e njeriut ka qenë objekt interesimi qysh prej krijimit. Shprehja "Kush njih veten, njih Krijuesin", është në themel të logjikës së këtij mendimi. **"Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte."** (Alak,1-5.) Edhe ajeti i mësipërm e urdhëron njeriun të studiojë veten, për ta njohur më mirë atë. Të njohësh veten, do të thotë të njohësh aftësitë dhe dobësitë e tua. Edukimi nxjerr në pah, zhvillon dhuntitë e njeriut dhe përmirëson e rregullon mangësitë e tij. Njohja e vetvetes është kusht kryesor për të arritur tek Krijuesi.

Interlokutori i edukimit shpirtëror është zemra e njeriut. Mevlana, edukimin shpirtëror e ka përngjasuar me mullirin, ku zemra është drithi, njeriu mulliri, trupi guri dhe mendimet, uji. Uji, që simbolizon mendimet, vë në lëvizje gurin, pa ujë guri nuk lëviz, pas procesit gruri shndërrohet në miell.

Edukimi fetar dhe shpirtëror, së pari është dashuri. Nëse në këtë edukim nuk ekziston dashuria, atëherë shfaqet imitimi. Mendja është një pishtar, kurse dashuria është diell. Mendja duhet deri sa të lindë dielli. Nëse lind dielli i dashurisë, nuk ka nevojë për pishtarë.

Qëllimi i edukimit fetar dhe shpirtëror është nxjerrja e njerëzve nga injoranca në dritë. Drejtimi i njerëzve për nga e mira, e bukura, e drejta dhe e dobishmja, në mënyrë që të arrijë qëllimin përfundimtar, fitimin e xhenetit.

Në rrugën drejt edukimit shpirtëror ka një sërë pengesash. Pengesa më e madhe në këtë rrugë konsiderohet

nefsi, i cili nuk dëshiron t'u bindet urdhëresave fetare. Kjo vjen si pasojë e bindjes që tregon njeriu përballë çdo dëshire të nefsit. Në procesin e edukimit shpirtëror, terapia e kësaj është refuzimi i dëshirave që vijnë nga nefsi. Preukopimin e nefsit me punë që janë të vështira për të, si të folurit pak, të ngrënit pak dhe të fjeturit pak.

Gjithashtu, një pengesë tjetër është dëshira e njeriut për t'u dukur, për të qenë i pari në çdo gjë. Kjo vjen si pasojë e vetëpëlqimit të tepërt. Kurimi i kësaj është modestia dhe ndërgjegjësimi se çdo mirësi që zotëron, është dhuratë nga Allahu.

Në rrugën drejt edukimit shpirtëror duhet të zvogëlohet pasioni dhe dhënia e tepërt pas kësaj bote. Dhe kjo arrihet duke kujtuar vdekjen dhe kuptuar se bota nuk është e përheshme. Ajo çfarë i jep kuptim kësaj jete, është besimi tek Allahu dhe bota tjetër.

Edukimi shpirtëror ka një sërë dobish, ndër të cilat mund të përmendim:

1- Edukimi shpirtëror i krijon njeriut mundësinë të njohë veten dhe Krijuesin. Ajeti: **"Lexo në emër të Zotit, i Cili të krijoi,"** e shpreh qartë metodën e njohjes së Allahut dhe rrugën e diturisë.

2- Edukimi shpirtëror, përmes rregullimit që i bën jetës së individit, i jep kuptim jetës së tij. Në sajë të edukimit shpirtëror, njeriu mëson ta përdorë kohën në mënyrë sa më produktive. Nëse individët përvetësojnë një jetë të rregullt edhe shoqëria bëhet më e shëndoshë.

3- Edukimi shpirtëror i frymëzon individit dhe shoqërisë të mirën, të drejtën dhe të vërtetën.

4- Në edukimin shpirtëror duhet të përfshihen të gjitha institucionet. Në këtë mënyrë, edukimi shpirtëror realizon drejtësinë sociale në shoqëri dhe ndihmon në rrenjosjen e vlerave, nga ana tjetër, nuk lejon shfaqjen e dukurive që dëmtojnë vlerat.

5- Në çdo moment njeriu përballet me probleme të ndryshme. Problemet bashkëshortore, fëmijët e pabindur, problemet ekonomike dhe problemet shëndetësore, të gjitha këto ndikojnë negativisht në jetën e njeriut. Largimi dhe lehtësimi i këtyre shqetësimeve, mundësohet vetëm përmes një edukimi të mirë shpirtëror. Shkurtimisht, edukimi shpirtëror e bën njeriun të fortë përballë çdo shqetësimi, madje duke menduar se shpërblimi që mund të vijë nga vuajtjet është i madh, shpesh vuajtjet kthehen në gëzim. Besimtari beson se çdo gjë ndodh me vullnetin dhe dijen e pakufishme të Allahut dhe kjo e bën atë të qëndrueshëm dhe të fortë përballë çdo situatë negative.



Jemi midis Urës!

Shum veta prej nesh tue pamë gjindjen t'onë të vështirë në pikpamjen sociale, thonë me një zâ të çuditshem: kemi ngelun midis Rrugës, dhe duhet të hedhim çapat, duhet të shpetojmë se të ngulenit në një vend është një soj me prapavajtjen; të kish qenë me kaq, t' ishte e përshtatun si duhet për gjindjen t'onë sociale ajo shembllë, do të thosha prap deri dikû jemi të lumtun; mjerisht nuk jemi midis rrugës, ku mundet edhe të çlodhemi ca kohë tue ndejtun me do një anë, por jemi midis një Ure qi me miljuna kombe po kalojnë nga një anë në tjetrën dhe fatkeqësisht ato qi nuk po mundin t'ecin si shokët me atë forcë, shpejti e aktivitet, po shtypën, po shkelën pa mëshirë.

Per mos t'u shtypun ç'duhet të bajmë? Përpara! Dhe natë e ditë përpara! Se ky parim ka me na shpetu nga çdukia e tmershime dhe e përjetshme.

Kto frazë i themi të gjith, por përparimi lypen sakrifica të randa e mundime të gjânë në ç'do degë të jetës jo vetëm në jeten private por edhe në jeten shtetnore. Ne sot duem të flasim midis të dyjave, dëshirojmë me një melanzh analytikë të shpjegojmë brezin e këtyne dy themelimeve qi mbas kuptimit t'onë është boga tija sociale.

Si e dimë të gjithë një societe e qytetnuëme për bahet prej personave të organizuëm; sa do të jet burimi i societës i pështetun në shumicë të frymëve, mos të harrojmë se vetëm shumica e frymëve nuk siguronë kurr begatin socialë të një vendi; Kini qi ka një popull si të madhe, po pa të organizuëme është shëmblla e gjallë per sa shkrumë mâ naltë.

Atëherë ne mbesojmë se begatija sociale do t'na sigurohet tue organizue vehtet qi përbajnë societën t'onë të mejtohemi si mund të bahet ky organizim, i cili jemi të mendjes mund të themelohet tue formuë grupe karijere, tergtare, mjeshtërore

dhe kulture.

Këto grupe kanë me lojtun rolin mâ të madhë në organizatën sociale; këto jo vetëm qi do t'na bajnë të ditun nga sëmundjet që brijnë trupin t'onë socialë por do t'na detyrojnë t'u gjejmë edhe barin e sherimit të këtyne lëngatave shkatruëse.

Vendi i ynë pa dyshim është tue kalue një evolucion socialë, dhe ky në siç-do shkallë po banë efektet serjoze me të tanë fuqinë e tij pershembëlluës. Me durë lidhun jeni tue cun mbas rrymit, dhe po presim si ata njerës qi lidhen fatit, për kû kemë me shkuë!

Kjo gjindja e jonë përshembëlluëse tue mos pasun një direksionë të vizguëm mbas nevojës së vendit e të kohës, kamë frikë nuk ka me na dhanë ato ruta qi dëshirojmë. Themelimi i një evolucioni në ligjë, në instituta kjoftë, për me qenë i realizuë me të tanë qellimine shenjtë, është nevojë me anën e grupevet inisiator m'u njoftuë shkoqitnisht kundrejt vetëve qi përbajnë sosieten. Rregullimi i jetës sociale përbahet nga mardhanjet e vazhduëme nder mjete vehtave e të Togut populluër armonia e përfituëme midis vargut të këtyne mardhanjeve siguronë mbarvajtjen e ati rregullimi.

Zakonet e përfituëm midisi grupevet sociale, lëvizjet e tyne përmbledhuës, në personat e societës themelojnë me të vertet mardhanje të një zâshme e të qendruëshme; rregullat e reja evolucionare, qi ende janë një shembëll ideje, për me i përputhun e i tretun në shpirtin e popullit, është nevojë m'u shpjeguë këto për an tij brënda në rrojtjen e tij, dhe tue bâmë organizime popullore të cilat duhet me i pasun gjithnji nën kontrollime të sinqerta.

Ky kontrollim, ky rregullim, mund të bâhet vetëm tue mirë organizuë togjet e popullit, trupet fetare, dhe organizatat pleqësore. Pa themeluë një rre-

gullim të tillë nuk mund të pretendojmë se ideali i jonë mbi evolucionin socialë është përhedhun nga petet intelektualë në petet e popullit; sa do qi të ndryshojnë Ligjet sa do qi të përbuzim vështirsinat e do zakeneve të vjetër, por kto ngelin mbi letër e në frymë të fjalëve pa kur farë efekti themeluës.

Shkurtazi duhet thënë: po nuk pati bashkim në zakone, në ndjenja, në dëshira, në dobina nuk themelohet një rregullim socialë.

Në shekullin e fundit përgjithsisht njerzit janë tue u ankuë nga jeta sociale, janë të zvirhdun nga pa drejtsia q' u bahet tue shkelun egalitetin; mendime dhe i dera të reja janë tue prishun rregullat e para sociale; në këtë l'amë të zhvillimeve të reja për me rregulluë të shkadhet e të futun në shpirtin e popullit; për qendrimin e rregullimit socialë duhet me do e mos me themeluë marëdhanëjet të njëzëshme midis shtetit, fevet, ligjevet, dhe ster-vitjes sociale.

Dhoma e Deputetve në sesionin e fundit bëri fjalë për nevojën e modernizimit të Ligjeve, dhe u-formua më pas një Komision i posaçëm për formimin e ktyne; këtë nuk do të bëjmë fjalë mbi dobin ose damin qi do të na shkaktojnë ligjet e reja, se për të dhanë këtë gjykim duhet më parë të dimë se veprimet e këti Komisioni me çfarë drejtimi juridikë e sanksioni Legal janë tue u-razhit për realizimin e tyre; mbasi këtë dijeni nuk e kemi, do të presim për me dhanë gjykimet t'ona nga pikë pamja sociale.

Vetëm duhet të mejtohem thellë se kur bëjmë një gadi të re, na duhen mobila të reja, në kjoftë se ngrëfim një maqinë edhe e mjellit kjoftë duhet t'a dimë se na duhet maqinistë e jo minollaj i millinjëve qi kanë ngelun nga koha e Nojës.

Ligjet që kemi në fuqi të cilat kemi dashun t'i quajmë si t'onat tue i andrue me balloma nuk mund të themi se janë Ligjë; Nuk është e drejt të themi se këta Ligjë i përshtaten si duhet jetës s'onë, por edhe aqi e pa-drejtë asht të mohuemit e një realiteti qi ekzistonë mbi fuqinë e zbatimit të këtyne kanuneve; se me gjithë të metat qi kanë, përmbajnë një traditë të motshme, për rregullimin e nevojave të kombit t'onë.

Katunari e qytetari me një pësim të provës së persëritun, e kan përvetue përfundimin e të drej-

tavet të vetë rreth zbatimit të ligjëve qi ndodhen në fuqi; nesër ase pas nesër kur do të ndodhet kundrejtë impresioneve të Ligjve të reja, ka për të ndërë në gjendjen e tij një hujtëni, një ndryshim të tjetër ngjyrëshëm, i mirë për ligjvënsit dhe për intelektualt, por i pa ardhun e i pa çëmuarë nga populli qi përbanë shumicën.

Cili është pra mjeti qi kto ndryshime ja kanë ditun edhe popullit, i siguron asimilacion e duhun ligjve të reja pa tronditun rrjedhimin e konvikcioneve? Si kunder thamë më naltë rregullimi i organizatave të ndryshme me lider të zotnit e antar të shkadhet vetëm e vetem ka me na lehtësue shtegtimin nga njena anë, n'anë tjetër t'Urës së qytetnimit të vertetë.

Populli qahet për shumë nevoja thotë se s'kamë udhë, s'kamë ujë me pi, s'kamë shkollë, edhe mbi gjith këto me një zâ të mjerushëm shton tue thanë nuk kamë të holla; por aji nuk mejton se kto s'mund t'i zbrisen nga qielli, e nuk i vjenë mirë t'a çmonjë qi do t'i sigurohen tue organizue vet vetin.

Nuk mjaftonë të nemëroshme undjet e jetës sociale, por është një nevojë e madhe m'i gjetun barin e sherimit këtyne sëmundjeve shkatrruëse; e pra ilaçi i parë asht organizimi i katundeve, gastrave, me anën e pleqësive të dijshe e çëmuëse mbi nevojën e Evolucionit; duhet ma parë se të bëjmë ndryshime në jetën sociale e në botën legale ma parë të përëndajmë në per katunde elementet e ri me mendime të reja t'ja futin popullit atë nevojë në shpirt e tue kuptuë aji atë Evolucionë si një mjetë shpetimi duhet të fillojmë në zbatime të reja.

Kur do të shofim qi organizatat e pleqësive fillojë të rregullohet me lider qi kuptojnë psikologjin e popullit, historin e qarkut qi ndollet, pozitën gjeografike shëndetsore, e kulturele të vendit, do të mbesojmë se kemi siguruë shtegtimin social në udhën madhshëtore të Evolucioneve: Pjesa intelektuale duhet të banjë këto sakrificat morale e materiale ma parë se të lypin realizimin e dishirave evolucionare.

Luma Skendo

Marrë nga Zani i Nalte
N. 4 NANDUER 1926, fq. 111

Regjistrimi i parë osman (tahrir) në Shqipëri

Organizimi i Perandorisë Osmane dhe funksionimi i aparatit të saj shtetëror mbështetjet mbi sistemin e timarit. Ky sistem u vendos në Ballkan dhe në Shqipëri gradualisht që në shek. XIV. Burimet historike të shek. XIV nuk janë të plota për të pasqyruar dinamikën e shtrirjes në kohë e hapësirë të sistemit të timarit.

Dokumenti më i hershëm, i zbuluar deri tani, për të njohur sistemin e timareve që vendosën osmanët në Shqipëri dhe në Ballkan, është regjistri kadastral i vitit 835 h. (1431-1432), i emërtuar "Regjistri i Sanxhakut Shqiptar" (Defter-i Sancak-i Arvanid). Në të janë përfshirë një pjesë e viseve të Shqipërisë Perëndimore, që shtriheshin nga Çamëria deri në lumin Mat. Krahas pasqyrim të shpërndarjes së timareve në çastin e hartimit të regjistrit, në të ka edhe shënime që u referohen periudhave më të hershme, kohës së sulltan Bajazitit I (1389-1402) dhe të sulltan Mehmetit I (1413-1421).

Të dhënat e regjistrit të vitit 1431-1432, për praninë e sistemit të timarit në Shqipëri që në fund të shek. XIV janë fare të pakta dhe kanë të bëjnë me krahinën e Korçës e të Përmetit. Kurse për kohën e sulltan Mehmetit I janë më të shumta. Ato tregojnë se pas marrjes prej osmanëve në vitet 1417 e 1418 të kështjellave të Gjirokastrës, të Beratit, të Kaninës etj., ishte bërë një regjistër kadastral dhe ishte formuar Sanxhaku Shqiptar, po me atë shtrirje të përafërt që do të kishte edhe në regjistrimin e mëvonshëm të vitit 1431-1432.

Në kohën e sulltan Mehmetit I osmanë kryen regjistrimin themeltar të vendbanimeve, të shtëpive, të pronave tokësore, i grupuan ato nëpër timare të madhësive të ndryshme, caktuan llojet e taksave dhe sasinë e detyrimeve që familjet e regjistruara duhej t'i paguanin shtetit dhe spahiut të tyre.

Ata synonin të zbatonin sistemin e tyre feudal ushtarak dhe, në radhë të parë, të vendosnin pronësinë feudale osmane mbi tokën, e cila ishte mjete kryesor i prodhimit. Të gjitha tokat e punueshme, arat, livadhet, kullotat, pyjet, korijet, pavarësisht në duart e kujt ndodheshin, konsideroheshin pronë mirie, d.m.th. pronë shtetërore (araz-i miriye) dhe vetëm një fond i kufizuar tokash u jepej si pronë private (araz-i mylk) komandantëve të shquar ushtarakë.

Toka vakuf formonte një kategori të veçantë prone, atë të institucioneve fetare, të cilat në këtë periudhë ishin në numër të pakët.

Me shpalljen e tokave të regjistruara si pronë mirie, tokat hynë në fondin e përgjithshëm tokësor të shtetit osman. Në varësi me madhësinë e të ardhurave që, sipas funksioneve, rëndësisë e njohjeve, u caktoheshin feudale të rinj osmanë, tokat u pjesëtuan në feude të vogla, të mesme dhe të mëdha, që administrata osmane i emëronte timare, ziamete e hase. Këto prona u shpërndareshin me kusht ushtarakëve të quajtur spahinj, subashë e sanxhakbejlerë, si dhe funksionarëve civilë. Këta i mbanin pronat për aq kohë sa ishin në funksionet përkatëse dhe përmbushnin detyrimet e tyre.

Në fillim administrata osmane në Shqipëri përbëhej nga osmanë turq dhe një numër i konsiderueshëm spahinjsh shqiptarë të islamizuar, të cilët përgjithësisht vinin nga radhët e fëmijëve të fisnikëve. Kishte edhe një numër spahinjsh shqiptarë të krishterë. Timaret e këtyre të fundit, përgjithësisht ishin në zona të thella.

Osmanët i ndanin krahinat në njësi të ndryshme administrativo-ushtarake. Këto njësi nuk ishin krijesa arbitrare, por mbështeteshin në lidhjet historike e traditën vendase të ndarjeve kishtarë e administrative. Sanxhakët ishin njësitë më të rëndësishme administrativo-ushtarake të Perandorisë Osmane.

Sipas burimeve historike, që njihen deri tani, në tokat shqiptare u krijuan, në periudha të ndryshme të shek. XV, disa sanxhakë: pasha sanxhaku i Shkupit, sanxhaku i Janinës, sanxhaku shqiptar (Sancak-i Arvanid) etj. Më i rëndësishmi prej tyre ishte pasha sanxhaku i Shkupit, që kishte 22 nahije gjithsej dhe një shtrirje shumë të gjerë: nga Selaniku në lindje dhe arrinte në perëndim deri në Gostivar e Kërçovë. Burimet më të hershme historike për organizimin e tyre, që kanë arritur të ruhen deri në ditët tona, i përkasin Sanxhakut Shqiptar.

Sanxhaku Shqiptar pati si kryeqendër Gjirokastrën dhe shtrihej nga Çamëria deri në lumin Mat. Ai bënte pjesë në ejaletin e Rumelisë, ku përfshiheshin të gjithë sanxhakët e Ballkanit. Sanxhaku Shqiptar ishte i ndarë në njësi të vogla, në vilajete, ku përfshiheshin disa krahina (nahije).

Në krye të sanxhakut qëndronte sanxhakbeu, komandanti i ushtrisë së sanxhakut që formohej nga disa qindra spahinj. Në krye të vilajetit ishte subashi, komandanti i spahinjve, që i kishin timaret në vilajetin përkatës. Subashët vareshin nga sanxhakbeu dhe kishin vetëm funksione ushtarake.

Në çdo vilajet, pranë subashëve ishin kadilerët, të cilët kryenin funksione administrative, civile, gjyqësore dhe fetare. Ata si kryetarë gjyqi, vendosnin jo vetëm në proceset juridike, por edhe në çështjet e shfrytëzimit dhe të ndarjes së timareve. Pranë kadilerëve kishte edhe funksionarë të tjerë të administratës shtetërore osmane. Këta ishin naibët, zëvendësit e kadilerëve, dhe imamët. Në çdo qytet ishte edhe dizdari, komandanti i rojeve të kështjellës. Të gjithë ata ishin të pajisur me timare. Popullsia jomyslimane (e krishterë, etj.) cilësohej raja. Sipas kësaj, administrata osmane i konsideronte shtetasit e saj tufë që duhej rujtur dhe mbarështuar nga pushteti qëndror dhe rajonal osman.

Aparati shtetëror qëndror e lokal i Perandorisë Osmane kujdesej për zbatimin e sistemit të timarit, mbi bazën e të cilit ishte ngritur e funksiononte tërë struktura politike, ushtarake e administrative e Perandorisë Osmane. Të ardhurat që vilesnin nga tatimet e sistemit të timarit, mbanin në këmbë gjithë aparatën shtetërore dhe mbulonin shpenzimet e tij.

Kujdesin e veçantë, që kishte aparati shtetëror për zbatimin e sistemit të timarit, e tregojnë më së miri procesi i regjistrimeve kadastrale të herëpashershme dhe shënimet e shumta anësore me të cilat janë pajisur regjistrat përkatës. Hartuesit e kadastrave (eminët) dërgoheshin nga kryeqyteti për të bërë regjistrimet. Në bazë të dekretëve (berateve), që sulltani u kishte lëshuar spahinjve, eminët shkonin fshat më fshat për të regjistruar shtëpitë, pronat e tatimet që duhej të vilesnin. Në përfundim të këtij procesi, eminët hartonin regjistrat e hollësishëm (mufasal defteri). Gjithashtu, ata bënë edhe kopje të përmbledhura të tyre, siç është edhe regjistri kadastral i vitit 835 h. (1431-1432), që është zbuluar në arkivat turke. Ai është i pajisur me shënime anësore që janë bërë vazhdimisht, deri në vitin 1455, për të pasqyruar zëvendësimin e spahinjve të mëparshëm me të rinj, ndryshimet që pësonin timaret, duke i zmadhuar ose zvogëluar ato, si dhe krijimin e timareve të reja me fshatra e grupe familjesh, që zbuloheshin si të paregjistruara e të fshehura etj.

Në këtë kuadër u ndërmor edhe regjistrimi i vitit 835 h. (1431-1432), nga i cili është zbuluar një kopje e përmbledhur e tij. Ai është regjistri kadastral më i hershëm për Ballkanin, i hartuar nga administrata osmane dhe i zbuluar deri më tani. Kjo kopje është e ndarë rastësisht në dy pjesë, nga të cilat vetëm njëra është botuar në vitin 1954 prej historianit turk Halil İnalcık. Në të janë shënuar

emrat e ndarjeve administrative e të qendrave të banimit, emrat e spahinjve, llojet e tatimeve që paguheshin e madhësia e tyre e shënuar në akçe (monedhë osmane) etj.

Gjirokastra ishte kryeqendra e Sanxhakut Shqiptar dhe në këtë sanxhak ishin përfshirë krahinat nga Çamëria deri në lumin Mat. Ai ishte i ndarë në 11 vilajete, të cilat më vonë do të quhen kaza: vilajeti i Gjirokastrës, i Këlcyrës, i Kaninës, i Beratit, i Tomoricës, i Skraparit, i Pavël-Kurtikut, i Çartallozit, i Krujës, i Përmetit dhe i Korçës. Dy vilajetet e fundit janë përfshirë në pjesën e pabotuar të regjistrimit osman të vitit 835 h. Si sanxhakbe i Sanxhakut Shqiptar u caktua Ali bej Evrenosi.

Krahas krahinave që ishin përfshirë në Sanxhakun Shqiptar, shënimet anësore të regjistrimit të vitit 835 h. (1431-1432) tregojnë se ndërkohë osmanët kishin regjistruar edhe rajone të tjera shqiptare. Sipas tyre, në një regjistër të veçantë e të pazbuluar deri tani ishin shënuar zotërimet e Gjon Kastriotit.

Sipas regjistrimit të vitit 835 h., në Sanxhakun Shqiptar ishin rreth 475 timare, duke përfshirë edhe shtesat e bëra gjatë viteve të mëvonshme.

Një pjesë e përfaqësuesve të fisnikërisë shqiptare u integrua në radhët e spahinjve e të drejtuesve të shtetit osman. Këta, si dhe individë nga shtresat e tjera, qofshin edhe të ulëta, që futeshin në radhët e luftëtarëve osmanë dhe dalloheshin në luftime, merrnin timare dhe poste të ndryshme, madje edhe në viset shqiptare. Edhe disa familje që ishin caktuar për ruajtjen e mirëmbajtjen e kështjellave e të ngushticave nga kalonin rrugët, osmanët i lironin nga një pjesë e detyrimeve. Elementë të tjerë nga radhët e fisnikërisë shqiptare u përfshinë në shtresën e spahinjve e të funksionarëve osmanë nëpërmjet institucionit të iç-ogllanit (pazhë) dhe të gulamit (djalë i rritur).

Dokumentet dëshmojnë se osmanët i kushtuan vëmendje shtresës së fisnikëve. Ata u përpoqën të afronin elementë nga radhët e fisnikërisë shqiptare dhe për këtë, përdorën marrëdhëniet e vasalitetit. Këtu ata konvertoheshin në fenë islame dhe edukoheshin me frymën e besnikërisë ndaj sulltanit. Nëpër institucionin e iç-ogllanit kaluan i biri i Gjon Kastriotit, Skënderbeu, i biri i Teodor Muzakës, Jakup Beu, i biri i Gjon Zenebshit, Hamza Beu etj.

Elementë të tjerë nga radhët e fisnikëve shqiptarë qëndronin pranë bejlerëve e sanxhakbejlerëve si gulamë (djalë i rritur), jetonin e shërbenin pranë tyre që të përgatiteshin për karrierën e feudalit osman. Pas kësaj, gulamëve të islamizuar mund t'u jepeshin si timare dhe pronat e baballarëve ose të afërmeve të tyre. Institucioni i gulamit u zbatua edhe në Shqipëri. İç-ogllanë e gulamë me origjinë shqiptare morën timare e poste jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajone të tjera të Perandorisë Osmane.

Arkitektura Islame

Arkitektura islame është një nocion që përmbledh të gjithë artin arkitekturor islam, të manifestuar në ndërtesa si: hane, medrese, teqe, spitale, fontane, vendstrehime për të varfrit dhe jetimët, tyrbe, tregje (bedesten: bexhisten), hamame, posta, karvansaraje, kështjella, ndërtesa zyrtare, biblioteka, ura, varre, vendbanime të ndryshme, qendra të hulumtimit dhe observimit, xhami, etj., të zhvilluara brenda një qarku kohor prej më shumë se njëmijë viteve dhe të përhapura në një zonë gjeografike mjaft të gjerë, nga arkitektët myslimanë dhe jomyslimanë në vendet islame dhe për myslimanët.

Arkitektura islame ka disa faza të zhvillimit të saj. Ndonëse fillimet e saj janë që nga ndërtimi i Xhamisë së Profetit, pas migrimit të Profetit Muhamed nga Meka në Medine, arkitektura islame njohu zhvillimin e vërtetë të saj pas katër kalifëve, në periudhën e kalifatit emevit. Pastaj, stili i arkitekturës islame është zhvilluar gjatë periudhës abasite. Stili i mrekullueshëm arkitektonik i Spanjës dhe Magribit mysliman, stili egjiptian, stili pers, si dhe ai turk (karahanët, gaznelitë, selçukët, timurët, safevitë, memlukët dhe osmanët) bënë gjithashtu që arkitektura islame të formojë identitetin e saj.¹

Që me kalimin e kalifatit tek Emevitë në vitin 661, u shpërngul qendra e shtetit islam, nga Medina në Sham. Myslimanët u takuan aty me trashëgiminë e kulturës antike, ndaj dhe ndërtesat i bënë në përshtatje me këtë kulturë që gjetën. Ky stil që lindi dhe u vendos aty, ndikoi më pas në të gjithë artin e botës islame.

Arkitektura islame kishte një natyrë të veçantë. Me të drejtë, studiuesja gjermane Sigrid Hunke, thotë se për të përgënjeshtuar tezën se gjoja myslimanët kanë qenë imitues të thjeshtë, mjafton qytetërimi që ata sollën në Spanjë. Hunke shkruan: *"Kur mbërritën (myslimanët), gjetën minimumin e elementeve, në një vend ku asnjëherë nuk ishte zhvilluar ndonjë lloj qytetërimi autokton. (...) Ishte një hiç total. Emigrantët që mbërrinin me turma nga Arabia dhe Siria gjenin aty popuj të paaftë për t'i pasuruar me çfarëdolloj gjëje. Nuk kishte asgjë, që ata të mund ta*

1. Shih. *Islam Sanatları Tarihi*, (Grupautoresh), f. 10 – 64.

*përvetësonin, asimilonin, imitonin apo përpunonin. Mirëpo Spanja, njohu një lulëzim të paparë në atë kohë. (...) Por shkëlqimi i pakrahasueshëm i qytetërimit andaluzian nuk i detyrohet asgjë gjenialitetit grek apo pers; më shumë se askujt tjetër ai ia detyron gjithçka vetëm gjenialitetit arab. Nga ana tjetër, me t'u dëbuar arabët nga Spanja, arti do të zhytej në shkreti të plotë, në një heshtje varri. Vërtet, asgjë s'do të mund ta vërtetonte më mirë fuqinë krijuese të gjenialitetit arab."*²

Xhamitë janë vendet ku Islami është në dialog me artin dhe të cilat, me plot kuptimin e fjalës mund të quhen galeri të harmonisë së artit dhe shpirtit islam. Arkitektët myslimanë, në një mënyrë mjaft profesionale dhe artistike, ditën të manifestonin në këto objekte bukuritë magjepsëse natyrore që ka krijuar Zoti. Në strukturat e shumë xhamive janë përzier njëra me tjetrën artet e ndryshme. Arkitekti me piktorin kanë punuar me një harmoni të përkryer ngjyrash e dizajnimesh.

E njëjta harmoni dhe përshtatje thua se gjendet në të gjitha xhamitë e ndërtuara nga shtetet islame në histori. Pa dyshim, këtë komunikim e gjejmë në një mënyrë të përkryer në Granatë, në sarajin Alhambra. Me gjithë pluhurin e shekujve, Alhambra qëndron madhështore, ashtu sikur thotë poeti francez Viktor Hygo, *"Xhinët e kanë ngritur në këmbë si një ëndërr të artë dhe e kanë qëndisur me harmoni."*

Taxh Mahala në Indi, është një tjetër vepër arti madhështore islame, e cila është një nga mrekullitë e botës, sa që me të drejtë një shkrimtar, kur është përballur me bukurinë magjepsëse të saj, është shprehur: *"Sikur koha të kishte mend, me siguri do të shkatërronte të gjithë ndërtesat e tjera përveç Taxh Mahalës, e cila do të ishte një terapi e mjaftueshme për shpirtin e sëmurë të njerëzimit."*³

Për nga aspekti kronologjik, pas ndërtimit të Kubetus-Sahras në Kudus, ndërtesa e dytë e rëndësishme për myslimanët ishte Xhamia e Madhe (Xhamia Umejje)

2. Sigrid Hunke, *Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin*, Përkth. O. Ademovi. f. 335 – 336).

3. Shih. Hakimi, M. Riza. *Islam Bilim Tarihi*, 227 – 229.



në Damask, në vitet e para të shekullit VIII. Atëherë kur Krishtërimi dhe Islami, gjatë kohës së Kryqëzatave, kishin një komunikim të afërt me njëri – tjetrin, është bërë shkëmbim i ndërsjelltë i njohurive dhe teknikave. Pasojat e këtij komunikimi mund të vërehen lehtësisht në Rilindjen evropiane. Mjeshtri i madh i Renesencës, Leonardo da Vinci, në një nga punimet e tij e shpreh qartë frymëzimin që ka pasur nga motivet islame.⁴

Natyrshëm, ne nuk mund të pretendojmë të ezaurojmë këtë temë brenda hapësirës që na jep revista, edhe sikur të detajohemi vetëm në një periudhë kohore të caktuar, në një pjesë gjeografike të caktuar apo qoftë edhe vetëm mbi veprat e një arkitekti, pasi për shembull, vetëm Mimar Sinani ka ndërtuar 131 xhami, 62 medrese dhe kurse të Kuranit, 19 tyrbe, 20 spitale dhe vendbanime për të varfrit, 21 karvansaraje dhe bexhistene, 8 ura, 7 çesme, 33 hamame dhe 33 saraje.⁵

Para së gjithash, ne duhet të kuptojmë se artet islame në përgjithësi, janë mjaft ideologjike, pra ato kanë një qëllim më vete, religjioz. Për shembull, arkitektura islame ka për qëllim të përcjellë tek njeriu idenë e Tevhid-it, Khalifa-s dhe Ihsan-it.

Atëherë, le të ndalemi në elementet bazë të arkitekturës islame:

1. TEVHIDI

Tevhid⁶, literalisht do të thotë “pohimi i Njëshmërisë”

4. Tez, Zeki. *Ortacag Islam Dunyasinda Bilim Ve Teknik*, fq. 179.

5. Miquel, Andre. *Islam Medeniyeti*, fq. 450.

6. Për të kuptuar më gjerë dhe më shkoqur atë se çfarë është Tevhidi në Islam shih.: Murata & Chittick. *Vizioni i Islamit*. Përkth. S. Ahmataj. Tiranë. Fondacioni

së Zotit. Afirmimi i njëshmërisë së Zotit, që është parimi i parë i besimit dhe ideja mbizotëruese në Islam.⁷

“Arti islam ka prirje të mos paraqesë gjëra, por kryesisht ide. Shkaku i kësaj del qartë, po të kuptojmë që absrtaksioni është funksion i arsyes, dhe arsyeja, e ndriçuar nga *teuhidi*, kupton *tenzihun*⁸; arsyeja e çliron realitetin hyjnor nga çdo realitet i krijuar. Megjithatë, arti është imazhinal për nga natyra. Pra, arti është i lidhur ngushtë me *teshbihun*⁹, vizionin e pranisë së Zotit në botë. Për të shprehur *teuhidin*, format artistike, që lidhen me teshbihun për nga vetë natyra e tyre imazhinalë, duhen kompensuar me pasqyrime të cilësive abstrakte e të largëta. Me fjalë të tjera, format duhet ta paraqesin disi bukurinë si diçka që u përket jo atyre, por Zotit. Arti islam i kujton njerëzit për bukurinë hyjnore, duke e shkëputur këtë bukuri nga kjo botë e nga gjërat që artet figurative janë të prirura të paraqesin.”¹⁰

Pikësëpari, artisti dhe arkitekti absolut është vetë Zoti, pasi Ai është Krijuesi i gjithçkaje dhe pronari absolut i gjithësisë. Kjo doktrinë është e rrënjësor mjaft qartë në vetëdijen e secilit mysliman. Ndaj dhe arkitektët myslimanë kanë marrë përsipër ta manifestojnë këtë koncept në ndërtesat madhështore dhe në stilin e ndërtimit të tyre.

Mendimtari i madh mysliman, Dr. Ismail Faruki (1921

Rumi. f. 108 – 213.

7. Murata & Chittick. f. 458.

8. “Pakrahasueshmëria e Zotit me krijesat e Tij; transhendenca e Tij.” (Murata & Chittick. f. 457)

9. “Ngjashmëria e Zotit me krijesat e Tij; imanenca e Tij brenda krijimit.” (Po aty.)

10. Murata & Chittick. f. 407 – 408.



– 1986), në veprën “*Tevhidi, implikimet e tij për mendimin dhe jetën*”, shpjegon gjerë rreth ndikimit të idesë së Tevhidit në qytetërimin islam. Sipas tij, koncepti i Tevhidit i jep identitetin e saj të veçantë arkitekturës islame, si pjesë integrale e qytetërimin islam. Ky koncept ka krijuar tek myslimanët një botëkuptim tevhidist të paparë, në ndërtimin e aktiviteteve të nivelit të lartë të përputhshmërisë midis objekteve dhe përdoruesve të tyre. Tevhidi ka krijuar një dialog mjaft produktiv mes arkitekturës islame dhe myslimanëve.¹¹

Si rezultat i kësaj vetëdijeje të fuqishme fetare dhe entuziazmi, të frymëzuar dhe të dominuar nga koncepti i Tevhidit, myslimanët kanë zhvilluar në fushën e arkitekturës një kulturë ndërtimesh dhe dizajnimesh, që synojnë të tërheqin vëmendjen për një sistem më të lartë të të shprehurit dhe të kuptuarit.

Në një farë mënyre, arkitektura sipas konceptit të arkitektit mysliman, është fusha përmes së cilës, ai përpiqet t’u shfaqë Tevhidin besimtarëve apo vizitorëve.¹²

2. KHALIFA

Sipas Islamit, njeriu është *khalifa* (mëkëmbës), i Zotit në tokë. Adami u krijua për të qenë përfaqësues i Zotit, pra mëkëmbësia është privilegj dhe përgjegjësi, që u është dhënë vetëm njerëzve.¹³

Ky perceptim unik islam mbi njeriun dhe ndaj pozitës së tij në tokë, krijon një marrëdhënie interesante të njeriut me mjedisin. Kjo ndodh jo vetëm pse njeriu është i varur nga natyra për mbijetesën e tij, por edhe pse ai, sipas botëkuptimit islam, ka në përbërje, që nga krijimi i tij, pjesë nga mjedisi, toka, natyra.

Mjedisi për njeriun, në një farë mënyre, është aleat dhe bashkëpunëtor i misionit të tij në tokë, pasi natyra është një terren për realizimin e qëllimit të tij shpirtëror mbi tokë. Islami na mëson se mjedisi është fytyra universale e krijimit. Roli i mjedisit është për të adhuruar Krijuesin (në mënyra të përshtatshme) dhe për t’iu nënshtruar Atij, në mënyrë që mëkëmbësi i Zotit të kryejë detyrën e tij të nderuar të menaxhimit të tokës.

Njerëzit nuk janë të vetmet krijesa që ndërtojnë, por vetëdija dhe imagjinata e bën njeriun të dalluar nga krijesat e tjera në aktivitetin e tij arkitekturor. Njeriu, duke u bazuar në lirinë dhe dhuntinë e tij, ndërton ndërtesa të formave dhe madhësive të ndryshme. Kë-

11. Për më shumë, shih. Faruki, Ismail Raxhi. (2007). *Tevhidi, implikimet e tij për mendimin dhe jetën*. Përkth. R. Nezirri. Shkup. Logos – A.

12. Për më gjerë, shih: Omer, Spahic. (2009). *Islamic Architecture*. Kuala Lumpur. A.S. Noordeen.

13. Murata & Chittick. f. 453.

shtu, përmes kësaj veprimtarie, krahas qëllimit final të përçarjes së mesazhit hyjnor, ai tregon qartë qasjen e tij ndaj realitetit.

Ekzistenca e njeriut nuk mund të mendohet pa ekzistencën e një mjedisi të ndërtuar. Marrëdhënia mes tyre është themelore dhe intime. Asnjë fazë e pranisë së njeriut në tokë nuk mund të imagjinohet pa aktivitetin e tij ndërtimor, pavarësisht nga shkalla e thjeshtësisë apo sofistikimit të ndërtimit. Ky parim vlen për të gjithë, duke nisur me njeriun dhe profetin e parë Ademin (a.s.), i cili ndërtoi Shtëpinë e parë të adhurimit, Bejtullahun, pra Qaben. Më pas, u ndërtua objekti i dytë i adhurimit, Bejtul-Makdis e kështu me radhë, njeriu vazhdimisht ndërtoi.

Kurani deklaron në kontekste të shumta në mënyrë eksplicite, se gjithçka në univers është në një gjendje të vazhdueshme adhurimi të Allahut.¹⁴ Kësisoj, tërë gjithësia përbën një mega-xhami, pra një hapësirë adhurimi.

Sociologu i madh mysliman Ibn Haldun, po ashtu kishte vërejtur se ndërtimi është bazë e qytetërimin dhe është një nga profesionet më të domosdoshme për njeriun.¹⁵

Duke u nisur nga ideja e Tevhidit, në të cilën shfaqet kthjelltazi Zoti si Mjeshtri dhe Pronari absolut dhe i vërtetë i gjithësisë, arkitekti dhe inxhinieri i ndërtimit mysliman, ngarkuar me frymën e mëkëmbësisë, ndjejnë për detyrë të transmetojnë tek njerëzit këtë vetëdije dhe t’i mbajnë ata në kontakt me këtë ndjenjë të nevojshme për njeriun.

Për të kuptuar vetëdijen e të qenit thjesht një krijesë nevojtare ndaj Zotit dhe mëkëmbës i Tij në tokë, është mjaft domethënëse lutja që bëri Mawlay Idris el-Anwar, para se të ndërtonte qytetin e Fas-it (Fez):

“Zoti im! Ti e di që unë nuk kam ndërmend të ndërtoj këtë qytet për të fituar krenari e as për të rënë në sy, as nuk kam ndërmend hipokrizinë, apo reputacionin e, aspak arrogancën. Por unë dua që për aq kohë sa kjo botë të ekzistojë, Ti të adhurohesh në këtë qytet, të vendosen dhe të zbatohen ligjet dhe parimet e Kuranit dhe të ecet nën udhëzimin e Pejgamberit Tënd. O i Plotfuqishëm, ndihmoji banorët e këtij qyteti për të bërë drejtësi dhe udhëzoji ata për ta përmbushur atë. O i Plotfuqishëm, parandaloji ata nga e keqja e armiqve të tyre. Dhuroju dhuntitë e Tua dhe mbroji

14. Shih. Haxhaxh, 18; Nahl, 48; Merjem, 93; el-Isra, 44; en-Nur, 41.

15. Ibn Khaldun, *The Muqaddimah*, Translated from Arabic by Franz Rosenthal, (Princeton: Princeton University Press: 1967), v. 2, f. 361.



nga fatëkeqësitë. Pa dyshim, vetëm Ti je realizuesi i këtyre gjërave.”

Arkitekti mysliman e ka të qartë objektivin fisnik që ndërmerr për të përcjellë tek njerëzit, pavarësisht nëse ajo çfarë ai ndërton është një xhami, shkollë, banesë e thjeshtë, hotel i madh, spital, fontanë, mauzole, etj., përmes të cilave ai e bën të lexueshme se vetëm Zoti është ai që meriton të adhurohet dhe të lavdërohet. Pra, ndërtesa në Islam është ngritur për t’i shërbyer njeriut, që ai ta madhërojë Krijuesin e vet. Me fjalë të tjera, arkitektura islame është një “shenjë/argument” (ajet) *man-made* në mesin e shenjave të Zotit në natyrë. Këto dy lloje shenjash, duhet të bashkëtojnë në paqe me njëra-tjetrën, duke mbështetur misionin e njëra-tjetrës dhe qëllimin e krijimit.

3. IHSAN

Kur Profeti Muhamed është pyetur nga Xhebraili se ç’është Ihsani, ai është përgjigjur: “Të adhuron Zotin sikur ta shikonit Atë, sepse, nëse nuk e shikoni ju Atë, ju shikon Ai ju.”

Ihsan rrjedh nga fjala *husn/hasene*, e cila nënkupton çdo cilësi pozitive: virtytin, mirësinë, bukurinë, pamjen e pëlqyeshme, hijeshinë, harmoninë, simetrinë, dëshirueshmërinë etj. Në një kuptim më të gjerë, *ihsan* është bërja e asaj që është më e bukur.

Një nga emrat hyjnor apo *esmaul-husna* (emrat e bukur të Zotit) është edhe *el-Muhsin*¹⁶ (Bërësi i asaj që është e bukur). Bërja e së bukurës nga Zoti, fillon

16. Konceptin “Muhsin”, Zoti e ka përmendur për ata që bëjnë vepra të bukura dhe i ka lavdëruar këta njerëz. (Shih. Nisa, 125).

me vetë krijimin, ndërsa lavdia që e kurorëzoi krijimin është njeriu, i bërë në formën më të bukur të Zotit. Dhe, meqë Zoti bën atë që është e bukur nëpërmjet krijimit të qenieve njerëzore, njerëzit kanë detyrimin të bëjnë atë që është e bukur në marrëdhëniet e tyre me Zotin dhe krijesat e tjera. Ashtu sikurse Zoti e ka krijuar si njeriun, po ashtu edhe tërë kozmosin, ashtu edhe veprimtaria njerëzore, që duhet të ndjekë modelin hyjnor, duhet të kryhet bukur.¹⁷

Ihsan gjithashtu, do të thotë edhe përsosmëri, përkryerje. Ndaj dhe kjo fjalë ka një kuptim të dyfishtë: cilësi pozitive dhe përsosmëri. Profeti Muhamed thuhet se ka thënë: “Vërtet Zoti e do atë njeri që, kur nis të bëjë një punë, e bën në mënyrë të përsosur.” Pra, çdo gjë që të bëjë njeriu, duhet ta bëjë në mënyrë aq të bukur dhe të përsosur, sikur e shikon Zotin.

Nocioni islam i Ihsanit ushtron shumë ndikim mbi identitetin dhe karakteristikat kryesore të arkitekturës islame. Duke i mësuar njeriut se ai është forma më e lartë e krijimit në të gjithë botën, pra *Eshrefi Mahlukat*, bën që njeriu të ketë qëllime të larta në botë.

Pikërisht duke u nisur nga përgjegjësia që të jep ky status kaq i lartë që Zoti i ka dhuruar njeriut, arkitekti mysliman, me frymën e *Tevhidit* dhe me misionin si *Khalifa*, ka manifestuar në mënyrë të përkryer *Ihsanin* në veprat e tij, në të gjitha variantet e kuptimit të këtij koncepti: bukurinë, hijeshinë, harmoninë, simetrinë etj.

17. Për të kuptuar më qartë dhe më gjerë konceptin Ihsan në Islam, shih. M - rata & Chittick. f. 369 - 430.

SHËRIMI ME GJËRA TË NDALUARA, ME NDYRËSIRA DHE DHËNIA E MARRJA E GJAKUT SIPAS SHERIATIT ISLAM

Allahu i Lartësuar ka thënë: “...e kush shtrëngohet (të hajë nga këto), duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos tepruar, për të nuk është mëkat...”.

(El-Bekare, 173)

*Transmetohet nga Ummu Selemete (r.a.), se ka thënë:
“Pata bërë verë. E në këtë rast, hyri i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.).*

Vera ishte duke u zier dhe ai tha: - Ç’është kjo?!”

*Unë i thashë: - Më është ankuar vajza ime se është e sëmurë
dhe unë po ia përgatis asaj (si ilaç). Ai tha:*

- Allahu nuk ka bërë ilaç në atë që e ka ndaluar”.

HYRJE

Prej begative dhe mirësive të Allahut të Madhërishëm është edhe ajo që Ai ka larguar prej umetit të Muhamedit, stërngarkesa dhe mundimi i papërbalueshëm. Po ashtu, i Lartësuari ka përcaktuar rregulla të veçanta për raste të jashtëzakonshme dhe që doemos kërkojnë zgjidhje. I Madhërishmi nuk e ka ndaluar asgjë, vetëm kur në të ka dëme dhe pasoja dhe nuk është me rëndësi të dihet shkaku i ndalesës.

Sheriati islam gjithmonë është kujdesur për ruajtjen e interesave vitale të njeriut. Këto interesa janë: feja (besimi), mendja, nderi, jeta dhe pasuria.

Gjithashtu, prej mëshirës së Allahut është edhe fakti që Ai ka përcaktuar për çdo sëmundje ilaçin, përveç vdekjes dhe pleqërisë. I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), e ka bërë obligim të domosdoshëm kolektiv (farzi kifaje) studimin dhe mësimin e lëndës së mjekësisë. Për këtë, imam Shafiu (r.a.), ka thënë: “Dituria është dy lloje: dituria që merret me çështjet e fesë dhe dituria që merret me studimin e shëndetit”¹.

1. Këtë thënie e ka transmetuar Harfmelete.

Pa dyshim se shërimi me gjëra të ndaluara, me ndyrësira dhe dhënia e marrja e gjakut, janë prej çështjeve që vërtet kërkojnë një studim të mirëfilltë në aspektin e së drejtës islame. Me shumë krenari mund të themi se dijetarët e hershëm dhe të mëvonshëm i janë qasur një studimi të atillë dhe i kanë dhënë shpjegimet e tyre.

Gjatë shtjellimit të kësaj tematike do të mundohemi të ofrojmë mendimet dhe shpjegimet që kanë sjellë dijetarët klasikë dhe ata bashkëkohorë.

SHËRIMI ME GJËRA TË NDALUARA

Rreth çështjes së shërimit me gjëra të ndaluara, dijetarët myslimanë ndajnë mendimet e tyre:

1. Disa prej dijetarëve janë të mendimit se është e ndaluar shërimi me gjëra të ndaluara dhe me ato gjëra që konsiderohen ndyrësira. Mendimin e tyre e arsyejnë me faktin se çdo gjë që e ka ndaluar Allahu i Lartësuar, në të nuk ka ilaç. Mendimin e tyre e bazojnë në këto fakte:

a. Muslimi e ka shënuar në sahihun e tij, të mbështetur te zinxhiri i transmetimit të Vail el-Hadarmijut se

Tarik bin Suvejd el-Xhufa e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s.), për çështjen e verës? E i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), ia ndaloi ta prodhonte atë. Ai i tha: "Unë e prodhoj atë për ilaç." I Dërguari (s.a.v.s.), i tha: "Vera nuk është ilaç, por është sëmundje".²

b. Transmetohet nga Ebu Derdai se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), ka thënë: "Allahu ka zbritur sëmundjen dhe ilaçin e për çdo sëmundje ka caktuar ilaçin, atëherë shërohuni, por mos u shëroni me atë që është e ndaluar".³

c. Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a.), se i Dërguari i Allahut ka ndaluar të kërkojmë shërim me atë që është e ndyrë- haram.

ç. Transmetohet nga Tarik bin Suvejd el-Hadremiju: "I pata thënë: O i Dërguari i Allahut! Në tokën tonë kemi vreshta me rrush. E shtrydhim atë dhe e pimë atë lëng? Ai tha: "Nuk lejohet." Unë i thashë: "Ne i kurojmë të sëmurët me atë lëng (verë)." Ai tha: "Ky nuk është ilaç, por sëmundje".⁴

d. Është pyetur i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), nëse lejohet të përdoret vera si ilaç shërues dhe ka thënë: "Vera është sëmundje e nuk është ilaç".

e. Transmetohet nga Ibn Mesudi (r.a.), se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), ka thënë: "Allahu nuk ka bërë shërimin tuaj në atë që e ka ndaluar për ju".

ë. Transmetohet nga Ummu Selemete (r.a.), se i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), ka thënë: "Pa dyshim, Allahu i Lartësuar nuk e ka bërë shërimin e umetit tim në atë që ua ka ndaluar atyre".

f. Transmetohet nga Ummu Selemete (r.a.), se ka thënë: "Pata bërë verë. E në këtë rast hyri i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.). Vera ishte duke u zier dhe ai tha: "Ç'është kjo?!" Unë i thashë: "Më është ankuar vajza ime se është e sëmurë dhe unë po ia përgatis asaj (si ilaç)." Ai tha: "Allahu nuk ka bërë ilaç në atë që ka ndaluar".

2. Disa nga dijetarët lejojnë kurimin e sëmundjes me gjëra të ndaluara dhe të ndyra, duke mbështetur mendimin e tyre në hadithin që i lejon fisit Urenijjin të përdorë për ilaç urinën e deveve⁵.

3. Ndërsa pjesa dërmuese e dijetarëve lejojnë përdorimin e gjërave të ndaluara (haram) dhe ndyrësirës si ilaç vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston asnjë ilaç shërues përveç tij.

2. Transmeton Muslimi.

3. Transmeton Ebu Davudi.

4. Transmeton Ibn Maxheh

5. Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Shiko Sahihun e Muslimit me komentimin e imam Neveviut vol. II, fq.57

Shumica e dijetarëve të mëvonshëm hanefitë të medh'hebit janë të mendimit se lejohet kurimi me ilaç që është prej gjërave të ndaluara, por duke kush-tëzuar se ky ilaç do të përdoret vetëm në ato raste kur nuk ekziston ilaç tjetër dhe se ekziston bindja që ky ilaç do të jetë shërues.

Juristi dhe dijetari i mirënjohur hanefit, Alaudin el-Haskefiu (vdiq më 1088. h), në librin e tij "Ed-Durrul Muhtar", shprehet kështu: "Dijetarët kanë divergjencë rreth lejimit të shërimit me gjëra të ndaluara... Është thënë: lejohet shërimi me gjëra të ndaluara, vetëm atëherë kur dihet se me atë ilaç arrihet shërimi dhe nuk ekziston tjetër veç atij ilaçi, ashtu si kanë lejuar që ai që është shumë i etur të përdorë verën (vetëm e vetëm për të kaluar krizën e vdekjes)".

Ajo që transmeton imam esh-Shevkaniju (vdiq 1255 h.), është se disa prej dijetarëve e kanë lejuar shërimin me gjëra të ndaluara në raste të jashtëzakonshme⁶.

Në disa libra të njohur të jurisprudencës islame hasim në argumentin se nuk lejohet shërimi me gjëra të ndaluara, përveç atëherë kur mjeku mysliman, që është i besueshëm dhe specialist jep mendimin se ky është i vetmi i ilaç dhe nuk ka tjetër.

Në librin e njohur hanefit "El-Fetava el-Hindijetu", përmendet se nuk mund të përcaktohet në mënyrë të prerë kushti që vetëm mjeku specialist mysliman të japë mendimin se ilaç i vetëm është ajo gjë që është e ndaluar, por kjo mund të vërtetohet edhe në mënyra të tjera të besueshme, për arsye se mund të ndodhë që në kohën e duhur të mos gjendet mjek specialist mysliman dhe kështu ta pësojë i sëmurë⁷.

Mendimin e përmendur në *el-Fetava el-Hindijetu* e përforcon edhe mendimi i dy juristëve të njohur myslimanë, Ibn Nexhim el-Misriju (ka vdekur më 970 h)⁸ dhe dijetari i njohur hanefit, Ibn Abidin esh-Shami, i cili ka thënë: "Po qe se ndodh që ekziston frika se vdekja do të vijë nga etja dhe se ka vetëm verë, atëherë duhet pirë verë në atë masë, sa të tejkalohet etja dhe të evitohet rreziku (prej vdekjes)".⁹

Nëpër disa libra të fikhut gjejmë se dijetarët nuk e kanë kushtëzuar që duhet doemos të merret mendimi i mjekut specialist mysliman, por kanë thënë që kushtëzohet shërimi me gjëra të ndaluara, vetëm atëherë kur dihet se me to arrihet shërimi. Pra, në këtë rast, nuk kanë përcaktuar si kusht të domosdoshëm mendimin e mjekut specialist mysliman. Veç kësaj, dijetari i njohur El-Hafidh Ibnul Kajjimi (ka vdekur më 751 h), ka shënuar

6. Nejlul Evtar, Esh-Shevkaniju vol. I fq. 60

7. El-Fetava el-Hindijetu 5/355

8. El-Eshbahu, Ibnu Nexhim, fq. 122.

9. Reddul Muhtar, Ibn Abidin esh-Shami 5/215, 289.

në librin e tij të njohur "Et-Turukul Hukmijetu Mesleku Malikijeti" fq. 170 : "Ata kanë lejuar dëshminë e dy mjekëve jobesimtarë se një ilaç i tillë është shërues, atëherë kur nuk ka mjek specialist mysliman".

Dijetari i mirënjohur hanefit, et-Tahtavi (ka vdekur më 1233 h), transmeton fjalët e dijetarëve të Belhit, duke thënë: "Sikur të ndodhë që për të sëmurin mjeku të japë mendimin se duhet të pijë alkool, në këtë rast lejohet përdorimi"¹⁰.

Ndoshta, ajo që i ka nxitur disa prej juristëve myslimanë që në rast të shërimit me gjëra të ndaluara të kërkohet mendimi i mjekut mysliman, është për arsye se ai ia ka frikën Allahut të Madhërishëm, ndaj nuk e shpreh mendimin për një gjë të tillë shkel e shko dhe nuk nxiton në dhënien e diagnozës, duke pasur parasysh përgjegjësinë që ka para Allahut. Po ashtu, mjeku mysliman nuk kërkon të përdoret diçka që është e ndaluar me shariat, përveç kur nuk ka zgjidhje tjetër veç përdorimit të atij ilaçi. Ndërsa, sa i përket mjekut jobesimtar, ai pa kurrfarë ngurrimi dhe përgjegjësie jep mendimin se duhet përdorur ilaçi që është prej gjërave të ndaluara dhe veç kësaj, e jep këshillën e tij me shumë lehtësi dhe pa kurrfarë frike ndaj Allahut.

Dijetari i mirënjohur Abdullah Nasih Ulvani shprehet kështu për këtë çështje: "Sa i përket rasteve kur disa ilaçe kanë përmbajtje të paktë të alkoolit, për shkak se është i domosdoshëm për ruajtjen e ilaçit që të mos priset, lejohet përdorimi i tij, nëse vërtetohet se në të është shërimi, me kusht që përshkruesi i barit të jetë mjek, mysliman i aftë dhe që i ka frikën Allahut (xh.sh.), sepse bazë e shariatit është lehtësimi, evitimi i stërngarkesë-mundimit dhe zbatimi i gjërave që janë në interes të njerëzve." Si bazë për këtë, është fjala e Allahut (xh.sh.): "...e kush shtrëngohet (të hajë nga këto), duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është mëkat...". (Bekare, 173).

REZYME:

Sipas shpjegimeve të dijetarëve, në parim është e ndaluar të përdoren si ilaçe shërues ato gjëra që janë të ndaluara, përveç atëherë kur arrihet bindja e plotë se nuk ka shërim pa përdorimin e gjërave të ndaluara. Bindja arrihet nga fjalët e mjekut mysliman apo me ndonjë mënyrë tjetër.

DHËNIA-MARRJA E GJAKUT

Dijetarët myslimanë kanë ndarë mendimet e tyre rreth lejimit apo jo të dhënie-marrjes së gjakut, sipas të drejtës së shariatit.

10. Hashijetuhu Tahtavi ala Derril Muhtar vol IV, fq. 195

1. Disa nga dijetarët klasikë janë të mendimit se dhënia-marrja e gjakut është e ndaluar, saqë ka prej tyre që kanë menduar se në asnjë rast dhe gjendje nuk lejohet dhënia-marrja e gjakut.

2. Dijetarët e mëvonshëm kanë lejuar të përdoret qumështi i femrës si ilaç dhe duke bërë analogji në këtë, ata lejojnë të merret dhe të jepet gjaku. Prej dijetarëve bashkëkohorë, që kanë dhënë fetva për këtë çështje, është myftiu i njohur pakistanez Muhamed Shefu (ka vdekur 1936 hixhri), që jep këtë fetva: Dhënia e gjakut në raste të domosdoshme, kur duhet të shpëtohet jeta e njeriut, lejohet kur plotësohen dy kushte: 1) Dhënësi i gjakut të mos i ekspozohet ndonjë rreziku apo të dëmi shëndetësor. 2) Të mos ekzistojë frika që do të keqpërdoret vlera e gjakut të njeriut, pra, të mos hapen dyert e shitjes dhe blerjes së tij.¹¹ . Po ashtu, dijetari i njohur bashkëkohor Muhamed Muteveli Sharavi (Allahu e mëshiroftë!), kur është pyetur për dhënien e gjakut, është përgjigjur kështu: "Nuk ka mëkat te dhënia e gjakut (bartja) nga një person në tjetrin. Qëllimi është fisnik, nijeti është i mirë. Pra, qëllimet janë shëndeti dhe shërimi, sepse Muhamedi (a.s.), gjithnjë e ka lutur Allahun për shëndet e falje në këtë botë dhe në botën tjetër."¹² Dijetari i njohur bashkëkohor, Muhamed bin Ibrahim Ali Shejh, kur është pyetur për dhënien e gjakut, ka dhënë këtë fetva: "Për t'u përgjigjur në këtë pyetje, duhen pasur parasysh tre elementë. E para: kush është ai person që po i dhurohet gjaku, e dyta: kush është personi nga i cili po merret gjaku dhe e treta: kush është personi që mendon se duhet dhënë gjaku dhe a mund të mbështetemi në mendimin e tij. Sa i përket personit të parë, ky duhet të jetë personi që e ka të varur jetën nga marrja e gjakut, qoftë për shkak të sëmundjes apo për shkak të plagës. Si argument për këtë mund të përmendim fjalët e Allahut të Lartësuar: "(Allahu) Jua ndaloi juve vetëm të ngordhurën, gjakun, mishin e dërrit dhe atë që theret (ngrihet zëri me të), jo në emër të Allahut. E kush shtrëngohet (të hajë nga këto), duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është mëkat. Vërtet Allahu fal, është mëshirues."¹³, "E kush detyrohet nga uria (të hajë nga të ndaluarat), duke mos anuar dhe duke mos pasur qëllim mëkatin"¹⁴, "përveç kur jeni detyruar (atëherë edhe harami është hallall)."¹⁵. Ajo që mund të argumentohet nga këto ajete është se, kur vjen gjendja në atë fazë, që personi i sëmurë apo i plagosur e ka të varur jetën nga marrja e gjakut dhe se nuk ka mundësi tjetër për shpëtimin e jetës së tij, atëherë lejohet marrja

11. Kadaja Fihijetin Muasiretin, Muhamed Burhanu Din Es-Sunbuhejli, Darul Kalem, Damask, pa vit botimi fq. 53.

12. Marrë nga libri "Fetfat e Sharavit".

13. El-Bekaretu: 173

14. El-Maidetu: 3

15. El-En'am: 119

e gjakut. Përsa i përket personit të dytë, personi nga i cili merret gjaku, duhet të kihet parasysh që shëndeti i tij të mos dëmtohet. Për këtë, mund të përmendim si argument kuptimin e përgjithshëm të fjalës së të Dërguarit (s.a.v.s.): “Nuk ka dëm apo dëmtim reciprok”. E sa i përket personit të tretë, duhet mbështetur në mendimin e tij nëse është e domosdoshme marrja e gjakut. Ky duhet të jetë mjek mysliman. Kur ndodh që nuk ka mjek mysliman, atëherë nuk ka kurrfarë të keqeje të mbështetemi në mendimin e mjekut jomysliman, me kusht që mjeku të jetë specialist i mjekësisë dhe i besueshëm tek njerëzit. Këtë e argumenton ajo që transmetohet se i Dërguari (s.a.v.s.), e kishte marrë me pagesë një njeri prej fisit Beni Dile si udhërrëfyes, për t’i treguar rrugën për në Medine, ngase ky ishte person i njihte rrugët dhe ishte prej jobesimtarëve të fisit Kurejsh. (Këtë e ka shënuar Buhariu 2104).¹⁶.

Dijetarët myslimanë kanë diskutuar rreth çështjes nëse lejohet shitja e gjakut në raste të veçanta, kur edhe lejohet përdorimi i tij? Përgjigja për këtë është: kur ndodh që në raste të jashtëzakonshme lejohet përdorimi i ndonjë gjëje që është e ndaluar, nuk lejohet edhe shitja e tij.

Marrja e gjakut në raste të jashtëzakonshme, kur rrezikohet jeta e njeriut, lejohet, por kurrsesi nuk lejohet të bëhet shitja dhe blerja e tij. Kjo normë vendoset duke bërë analogji në gjërat e ndaluara, që në raste të jashtëzakonshme lejohen të përdoren, por kurrsesi nuk lejohet shitja e tyre. Kur ndodh që ai që ka nevojë nuk gjen dhurues të gjakut me vullnet dhe pa kompensim, atëherë, për shkak të nevojës së jashtëzakonshme i lejohet këtij të paguajë marrjen e gjakut, por dhënësit i nuk i lejohet të marrë kompensim.

Në dhënien e gjakut kushtëzohet që dhënësi ta dhurojë gjakun me vullnet, pa kurrfarë presioni dhe pa kurrfarë kompensimi.

Po ashtu, lejohet të rezervohet gjak në vendet e posaçme për ruajtjen e tij, për t’u përdorur për raste të papritura dhe të jashtëzakonshme

Shënim: gjatë shpjegimit të këtyre çështjeve kemi vërejtur se gjithmonë është cekur ajo që lejohet të përdoret në raste të jashtëzakonshme vetëm sa për të tejkaluar krizën e jetës. Rregulla që njihet në shkencën e jurisprudencës si: “Nevoja e jashtëzakonshme bën që vepra e ndaluar të jetë e lejuar”. Me nevojën e jashtëzakonshme nënkuptohet ajo gjendje, kur njeriu është para vdekjes, nëse nuk e përdor atë që është e ndaluar dhe se në të njëjtën kohë, nuk mund të gjejë ndonjë zgjidhje me diçka që është e lejuar. Prandaj, në raste të jashtëzakonshme, njeriu është i detyruar të shfrytëzojë atë që është e ndaluar, vetëm e vetëm që të kalojë krizën e vdekjes. Kështu, kur njeriu është shumë i uritur dhe nuk gjen asgjë për ta kaluar krizën e jetës, veç mishit të derrit, në këtë rast detyrohet të hajë nga ky mish, vetëm sa ta tejkalojë krizën e vdekjes, por jo ta teprojë dhe ta ketë për qëllim shijimin. Prandaj edhe përdorimi i gjërave të ndaluara si ilaç lejohet në raste të jashtëzakonshme, kur njeriut po i kanoset rreziku për jetë dhe nuk ka ilaç tjetër prej gjërave të lejuara.

PËRFUNDIM:

Pas gjithë këtyre shpjegimeve që kanë ofruar dijetarët rreth çështjes së shërimit me gjëra të ndaluara dhe rreth çështjes së marrjes së gjakut, mund të sjellim këto përfundime:

1. Myslimanët duhet të jenë shumë të kujdesshëm kur kanë nevojë për shërim, që të mos nxitojnë në përdorimin e ilaçit që është prej gjërave të ndaluara, siç është alkooli, mish i derrit etj., por duhet të mundohen të përdorin vetëm barëra që janë të lejuara sipas fesë. E kur harxhohen të gjitha mundësitë e shërimit dhe mbetet vetëm mundësia e shërimit me gjëra të ndaluara, në rast të tilla lejohet.
2. Dhënia e gjakut në raste të jashtëzakonshme lejohet, me kusht që të jepet mendimi i mjekut specialist.
3. Duhet pasur në mendje se gjaku është shumë i vlefshëm, andaj nuk duhet menduar për përfitim prej tij.

16. El-Idtiraru lilel At’imeti vel Edevijetil Muharremeti, fq. 169

HISTORIKU I BASHKËSISË ISLAME NË KINË

Fillimet e bashkësisë myslimane në Kinë, sipas burimeve historike tradicionale klasike islame, lidhen me udhëtimet e katër sahabëve të njohur në Kinë. Sahabët qenë Sad ibn Ebu Vakas, Vehb Ebu Keshshe, Xhaferibn Ebu Talib dhe Xhahshi. Sipas po këtyre burimeve, sahabët Sad ibn Ebu Vakas, Said ibn Zejd, Kajsibn Sad dhe Hasan ibn Thabit shkuan në Kinë në vitin 637, duke pasur me vete edhe një kopje të Kuranit. Sadi shkoi për të tretën herë në Kinë, në vitin 651 me kërkesë të kalifit Osman, i cili e urdhëroi të kryesonte një delegacion përfaqësues në Kinë.

Historianët kinezë shprehen se nuk ekziston ndonjë evidencë në burimet e shkruara kineze të asaj kohe, që do të na lejonte të pohojmë se Sadi pati ardhur në Kinë. Sipas tyre, feja islame u përhap në Kinë nëpërmjet tregtarëve arabë, që erdhën në numër të shumtë gjatë sundimit të dinastisë Tang, e njohur për politikën e saj kozmopolitane.

Arabët myslimanë përmenden në burimet e shkruara kineze nën emrin Tashi. Këto burime të shkruara i përkasin dinastisë kineze Tang, e cila sundoi mes viteve 618 dhe 907. Këtë emërtim kinezët e patën marrë nga persianët, të cilët i quanin arabët tazi. Burimet kineze të vitit 713 flasin rreth një të dërguari tashi, që kishte ardhur në oborrin e kësaj dinastie. Vendbanimi i parë mysliman në Kinë konsistonte në tregtarët arabë dhe persianë.

Pas betejës së Talasit, mes dinastisë Tang dhe shtetit abasi, në vitin 751, marrëdhëniet mes tyre u përmirësuan dhe u zhvilluan edhe më shumë pas vitit 756, vit në të cilin shteti abasi dërgoi një numër të konsiderueshëm iranianësh dhe irakenësh që të ndihmonin perandorin SuTsung kundër rebelëve që kërkonin ta hiqnin nga fronti. Më pak se 50 vjet më vonë, mes abacive dhe dinastisë Tang u lidh një marrëveshje kundër sulmeve të tibetianëve në Azinë Qendrore.

Gjatë sundimit të dinastisë Song, mes viteve 960 dhe 1279, myslimanët filluan të kishin një impakt më të madh mbi ekonominë dhe në këtë mënyrë, mbi të gjithë jetën ekonomike të vendit. Në këtë

periudhë, myslimanët dominonin në Kinë tregtinë e jashtme dhe industrinë e import-eksportit në drejtim të perëndimit dhe të jugut.

Në vitin 1070 perandori ShenTsung ftoi 5300 burra myslimanë nga Buharaja që të vinin dhe të vendoseshin në Kinë. Qëllimi ishte që kjo bashkësi të formonte një territor të pavarur mes dinastisë Song dhe perandorit Liao. Në vitin 1080, rreth 10 mijë burra dhe gra myslimanë arabë emigruan drejt Kinës dhe u vendosën në pjesën veriore dhe jug-perëndimore të Kinës. Në këto vite u përkthyen në gjuhën kineze pjesë nga vepra e Ibn Sinasë, kapitulli i ilaçeve.

Edhe gjatë dinastisë Juan myslimanët vazhduan të emigronin drejt Kinës, aq sa numri i tyre kapi shifrën 4 milion myslimanë në shek. XIV. Një pjesë e udhë-



heqësve mongolë të dinastisë Juan përzgjidhnin nënshtetasit e besimeve të ndryshme jotradicionale kineze, si myslimanë, të krishterë, hebrej apo budistë nëpër detyra administrative në vend të murgjve vendas konfucianë. Situata ndryshoi gjatë sundimit të Xhingiz Hanit, kur u ndaluan shumë rite fetare për myslimanët dhe hebrejtë.

Edhe gjatë dinastisë Ming, myslimanët vazhduan të vërshonin drejt Kinës. Gjatë sundimit të kësaj dinastie në kryeqytetin e dinastisë Nanjing, ekzistonte edhe një qendër arsimimi islam. Por gjatë kësaj dinastie u përjetua një rënie e madhe e popullsisë myslimane nëpër qytetet porte, si rrjedhojë e dobësimin të tregtisë së jashtme. Megjithatë, myslimanët vazhduan të kontribuonin në jetën ushtarake të dinastisë. Pjesa më e madhe e komandantëve më të besuar të perandorit Zhu Juang Zhung qenë myslimanë (si p.sh. Hu Dahai, Mu Jing, Lan Ju, FengSheng dhe DingDexing).

Më pas, emigrimet e myslimanëve drejt Kinës pësuan një rënie drastike, duke bërë që myslimanët në

Kinë të shndërroheshin në një bashkësi të izoluar nga pjesa tjetër e botës islame. Përkrah kinezëve myslimanë edhe myslimanët e etnive të tjera (arabë, persë) filluan të ndërthurnin elementët e jetës së përditshme me kulturën tradicionale kineze, duke përdorur si gjuhë të shtëpisë gjuhën kineze dhe duke mbajtur veshje kineze. Një pjesë e myslimanëve adoptuan mbiemra kinezë, ndërsa të tjerët filluan të përdornin për mbiemra fjalë që tingëllonin si kineze, por që në të vërtetë kishin domethënie nga emrat arabë mysliman, si Ma për Muhamed, Mai për Mustafa, Mu për Masud, Ha për Hasan, Hu për Hysein dhe Sa për Said.

Gjatë sundimit të dinastisë King, që zgjati prej vitit 1644 deri në vitin 1911, myslimanët në Kinë kishin shumë xhami nëpër qytetet e mëdha si në Pekin, Xian, Hangzhou, Guangzhou si dhe në qytetet e tjera në pjesën perëndimore të Kinës. Arkitektura e xhamive ishte në tërësi kineze, e stolitur me shkrimet në gjuhën arabe si një karakteristikë dalluese.

Gjatë kësaj periudhe, në Kinë nisën të përhapen edhe sektet mistike islame, si kadirët dhe nakshibenditë. Gjatë kësaj periudhe, myslimanët kinezë qenë edhe myslimanët e parë që u vendosën për të jetuar në Zelandën e Re.

Dinastia King u zhduk në vitin 1911 dhe u krijua Republika e Kinës. Në fillim të krijimit të kësaj republike shteti kinez deklaroi se republika u përkiste në mënyrë të barabartë të gjitha etnive dhe feve që gjendeshin në Kinë. Kjo çoi në përmirësimin e situatës mes bashkësive të ndryshme etnike dhe fetare që gjendeshin në Kinë. Gjatë kësaj periudhe, një numër i madh myslimanësh kinezë u arsimuan në Ezher. Vetëm mes viteve 1911 dhe 1937, myslimanët kinezë botuan më shumë se njëqind revista. Ndonëse Linxia ishte qendra e myslimanëve kinezë, një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të tyre zhvilloheshin në Pekin. Në dekadat e para të shekullit XX, në Kinë përlllogaritet se jetonin afërsisht 20 milion myslimanë kinezë.

Gjatë pushtetit komunist në Kinë, pas vitit 1949, bashkësia myslimane vuajti një sërë problemesh diskriminimi. Shumë objekte myslimane u shkatërruan apo u përdhosën. Tensionet mes myslimanëve ujgurë dhe shtetit kinez vazhdojnë ende edhe sot.



Bashkëpunimi, faktor në forcimin e shoqërisë islame

Bashkëpunimi është i mundshëm në botën njerëzore, shtazore, bimore dhe në të gjitha botët e tjera që ne i shohim apo nuk i shohim.

Për shembull, bashkëpunimi në botën e gjallesave është i larmishëm në lloje të ndryshme. Ai është mënyrë për qëndrimin e tyre në këtë jetë lëndore. Kështu, në botën e insekteve mund të marrim si model milingonat, të cilat bashkëpunojnë në punë të ndryshme me durim, disiplinë dhe rregull. Përpyekjet e tyre të llojllojshme ruajnë jetën dhe ekzistencën e tyre. Nëse përballen me rrezikun, grumbullohen dhe bashkëpunojnë për mbrojtje të përbashkët. Ky lloj bashkëpunimi konsiderohet një mënyrë e vetme për t'u bërë ballë rreziqeve që ka jeta. Kurani famëlartë na tregon një shembull nga qëndrimet e këtij lloji të dobët të krijesave. Profeti Sulejman (a.s.), duke kaluar mbi një luginë të mbushur me milingona në Sham, dëgjoi një milingonë se si komandonte dhe thërriste të tjerat që të largoheshin, të mos i shkelte ushtria e Sulejmanit (a.s.). Këtë gjë e përmend dukshëm Kurani famëlartë: "Deri atëherë kur arritën mbi luginën e milingonave, një milingonë tha: "O ju milingona, hyni në vendet tuaja që të mos ju copëtojë Sulejmani dhe ushtria e tij, duke mos ju vërejtur". E ai (Sulejmani) buzëqeshi i gëzuar prej fjalës së saj dhe tha: "Zoti im, më mundëso që të falënderoj të mirat Tuaja që m'i dhurove mua dhe prindërve të mi dhe të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen, e me mëshirën Tënde më shtjerë në mesin e robërve Tuaj të mirë." (En-Mel/18,19)

Gjithashtu edhe grupet e bletëve bashkëpunojnë me saktësi dhe koordinim të përsosur, duke kryer detyrat e tyre dhe ndërtuar vendqëndrimet e tyre. Këtë e bëjnë me qëllim që të mundësojnë prodhimin e mjaltit, të cilin Allahu (xh.sh.), e ka cilësuar shërim për njerëzit. Madhëria e Tij absolute thotë në Kuratin e shenjtë: "Zoti yt i dha instinkt bletës: Ndërto shtëpi nëpër kodra (male), nëpër drunj (pemë) dhe nëpër kulmet që ata (njerëzit) i ndërtojnë. Pastaj ha nga të gjitha (llojet) frutat dhe futu nëpër rrugët e nënshtruara (e të mësuara) prej Zotit tënd. Nga barqet e tyre (bletëve) del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim (bar-ilaç) për njerëz. Edhe në këtë ka arsye për atë popull që mendon thellë."

Jo vetëm kaq, por edhe në botën e shpendëve, të kafshëve etj., shihen grupe që bashkëpunojnë njëra me tjetrën. Në rast se i kanos ndonjë rrezik, bashkohen dhe i bëjnë ballë në grup, në të kundërt, ata shkatërrohen e shuhën.

Ndërsa njeriu, si krijesa më e përzgjedhur e Krijuesit të gjithësisë, është zotëria e të gjitha gjallesave. Duhet që bashkëpunimi të jetë më i fortë dhe më i thellë, sepse ai (njeriu) e kupton shumë më mirë se bashkësia e koordinuar është më e mirë se ndarja dhe se bashkëpunimi është më i dobishëm se individualizmi e izolimi.

Është e natyshme që kjo jetë materiale t'i dallojë njerëzit në dhunti e zotërimi, në përpjekje e mundësira. Ka prej njerëzve që janë të fortë e të dobët, të shëndetshëm e të sëmurë, të pasur e të varfër, të mundshëm e të plogësht etj. Mendoj se këto dallime nuk duhet të na lartësojnë apo të na ulin, por përkundrazi, duhet të jenë qëllim afrimi midis tyre, drejt mirëkuptimit, mëshirës, solidaritetit e bashkëpunimit, ngase njeriut, sado që t'i jepet forcë apo aftësi, nuk mund të jetojë vetëm. Njeriu ka nevojë në shumë aspekte për të tjerët, për ta ndihmuar në rrjedhshmërinë e jetës, për ta përkrahur në vështirësi, për të marrë pjesë me të në gëzim e hidhërim.

Nga ana tjetër, po të kthehemi pak në të kaluarën, do të shohim se shoqëria arabe përpara ardhjes së Islamit, ka qenë e mbështetur mbi racizmin injorant. Racizmi fisnor arab kishte zëvendësuar bashkëpunimin e përgjithshëm midis të gjitha fiseve. Kjo gjë reflektonte në ndihmën që shoku i jepte shokut të vet zullumqar; e ndihmonte atë për shkeljen e drejtësisë dhe të së vërtetës. Pothuajse të gjitha lidhjet e marrëdhëniet sociale midis tyre ngriheshin mbi mendjemadhësi, arrogancë e mbisundim të padrejtë, me synim për të arritur madhështinë e lartësinë mbi të tjerët. Me ardhjen e Islamit si fe e përsosur dhe me dërgimin e Muhamedit (a.s.), si Profet të Islamit, veprime të tilla jonjerëzore u nënçmuan dhe pikërisht kjo fe e vërtetë Hyjnore, punoi për ta kthyer identitetin njerëzor në fitratin (pastërtinë Islame) origjinal, i cili u konkretizua me bashkëpunim të sinqertë, dashuri të mirëfilltë dhe ndihmesë fisnike. Feja islame i bëri të gjithë myslimanët

vëllezër, që të duhen njëri me tjetrin si umet bashkëpunues në të mira, pa dallim race, gjuhe, krahine a vendi. Pra, Islami i nxiti myslimanët drejt vlerave e virtyteve të larta dhe të pakrahasueshme. "Besimtarët dhe besimtarët janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, ndalojnë nga e keqja, falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Këta do t'i mëshirojë Allahu. Allahu është ngadhënjyes, i urtë." (Etevbe, 71) Islami dënon çdo konflikt, çdo zemër të prishur e çdo egoizëm që padyshim, ndikojnë negativisht në të drejtën e punës e të jetës së njerëzve. Në lidhje me këtë çështje, Allahu (xh.sh.), thotë: "Është Ai (Allahu), që për ju krijoi gjithçka në tokë." (El-Bekare, 29) Këto fjalë Hyjnore konfirmojnë se çdo gjë që Allahu i Lartësuar ka krijuar në këtë gjithësi, janë në shërbim të njeriut, i cili lypset të punojë me të gjithë kapacitetin dhe potencialet e tij në shërbim të shoqërisë, ku bën pjesë. Nuk mund të jetë e mira dhe pasuria vetëm për një shtresë të veçantë, por duhet të jetë e të gjithëve, sepse të gjithë njësoj kanë emërtimin njeri.

Transmetohet nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Allahut ka thënë. "Kam parë një njeri në xhenet kapur mbas një peme, të cilën e kishte hequr nga rruga, sepse dëmtonte myslimanët." Nëse çështja është kështu, atëherë imagjioni çfarë vendi të lartë ka ai që heq ngarkesën e padrejtësisë, vendos në vend të saj bazat e drejtësisë e të bashkëpunimit, vepron për t'i dhënë krenarinë e përparimin umetit, punon me të gjitha mundësitë për t'i dhuruar shoqërisë islame sigurinë e mirëqenien e të gjitha të mirat që ka jeta kalimtare. Kështu, feja islame vendos drejtësinë sociale si bazë dhe referencë për vëllazërimin njerëzor e bashkëpunimin e frytshëm e konstruktiv. Këtë e bën për hir të lirisë e të barazisë dhe për të realizuar sovranitetin, krenarinë e për të garantuar nivelin e jetesës në formën më të mirë, më të lartë dhe më të përsosur për çdo individ të shoqërisë.

Pra, bashkëpunimi është një nga kolonat e besimit dhe një nga themelet e fesë sonë. Është detyrë e besimtarëve që të kapen mbas saj dhe ta kenë sjellje morale në jetën e tyre të përditshme. Zoti i Lartësuar thotë në Kuran: "... Ndihmoni njëri-tjetrin në të mira dhe në të mbara e jo në mëkate e në armiqësi. Kini frikë dënimin e Allahut, se me të vërtetë Allahu është ndëshkues i fortë." (El-Maide, 2) Kjo do të thotë, bashkëpunoni në zgjerimin e veprës së mirë dhe shmangni atë që dëmton fenë dhe jetën materiale e mos bashkëpunoni në të ligat e kësaj bote mashtruese, se për të do të përgjigjeni në Ditën e Llogarisë, që s'ka dyshim se do të vijë. Transmetohet nga Abdullah bin Omeri se një njeri erdhi tek Resulullahi dhe i tha: "O i dërguari i Allahut, kush janë njerëzit më të dashur të Allahut?" Ai (Profeti Muhamed a.s.), i tha: "Njerëzit më të dashur të Allahut janë ata që përpiqen t'u sjellin dobi njerëzve (nëpërmjet bashkëpunimit) ..."



Eliminoni dhimbjen e dhëmbit për shtatë minuta

Dhimbja e dhëmbit është padyshim një nga dhimbjet më të pakëndshme, që pothuajse të gjithë e njohim. Mirëpo, me ndihmën e një marifeti shumë të thjeshtë, që përbëhet vetëm nga një copë akulli, do ta keni të lehtë ta eliminoni atë, së paku deri sa të arrini te stomatologu.

Një studim i realizuar disa vite më parë në Kanada, ka treguar se dhimbjen e dhëmbit mund ta eliminojmë ose lehtësojmë duke mos e hapur aspak gojën.

Ajo që ju nevojitet është një copë akulli, të cilën do ta vendosni në rrudhosjen e dorës në mes të gishtit të madh dhe gishtit tregues dhe ngadalë do ta fërkoni pikërisht atë pjesë- pesë për shtatë minuta.

Kjo pjesë e shuplakës është vendi në të cilin gjenden mbaresat nervore, të lidhura me qendrën e dhimbjes në tru, e cila kontrollon shkallën e dhimbjes në duar dhe në kokë. Fërkimi me akull bllokon ato qendra dhe 90 % e pjesëmarrësve në studim kanë pohuar se kjo teknikë ua ka lehtësuar dhimbjen.



Depresioni pas lindjes dhe pasoja

Shumë gra kalojnë një periudhë paqartësie emocionale, për shkak të ndryshimit të hormoneve, por depresioni pas lindjes është një gjendje shumë serioze e cila zgjat shumë.

Zakonisht, depresioni pas lindjes fshihet dhe nuk flitet për të. Periudha pas lindjes perceptohet si një periudhë kur ju duhet të jeni e lumtur dhe "dielli duhet të shkëlqejë në sytë tuaj". Për këtë arsye, shpeshherë nuk i kushtohet rëndësi parandalimit dhe trajtimit të depresionit pas lindjes.

Pas lindjes, shumë gra kalojnë nëpër një periudhë kur ndihen të mërzitura. Kjo zakonisht fillon rreth tri ditë pas lindjes dhe mund të zgjasë deri në dy javë. Shenjat e kësaj gjendjeje janë: të qarët, acarimi, shqetësimi, tensioni, ankthi dhe ndoshta pagjumësia. Në paraqitjen e kësaj gjendjeje luajnë rol hormonet,

por ndoshta edhe stresi gjatë lindjes dhe shqetësimi që lidhet me beben.

Një përqindje e konsiderueshme e grave kalojnë në depresion pas lindjes. Kjo gjendje karakterizohet nga përkeqësimi i simptomave normale, në panik ose mani postpartale. Ndonjëherë, me çrregullime obsesive-kompulsive. Disa gra përjetojnë të ashtuquajturin çrregullimin e stresit posttraumatik, sidomos nëse lindja ka qenë traumatike.

Prallëherë ndodh që gjendja të përkeqësohet skajshmërisht, por ajo që shihet shumë shpesh, është gjendja me simptomat e sipërsënuara, e shoqëruar me halucinacione, konfuzion dhe iluzion. Prandaj, kjo gjendje duhet trajtuar me seriozitet të madh.

Kujdes! Fëmija juaj mund të jetë alergjik ndaj qumështit

Alergjia ndaj qumështit zakonisht vihet re gjatë vitit të parë të jetës së fëmijës. Në këtë periudhë, sistemi tretës nuk ka pjekurinë e duhur.

Shenjat e alergjisë ndaj qumështit mund të shfaqen disa minuta apo disa orë pas konsumimit të qumështit, por shenjat më të rënda të kësaj alergjie shfaqen gjysmë ore ose një orë pas konsumit të tij.

Shenjat më të shpeshta janë skuqje, rënie të lëkurës, shqetësim në stomak dhe zorrë, të vjella dhe diarre. Megjithatë mund të shfaqet rrallë, edhe hemorragjia në jashtëqitje është një nga shenjat e pakta të kësaj alergjie. Tek disa fëmijë të tjerë, alergjia ndaj qumështit mund ta shfaqë veten me bllokim kronik të hundëve, kollë, vështirësi në frymëmarrje. Pas marrjes së qumështit të lopës apo ndonjë produkti të qumështit, mund të shfaqen shenja, si fryrje, kruajtje dhe rënie të lëkurës në trajtë urtikarie, por nuk përjashtohet mundësia e shkaktimit të ekzemes (sëmundje lëkure).

Nëse fëmija juaj nxihet menjëherë pas pirjes së qumështit, është i zbehtë dhe i lodhur, nëse në trup i shfaqen droçka, ka fryrje të menjëhershme të qafës dhe pjesës së kokës dhe, nëse ka diarre me hemorragji, duhet të shkoni menjëherë në urgjencë.

Në kurën e alergjisë ndaj qumështit, në radhë të parë hiqet qumështi dhe produktet e tij nga dieta e nënës, nëse fëmija ushqehet me gji. Nëse fëmija nuk ushqehet me gji, atëherë duhet përdorur ushqim hipoalergjenik, i formuar nga protei-

na të hidrolizuara. Nëse fëmija paraqet shenja alergjike gjatë periudhës së ushqimit shtesë, atëherë hiqet qumështi dhe produktet e tij nga dieta e fëmijës dhe analizohen shenjat e alergjisë nëse kanë përparuar apo jo.

Më vonë, nën kontrollin e mjekut mund t'i jepen sasi të vogla qumështi dhe produktet e tij dhe të analizohen edhe një herë shenjat e alergjisë. Fëmijët alergjikë ndaj qumështit mbi moshën 1 vjeç, duhet të qëndrojnë larg djathit, kosit, akullores dhe qumështit. Kjo mund të quhet qumësht soja, por nuk duhet harruar se alergjia ndaj qumështit të lopës dhe alergjia ndaj qumështit soja mund të shfaqen përnjëherësh.

Në këtë rast, pediatri juaj do t'ju ndihmojë të vendosni rreth zgjedhjes së qumështit të duhur. Ai mund t'ju japë dhe ilaçe antihistaminike, në varësi të shkallës së alergjisë. Nëse fëmija juaj paraqet ankesa në lidhje me rrugët e frymëmarrjes, mund t'i jepen ilaçe kundër astmës.

Pjesa më e rëndësishme e kurës është heqja e qumështit dhe e produkteve të qumështit. Në shumicën e rasteve, alergjia ndaj qumështit zgjat deri në dy ose pesë vjeç.

Për të parandaluar alergjinë, zgjidhja më e mirë është ushqyerja e fëmijës me gji deri në 4 ose 6 muajsh dhe, nëse fillohet me ushqimin shtesë dhe nëna është alergjike ndaj qumështit, atëherë duhen shtuar ngadalë dhe çdo 2 javë ushqimet shtesë.



Në Tabelën e Mendelejevit shtohen edhe dy elementë të rinj

Bashkimi Ndërkombëtar për Kiminë e Pastër të Aplikuar (IUPAC) ka ratifikuar zyrtarisht emrat e propozuar për elementët 114 dhe 116, zbulimi i të cilëve u konfirmua nga IUPAC në fund të vitit të kaluar.

Elementët do të marrin emrat që njohin përpjekjet e përbashkëta të shkencëtarëve nga SHBA dhe Rusia, për të siguruar një dëshmi të qartë të sintezës së tyre.

Emrat e pranuar të elementëve të rinj janë **Flerovium** (simboli Fl), për elementin 114, në nder të fizikanit rus Georgij Flerov, i cili zbuloi fuzionin e uraniumit. Emri Flerov i është dhënë njëkohësisht edhe Institutit të Përbashkët të Kërkimeve Bërthamore në Dubna, Rusi, aty ku u realizua elementi i parë.

Elementi 116 do të quhet **Livermorium** (simboli Lv), në nder të Lawrence Livermore nga Laboratori Kombëtar i



Kalifornisë, shtëpia e një ekipi të përbashkët për kërkime bërthamore dhe elementëve të rëndë.

Spiuni i vogël amerikan



Shkencëtarët amerikanë kanë zhvilluar një robot spiun me përmasat e mushkonjës, të cilin e kanë pajisur edhe me kamera. Ky robot do të përdoret në operacionet ushtarake të forcave ajrore të SHBA-ve. Në sajë të kamerës me të cilën është pajisur ky robot i vogël sa një

mushkonjë, do t'i sigurojë ushtrisë amerikane shumë avantazhe në fushën e spiunazhit.

Ky mikro-robot, i cili është ndërtuar në laboratorin e Universitetit të Pensilvanisë, është shumë vështirë të vihet re dhe mund të përdoret edhe në brendësi të banesave.


Por e veçanta më interesante që ka ky robot, është edhe funksioni i pjesës e cila i ngjan një shiringe. Thuhet se kjo pjesë, në sajë të një gjilpëre, mund të përdoret edhe si armë, por edhe për të mbledhur informacione ADN-je. Ky robot do të jetë gati për prodhim në vitin 2015.

Dy mijë e pesëqind kilometra, pa asnjë pikë karburant

Aeroplani "Solar Impulse", i cili punon me energji diellore, arriti në stacionin e tij të fundit, në Marok. Aeroplani i pilotuar nga piloti zviceran Bertrand Piccard, u ul në aeroportin e Rabat Sale, ku e prisnin gruaja dhe fëmijët.

Fluturimi i parë i "Solar Impulse" ishte Zvicër-Bruksel, ndërsa fluturimin e dytë, të cilin e bëri vitin e kaluar, ishte Paris-Bruksel. Por këtë vit "Solar Impulse", përshkoi largësinë prej 2.500 kilometrash, pra Zvicër-Marok, pa përdorur asnjë pikë karburanti.

Solar Impulse është i pajisur me katër motorë, me krahë me gjatësi 63 metra dhe 12 mijë qeliza diellore. Aeroplani diellor, në testin e tij të parë të fluturimit, u nis nga Zvicra dhe duke fluturuar mesatarisht me 89 km në orë, për 17 orë arriti në Madrid.



Titullohet edhe një hafiz i ri në Medresenë e Madhe të Gjakovës

Burhan Islami, i lindur më 20.08.1994 në Gjilan, u regjistrua në nëntor të vitit 2010 në institutin tonë të Hifzitet në Gjakovë. Për një periudhë prej një viti e gjashtë muaj, gjegjësisht në maj të vitit 2012, Burhan Islami përfundoi hifzin (memorizimin e Kuranit). Po ashtu, brenda kësaj periudhe përfundoi me sukses të lartë edhe klasat 10 dhe 11 të Medresesë së mesme Alauddin – Prishtinë.

Burhan Islami e përfundoi hifzin ditën kur vizituan institutin tonë të Medresesë në Gjakovë, Hoxha ynë i nderuar Osman Nuri Topbash, z. Rafet Bilaç dhe grupi vizitor që i shoqëronin ata. Hoxha ynë i nderuar përgëzoi Hafizin e posadalë, Burhan Islamin, për punën e tij të palodhshme gjatë memorizimit të Kuranit dhe i uroi suksese të mëtejshme në vitet e ardhshme shkollore. Stafit udhëheqës i Institutit të hifzitet në Gjakovë, i uron Burhan Islamin suksese në vitet e ardhshme të jetës së tij.



Berisha-Gyl, bashkëpunim mes vendeve

Kryeministri Berisha, muajin e kaluar zhvilloi në Stamboll një takim me Presidentin e Turqisë Abdullah Gyl, duke vlerësuar miqësinë e solidaritetin mes të dy vendeve.

Kryeministri Berisha vlerësoi kontributin e jashtëzakonshëm të Presidentit Gyl dhe Kryeministrit Erdogan, në konsolidimin e zgjerimin e marrëdhënieve shumë të ngushta e vëllazërore midis dy vendeve, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit frytdhënës në të gjitha fushat.

“Në një hark të shkurtër kohor, theksoi Kryeministri, investimet turke janë rritur shumë herë dhe investitorët turq kanë një vlerësim e imazh shumë pozitiv në Shqipëri”.

Në takim u shpreh besimi se bashkëpunimi mes dy vendeve do të njohë dimensione të reja në shumë fusha, si në atë të shkëmbimeve ekonomike, tregtare, të turizmit, arsimit, në sektorin bankar etj.

Presidenti Gyl ndau të njëjtin mendim se ndërtimi i infrastrukturave të rëndësishme që do të lidhin vendet e rajonit, është dhe mbetet jashtëzakonisht i rëndësishëm për bashkëpunimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre.

Korridorit 8 u vlerësua si projekti kyç për forcimin e lehtësimin e lidhjeve dhe bashkëpunimit mes vendeve të rajonit.

Muhamed Mursi, presidenti i ri i Egjiptit

Kandidati i Vëllazërisë Myslimane, Muhamed Mursi, i cili fitoi zgjedhjet e para presidenciale në vend, që nga rënia e ish-presidentit egjiptian, Hosni Mubarak, është përpjekur të eliminojë imazhin e tij si lider islamik, për të bërë hapa ndryshimi në vend.

Mursi u angazhua të punonte bashkë me egjiptianët për një të ardhme më të mirë, për liri, demokraci dhe paqe. Ai premtoi gjithashtu se do t’u shërbente gjithë egjiptianëve, pavarësisht nga bindjet e tyre politike apo fetare.

Për dekada me radhë, Vëllazëria Myslimane ka qenë shumë aktive në planin social dhe në atë profesional.

Në zgjedhjet presidenciale Mursi ishte kandidati i vetëm me një program islamik, bazuar në parimet themelore të këtij besimi.

Presidenti i ri, 60 vjeç, u lind në prefekturën Sharkija, në deltën e Nilit. Ka mbaruar studimet e larta për inxhinieri në Universitetin e Kajros, në vitin 1975 dhe në vitin 1982

gjithashtu merr një doktoraturë në Universitetin e Karolinës së Jugut, në SHBA. Mursi është i martuar dhe baba i pesë fëmijëve. I ka kushtuar më tepër kohë Vëllazërisë Myslimane.

U zgjodh deputet në vitin 2000 dhe në vitin 2010 mori postin e zëdhënësit të Vëllazërisë Myslimane.

U burgos për një kohë të shkurtër, më 28 janar 2011, tri ditë pas fillimit të protestës, që shkaktoi rrëzimin e ish-presidentit Mubarak.

Ndërkaq, me mijëra egjiptianë u mblodhën në sheshin “Tahrir”, në qendër të Kajros, ku shpërthyen nga gëzimi pas fitores së kandidatit të Vëllazërisë Myslimane, Muhamed Mursi, në zgjedhjet presidenciale.

Protestuesit të mbledhur në këtë shesh, epiqendra e revoltës, që rrëzoi ish-presidentin Hosni Mubarak në fillim të vitit 2011, valëvisnin flamuj dhe ngrinin portrete të kandidatit islamik.